



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 297/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.08.2020 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt “Realizimi i dhomës së serverave (bcc site) në Vaun e Dejës dhe krijimi i kushteve teknike në HEC Vau i Dejës, HEC Koman dhe HEC Fierzë”, me nr. REF-61043-06-11-2020, me fond limit 27,800,000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 13.07.2020, nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Integrated Security Solutions” sh.p.k.
Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, K.III, Tiranë.
- Autoriteti kontraktor:** KESH sh.a.
Adresa: Rr. “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga ankimuesi dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Ankimuesi ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesës të ankimuesit.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.06.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Realizimi i dhomës së serverave (bcc site) në Vaun e Dejës dhe krijimi i kushteve teknike në HEC Vau i Dejës, HEC Koman dhe HEC Fierzë*”, me nr. REF-61043-06-11-2020, me fond limit 27,800,000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 13.07.2020, nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a.

II.2. Në datën 18.06.2020, operatori ekonomik ankimues “Integrated Security Solutions” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, me argumentin si më poshtë vijon:

“[...] ANKESË NR.1

Të bëhet ndarja në Lote pasi AK kërkon 2 mallra të fushave të ndryshme brenda të njëjtit objekt. Konkretisht kërkohet prokurimi i sistemeve të kondicionit dhe sistemeve të sigurisë në përbërje të të njëjtit tender. Ne Nenin 9 pika 5 te VKM Nr. 914 “Per rregullat e Prokurimit Publik” percaktohet se: “Kontrata ndahet në lote, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t’i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të

përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor. Në çdo rast, kur kontrata ndahet në lote, për efekt të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit, vlera limit e kontratës do të jetë shuma e vlerës së secilit lot.” Nderkohe që në Nenin 29 ndër të tjera përcaktohet se: Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit. “ Sa më sipër duke marrë në konsideratë faktin se kompanitë që ofrojnë sisteme sigurie nuk montojnë kondicionera sic pretendon AK, kërkojmë minimalisht ndarjen e kësaj procedure në Lote. Pika 2.11 të modifikohet si më poshtë:

2.11 Ndarja në LOTE: Po X Jo

ANKESË NR.2 Në pikën 2.14.1 të DST 2.14.1 Do të pranohet nenkontraktimi: Po Jo

Nese do te lejohet nenkontraktimi, te specifikohet perqindja e lejuar per nenkontraktim.

AK nuk ka parashikuar nëse lejohet apo nuk lejohet nënkontraktimi. Duke marrë në konsideratë faktin se ky prokurim ka një ndërthurje mallrash të ndryshëm, gjykojmë se në funksion të zgjerimit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik duhet të lejohet mundësia e nënkontraktimit të operatorëve të tjerë. Pika 2.14.1 të modifikohet si më poshtë: 2.14.1 Do të pranohet nenkontraktimi: Po X Jo

Nese do te lejohet nenkontraktimi, te specifikohet perqindja e lejuar per nenkontraktim.

ANKESË NR.3

Në DST rezulton se është lënë pa plotësuar pika 2.15 si më poshtë: 2.15. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) janë përdorur standartet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit: Po Jo

2.16. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë të Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rastin kur standardet janë të pa-aplikueshme, është marrë miratimi paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit: Po Jo

I.S.S shpk është e vetëdijshme që si institucion me vetëfinancim nuk keni detyrim për të marrë miratim nga AKSH-i, por keni detyrimin ligjor për të plotësuar të gjitha fushat në DST dhe të zgjidhni njërin nga opsionet.

ANKESË NR. 4

Në pikën 2.3 të Kapacitetit Teknik parashikohet se: 2.3.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e hapjes së tenderit, furnizime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 11,100,000 (Njëmbëdhjetë milion e njëqind mijë) Lekë. Në lidhje me këtë pikë, Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

Për furnizime të ngjashme ndaj organeve publike:

Vertetime të leshuara nga enti publik dhe fatura tatimore shitje ku shenohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Formulimi i mësipër është në kundërshtim me pikën 4 të Nenit 27 “Kontratat e Mallrave “ të VKM 914 i cili parashikon se : Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të leshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasishtet e mallrave të furnizuara. Mënyra se si AK ka formuluar fjalinë kërkon në rastin e vërtetimit të përvojës me autoritetet shtetërore paraqitjen në mënyrë kumulative edhe të

faturës tatimore të shitjes edhe të vërtetimit të realizimit me sukses. Sa më sipër kërkojmë shtimin e lidhëzës “ose” në formulimin e bërë nga AK.

ANKESË NR. 5 Në pikën 2.3.2 të DST parashikohet se: 2.3.2. Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zotërojë dhe të paraqesë Licencën Profesionale të lëshuar nga institucione të autorizuar me ligj, në kategoritë si më poshtë: NP-3A , NS-12A, NS-13A, NS-14A. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike, Licensat profesionale duhet ti paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licença Profesionale.

Licenca e kërkuar më sipër lëshohet për kompanitë që ushtrojnë veprimtari ndërtuese zbatimi ndërkohë që objekti i prokurimit të këtij tenderi është blerje e mallrave të nevojshëm për ndërtimin e dhomës së serverave kryesisht pajisje sigurie dhe kondicioner. Nga konsultimi me VKM Nr. 943, datë 28.12.2016, i ndryshuar rezulton se:

NP-3 Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada. Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

N.S-12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit. Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

N.S-13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni. Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

N.S-14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV. Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Duke marrë në konsideratë Zërin “Punime civile të specializuara” në DST gjykojmë se kërkesa për paraqitjen e licencës me kategoritë si më sipër është e ekzagjeruar dhe diskriminuese ndaj kërkojmë heqjen e këtij kriteri.

ANKESË NR. 6

Në pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik parashikohet se: Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat ISO ose ekuivalentin e tyre si më poshtë:

- 1) ISO 9001 :2015/ ose të përditësuar “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” ;*
- 2) ISO 14001 :2015/ ose të përditësuar “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;*
- 3) ISO 18001-2007 ose 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;*

4) ISO/IEC 20001:2011 / 2018 ose të përditësuar “Për menaxhimin e shërbimeve sistemeve IT”.

5) ISO 27001 :2013 ose të përditësuar “Për menaxhimin e sigurisë së informacionit”.

Çertifikatat e mësipërme kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, dhe të jenë nëpërputhje me nenin 30 të V.K.M. Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.

Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike ISO duhen plotesuar prej secili nga operatoret ekonomike. Nuk e kuptojmë se çfarë rëndësie ka për AK ISO për menaxhimin e mjedisit apo për Menaxhimin e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë??? Kërkojmë heqjen e : ISO 14001:2015/ ose të përditësuar “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”; ISO 18001 -2007 ose 45001 :2018 “Sistemi i menaxhimit te shëndetit dhe sigurisë në punë”; ...pasi nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit !!!

ANKESË NR.7

Në pikën 2.3.6 parashikohet se: 2.3.6. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mesatarisht të paktën 30 punonjës, të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Mars 2020 - Maj 2020. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqitet: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ose nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ku te specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën Mars 2020 - Maj 2020.

Listepagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore sipas formularit E Sig-25 për periudhën e mësipërme Mars 2020 - Maj 2020.

Numri i punonjësve të kërkuar në këtë pikë është i ekzagjeruar dhe synon kufizimin e konkurrencës. Nëse numërojmë numrin e inxhinierëve dhe specialistëve që vetë AK ka kërkuar në pikën tjetër rezulton se numri total është 15. Nuk e kuptojmë pse AK duhet të dyfishojë numrin e fuqisë punëtore. Nëpërmjet kërkesës për disponimin në staf të 30 punonjësve, autoriteti kontraktor ka tejkalluar natyrën dhe përmasat e kontratës pasi një numër i tillë punonjësish është tërësisht joproporcional me objektin e prokurimit. Sjellim në vëmendjen tuaj përcaktimet ligjore se Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura. Kërkojmë që pika 2.3.6 të modifikohet si më poshtë:

2.3.6. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mesatarisht të paktën 15 punonjës, të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Mars 2020 - Maj 2020. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqitet:

ANKESË NR.8

Në pikën 2.3.7 të Kapacitetit teknik është parashikuar: Operatori Ekonomik ofertues duhet ketë pjesë të stafit të tij, minimalisht punonjësit si më poshtë:

-1 (një) inxhinier mekanik ose mekatronik i certifikuar për sistemet e kondicionimit që do të ofertojë.

-1 (një) inxhinier elektrik, ose inxhinier elektronik /informatikë, i certifikuar për sistemin e BMS që do të ofertojë.

-1 (një) inxhinier elektronik ose telekomunikacioni/informatikë i certifikuar për sistemin e Kamerave që do të ofertojë.

-1 (një) inxhinier elektronik ose telekomunikacioni /informatikë i certifikuar për sistemin e akses kontrollit që do të ofertojë.

-1 (një) inxhinier elektronik, ose telekomunikacioni/informatikë i certifikuar për Menaxhim të Shërbimeve IT (Certifikata ITIL ose ekuivalente).

-1 (një) inxhinier elektronik ose telekomunikacioni /informatikë i specializuar për ndertimin e rrjetit Data dhe fiber optike që do të ofertojë.

-2 (dy) specialist ose teknik për instalime në tension të ulët.

-1 (një) specialist ose teknik të specializuar në instalimet e sistemit të kondicionit.

-1 (një) specialist ose teknik të specializuar në instalimet e sistemit të BMS.

-1 (një) specialist ose teknik të specializuar për instalim kamerash.

-1 (një) specialist ose teknik të specializuar për akses kontroll.

-1 (një) specialist ose teknik të specializuar për sistemin e zjarrit

-1 (një) specialist ose teknike të certifikuar për instalime të rrjetit Data dhe fiber optike.

Për të vërtetuar këtë pikë, duhet të paraqitet:

Për inxhinierët: Diplomë inxhinierike, Kontratë Pune, CV, Certifikatat përkatëse dhe Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore sipas formularit E Sig-25 për periudhën Mars 2020 - Maj 2020. Për specialistët ose teknikët: Kontrate Pune, CV, Certifikatat përkatëse dhe Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore sipas formularit E Sig-25 për periudhën Mars 2020 - Maj 2020.

Të gjitha kërkesat e mësipërme janë të ekzagjeruara dhe kufizojnë pjesëmarrjen në mënyrë të pandershme në këtë tender.

Konkretisht: 1. AK kërkon inxhinier mekanik për sistemet e kondicionimit??? Në VKM 514 datë 20.09.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve" jepen këto funksione për profesionin e inxhinierit mekanik : Inxhinieri mekanik kryen studime, këshillon, dizajnon dhe drejton prodhimin e makinerive, avionëve, anijeve, impianteve mekanike dhe industrial, pajisjeve dhe sistemeve. Ai këshillon dhe drejton funksionimin e këtyre pajisjeve, mirëmbajtjen dhe riparimin. Studion dhe këshillon mbi aspektet mekanike të materialeve, proceseve apo produkteve të veçanta. Për atë kohë sa AK kërkon autorizim prodhuesi për kondicionerët rezulton që nuk është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë në staf një inxhinier mekanik për prodhimin e kondicionerëve!!! Kërkojmë heqjen e kërkesës për 1 inxhinier mekanik/mekatronik pasi është e ekzagjeruar dhe e pambështetur në nevojat konkrete të këtij prokurimi.

AK në mënyrë evasive ka kërkuar certifikime të ndryshme pa përcaktuar se nga cili institucion duhet të jenë lëshuar këto certifikata. P.SH AK kërkon që O.E të ketë në staf 1 (një) specialist ose teknik të specializuar për sistemin e zjarrit por nuk përcakton nëse ky specialist duhet të ketë një certifikatë të lëshuar nga prodhuesi i sistemeve të zjarrit apo një certifikatë të lëshuar nga MZSH. Sa më sipër, kërkojmë që AK të përcaktojë institucionin kompetent për të lëshuar certifikatat për secilën pikë. Gjithashtu AK të përcaktojë nëse do të pranohet që një individ të ketë më shumë se 2 certifikime psh. O.E të ketë në staf vetëm një inxhinier elektronik dhe ky person të ketë certifikatë edhe për sistemet BMS, sistemet e kamerave, akseseve, ITL, Data etj.

ANKESË NR. 9

Në pikën 2.3.8 përcaktohet se 2.3.8. Operatori Ekonomik ofertues për paisjet duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/ve të përkthyer në gjuhën shqipe në pjesën ku janë paraqitur të dhënat dhe karakteristikat teknike, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike, të mallrave objekt prokurimi.

Nuk e kuptojmë se çfarë dëshiron të thotë AK me pjesën : të përkthyer në gjuhën shqipe në pjesën ku janë paraqitur, të dhënat karakteristikat teknike

Në DST është përcaktuar qartë se gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe ndaj i gjithë dokumentacioni që do të paraqitet do të jetë në gjuhën Shqipe. A do të pranojë AK që një pjesë e katalogut të jetë në gjuhë kineze psh dhe vetëm pjesa e specifikimeve teknike të jetë në shqip??? Sjellim në vëmendje të AK se të gjithë dokumentat e dorëzuar në tender duhet të jenë të përkthyer dhe noterizuar sipas ligjit dhe këto parashikime nga AK shërbejnë vetëm për të krijuar konfuzion të O.E dhe për ti dhënë AK mudësinë që të jetë abuziv gjatë procesit të kualifikimit. Kërkojmë modifikimin e pikës 2.3.8 si më poshtë: 2.3.8. Operatori Ekonomik ofertues për paisjet duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/ve të përkthyer në gjuhën shqipe në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike, të mallrave objekt prokurimi.

ANKESË NR. 10

Në pikën 2.3.10 parashikohet se: 2.3.10. Operatori Ekonomik ofertues, për integrimin në BMS të paisjeve të sistemit elektrik, sistemit të kondicionim me fryrje nga poshtë, UPS, PDU-së, paneleve elektrike, matëseve të tensionit, duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton integrimin e tyre. Formulimi i këtij kriteri është evaziv dhe madje krijon përshtypjen se AK as nuk e ka idenë se çfarë kërkon . AK të përcaktojë se çfarë dokumentacioni konkret kërkon për këtë pikë!!!

Kriteret e mësipërme të kualifikimit bien në kundërshtim me: Gërmën “c” dhe “ç” të nenit 1 të LPP, i cili parashikon se qëllimi i këtij ligji është: c) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

Nenin 20 të LPP, i cili parashikon se: Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

Nenin 28/2 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për R.P.P”, përcaktohet se në Kontratat e shërbimeve: Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me afësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraldor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Në lidhje me specifikimet teknike I.S.S shpk paraqet ankesat si më poshtë:

ANKESË NR. 11

Në Shtojcën 10 Specifikimet Teknike pika 1.2 Situata Aktuale rezulton si më poshtë Ne këtu paragraf permenden disa herë pajisjet e kamerave dhe NVR neper Hecet ekzistuese. Video monitorimi ne keto objekte eshte pothuajse jashte funksionit, kjo e vertetuar me sakte dhe nga vizita e MB para disa ditesh qe u pasqyrua dhe ne media dhe ku me shume se 80% e kamerave nuk funksionojne. Ju lutem një sqarim si ka mundësi që Ju si AK kerkoni te beni nje projekt per dhomen e serverit nderkohe shumica e paisjeve fundore nuk u punojne? Kerkojme te na behet e ditur e gjithë infrastruktura ekzistuese qe keni per video monitorimin ne Digat e Vaut te Dejes dhe ne Hidrocentralet e tjera. Gjithashtu të jepet informacion nëse keto sisteme jane funksionale apo jo.

ANKESË NR.12

Në Shtojcën 10 Specifikimet Teknike pika 2.1 Objektivi i Përgjithshëm rezulton si më poshtë:

Krijimi i dhomes se serverëve (BCC-Site) sipas standarteve Teknike për KESH SH.A

Kërkojmë nga AK të na vërë në dispozicion standartet teknike për KESH sh.a !!!

(BCC-Site) Ju lutem ne baze te ligjtit te APP kerkojme per kthimin e kesaj fjalie ?

Transferimi i pajisjeve dhe linjave të komunikimit ekzistuese. Lutem sqaroni nëse kerkohet dhe transferim i pajiseve te video monitorimit ? Nëse po të jepen të dhëna të sakta në mënyrë që të kemi mundësi të llogarisim kostot.

Minimizimi i probabilitetit të mosfunktionimit të sistemeve të informacionit nga faktorë të jashtëm; Rritja e sigurisë së informacionit. Ky term qe perdorni per objektivat eshte shume evaziv. Ju kerkoni te kryeni nje investim dhe thjesht doni te minimizoni probabilitetin? Sa esht koeficienti i minimizimit?

ANKESË NR.13

Në Shtojcën 10 Specifikimet Teknike pika 4.3 “Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave” përcaktohet se: Zbatimi i projektit do të fillojë menjëherë me nënshkrimin e kontratës nga të dy palët dhe periudha e implementimit te detyrave do te jete 3 muaj nga kjo datë.

Kerkojme shtyrjen e ketij afati ne 6 muaj duke pare kushtet e vështira që ndodhet Republika e Shqiperise dhe gjithë bota. Dihet botërisht që për shkak te COVID19 prodhimi dhe transportet kane vonesa te konsiderueshme ne gjithë boten. Eshte teknikisht dhe llogjikisht e pamundur të bëhet realizimi i ketij projekti per 3 muaj nqs paisjet qe kerkohen do porositen. E vetmja mënyrë që ky projekt të realizohet me sukses brenda afatit 3-mujor ndërkohë që të gjithë shtetet e botës kanë mbyllur kufijtë është që O. E i parapercaktuar per ta fituar këtë gare ti kete produktet në magazinë?!!

ANKESË NR.14

Ne tabelen e planifikimit te buxhetit për zërta 11-15 në mënyrë skandaloze jepet emërtimi i përgjithshëm pa përshkruar se cfarë pajisjesh përmban një set:

Ju kerkoni:

11 F.V. Network (perfshi FO, CU, patchpanele dhe menaxhues kablli, set menaxhues ajri, kanalinen e verdhe, aksesori etj.)	set	1
12 F. V. Sistem i detektimit dhe flkjës se zjarrit	set	1
13 F.V. Sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit	set	1
14 F.V. Sistem CCTV (5 kamera, NVR, sëitch POE)	set	1
15 F .V. Sistem akses kontrolli	set	1

Te gjitha keto jane sisteme qe perbehen nga disa elemente te ndryshem. Kerkojme ndarjen e te gjitha ketyre elementeve ne sasi dhe jo ne set pasi nuk perlllogaritet sakte kosto.

Gjithashtu ka dhe elemente te fshehur brenda ketij seti te cilat duhet ti bëhen me dije OE.

ANKESË NR.15

Në Dst . për pikën 1 1 “Sistemi i detektimit te zjarrit” përcaktohet se: Dhoma e serverave duhet që të pajiset me sistem detektimi dhe sinjalizimi të zjarrit per te gjithë hapësiren (si per hapësiren e cila kufizohet nga dyshemeja teknologjike dhe tavani, ashtu edhe per hapësiren e

cila kufizohet nga dysHEMEJA teknologjike dhe dysHEMEJA fikse. Pajisjet e alarmit të zjarrit do të instalohen sipas rregullave dhe standarteve lokale. Për detektimin e zjarrit duhet të vendosen në dhomën e serverave detektorë temperature dhe detektorë optikë tymi. Për sinjalizimin e alarmit të zjarrit do të vendosen sirena. Ky sistem duhet të ketë afësi për t'u integruar me sistemet e tjera.

Lutem sqarimin e pikave si më poshtë: A. Kerkoni nje sistem per detektimin e zjarrit dhe nuk specifikoni cfare paisjesh do vendosen? Sa do jete sasia e detektoreve te temperatures ? Sa do jete sasia e detektoreve optik te tymit? Shkruani qe do duhen sirena ne numrin shumes... SA SIRENA ??? Ku do vendosen keto detektore ? Ku do vendosen sirenat ? Me cfare do lidhen sirenat me panelin e alarmit? Me cfare do lidhen detektoret me Panelin e alarmit? Me kabull? Me ëireless? Me radio? Kush jane specifikime teknike te paisjeseve qe do pranohen nga AK? Sa eshte sasisa e kabullit qe duhet per te lidhur paisjet? Paneli i sistemit te detektimit dhe sinjalizimit te zjarrit do kete nje cabinet dhe cfare do vendoset aty? Ku do transmetoje dhe sinjalizojë ky panel? Si shpjegohet qe nje AK ben nje projekt dhe nuk jep asnje specifikim Teknik per sistemin qe kërkon. Si e keni parashikuar fondin limit te ketij projekti kur nuk keni asnje te dhene per keto paisje qe ju kerkoni? A eshte kryer ligjerisht procedura per llogaritjen e fondit limit ? A jane te faktuara kerkesat qe u keni bere OE qe kane marre pjese ne perrlogaritjen e fondit limit ?

ANKESË NR.16

Paragrafet me poshte jane manuali i sistemit qe keni parapercaktuar per kete procedure ???

Sistemi duhet të jetë i programuar për këto skenarë:

-Stand by - Sistemi është në gatishmeri.

Në këtë gjendje sistemi nuk kryen asnjë veprim por vetëm lexon të dhënat nga detektorët zjarrit në zonat e përcaktuara më lart.

-Prealarm (Pre-activated) - Sistemi ka sinjal alarmi (Fire Alarm) nga një prej zonave të mbulimit të zjarrit (kur aktivizohet një sensor në zonën e mbrojtur nga zjarri temperature ose tym) dhe duhet të iniciojë një alarm në panelin e kontrollit, duhet të aktivizojë sirenat dhe dritat pulsuese në zonën e mbuluar nga ky sensor. Këto sinjale i dergohen dhe personelit për kontrollin dhe monitorimin e mbrojtjes nga zjarri. Në këtë gjendje nuk duhet të aktivizohet menjëherë sistemi i shuarjes së zjarrit për të shmangur alarmet “false”, qe mund te vijne si rezultat i faulteve te sitemit. Pas ndërhyrjes së operatorëve të sigurisë, në rastin e alarmeve “false”, sistemi mund të kthehet në gjendjen e tij normale nëpërmjet butonave të komandimit në panelin e kontrollit.

-Alarm (Activated) Sistemi ka sinjal alarmi nga të dy zonat e dhomës (sensore temperature dhe detektor tymi). Detektimi i zjarrit nga një sensor i dytë aktivizon “alarmin nga zjarri” dhe kalimin në fazën e shuarjes së zjarrit edhe në këtë fazë, operatorët mund të ndalojnë manualisht kalimin në procesin e shuarjes së zjarrit (në rast se zjarri mund te shuhet nëpërmjet shuarësve portabël me pluhur ose nëse kemi të bëjmë me një alarm “fals”). Sistemi i projektuar i mbrojtjes nga zjarri duhet t'i mundësojë operatorëve edhe aktivizimin manual në procesin e shuarjes së zjarrit nëpërmjet butonit përkatës në ambjent. Në këtë gjendje sistemi jep alarmin per evakuimin e ambjenteteve duke ndezur sinjalet dalje dhe duke aktivizuar alarmin e përgjithshem. Njëkohesisht behet caktivizimi i magneteve te dyerve nga sistemi i kontrollit, monitorimit dhe menaxhimit. Kerkojme rishikimin e ketyre fjalive pasi jane copy paste!

ANKESE NR.17

Në Dst përcaktohet se: *Extinguishant Release Control*. Duhet të jepet mundësia për clirimin e agjentit shuarës të zjarrit manualisht me anë të një sëitch të veçantë (një Button Push ose ekuivalent).

Butonat e Aktivizimit dhe Ndalimit Manual. Ne hyrjen e dhomes se serverave, jashte dhomes, duhet te montohen butonat e Aktivizimit Manual dhe te Ndalimit Manual te sistemit te shuarjes.

Butoni i Aktivizimit manual. Mund te perdoret nese kerkohet aktivizim i menjehershëm i sistemit te shuarjes (ne rast se vetem njeri nga dedektoret eshte aktivizuar dhe paneli ka kaluar ne gjendjen “Pre-alarm”, personeli pergjegjes mund te shtype kete buton dhe te aktivizoje manualisht sistemin e shuarjes).

Butoni i Ndalimit(ose vonimit) te aktivizimit. Mund te perdoret ne rastet kur paneli ka kaluar ne gjendje “Alarm”, por duam te vonojme ose ndalojme aktivizimin e sistemit te shuarjes pasi personeli pergjegjes veren se eshte alarm fals ose ne dhome ka rënë zjarr qe mund te shuhet ne menyra te tjera (psh. me nje fikse dore).

Lutem një përgjigje për sa më poshtë:

Kush jane specifikimet teknike te ketyre butonave?

Mund te sjellim nje buton qe ka nje Madhesi 1 mm apo nje buton qe ka nje Madhesi 10metra ?

Me cfare do lidhet me sistemin?

ANKESË NR.18

Në pikën 9.2.1 Sistemi CCTV përcaktoni se: *Dhoma e serverave duhet te pajiset me sistem CCTV dhe sistem te kontrollit te aksesit*. Brenda dhomes se serverave duhet te instalohen 5 kamera per vezhgimin e gjithë hapësirës se dhomes. Gjithashtu, dhoma e serverave duhet te pajiset me sistem kontrolli aksesi me dy readera per deren e dhomes se serverave (Brenda dhe jashte dhomes). Regjistrimi i kamerave në dhomen e serverave do të behet me ane të NVR-se lokale, ndersa kamerat do të ushqehen nëpërmjet teknologjisë POE për të evituar instalimet e rrymës elektrike. Të gjithë aksesorët e nevojshëm për montimin e kamerave duhet të jenë të përfshira. Për ushqimin e kamerave me POE duhet të instalohet nje sëitch sipas specifikimeve te percaktuara me poshte. Me poshtë janë specifikimet teknike për komponentët kryesore të sistemit CCTV.

Lutem saktësoni pikat si më poshtë: a.Kërkoni më sipër qe aksesorët duhet te jene te perfshirë.

Si mundet qe nje AK te mos japi informacion se kush jane keto aksesorë ndihmës? Ky term qe ju perdorni konfondon O.E pjesëmarrës duke mos llogaritur dot kostot pasi ju nuk përcaktoni produktet. Sa metra kabull kerkojne keto kamera per tu instaluar? A duhen kanalaina duhen? Tubo duhen? Kuti per kamerat duhen? Koka rrjeti duhen?

Karakteristikat	Vlerat specifike minimale
Numri i kanaleve hyrëse	8 kanale ose me shume
Outgoing Bandwidth	Min 150 Mbps
Rezolucioni maksimal në regjistrim	Min 12 MP
Synchron Playback	deri në 8 kanale
Formati i Videos	H.264 ose me mire
Kapaciteti i numrit të Hard-	2

disqeve	
Kapaciteti fizik i disqeve	Deri në 8 TB
HDD te përfshira	2x4TB HDD
Porta e rrjetit	Min 2x RJ-45 10/100/1000 Mbps
Portat USB	2xUSB 2.0 ose me shume; 1xUSB 3.0 ose me shume;
Temperaturat e operimit	0 deri në +45° C

Me sipër kerkoni nje NVR qe te jete minimalisht 12 MPX nderkohe qe kamerat i kerkoni jo me shume se 8 MPX. Keni Arsye? Kerkojme uljen e rezolucionit minimal te NVR nga 12 MPX ne 8 MPX. Kerkojme riformulimin e te gjitha parametrave Teknik te NVR pasi nuk jepni informacione cili do të jete procesori minimal i pranuar per NVR? Kush do jete bandwidthi ne hyrje i kesaj NVR pasi kerkoni vetem daljen? NVR duhet te kete minimalisht nje porte VGA apo nje Porte HDMI apo 10 porta ??? Nuk e kuptojmë se si AK ka marrë oferta për një projekt ku nuk janë përcaktuar as specifikimet teknike minimale!!! Kur thoni kapaciteti fizik i disqeve 8 TB kuptoni nje HDD duhet te jete 8 apo te dy 8? Cfare lloji duhet te jene HDD 2.5 apo 3.5? Kerkojme që AK minimalisht të bëjë perkthimin ne gjuhen shqipe te fjalive qe jane Anglisht dhe COPY Paste nga katalogët e operatorit të paracaktuar per të fituar këtë kete procedure.

Karakteristikat	Vlerat specifike minimale
Tipi i kameres (“Type of camera”)	Bullet
Procesori i figures (“Image Sensor”)	Progressive Scan CMOS sensor 1/2”
Rezolucioni i figures (“Resolution”)	Minimumi 3840*2160
Frekuenca e kuadrove (“Frame Rate”)	20 fps
Reduktimi i zhurmës (“Noise Reduction”)	3D DNR
Tipi i lenteve (“Lens Type”)	E Motorizuar
Gjatesia fokale (“Local length”)	2.8 ~ 12mm,
Ndjeshmeria drites në 50 IRE, (“Min. Illumination @50IRE,)	Color 0.01 lux; B/W 0 lux with IR
Ndriçimi Infra të Kuqe (“IR illuminators”)	40 m;
Rezistenca ndaj pluhurit dhe shiut	IP67
Dite/Nate (“Day/Night”)	IR cut filter
Diapazoni dinamik i djeshmerise, (Wide Dynamic range)	Po (“Yes”), min 120 dB
Formati i kompresimit të Videos	H.264 ose me mire
Dedektim i levizjes (“Motion Detection”)	Po
Pajtueshmeria e sistemit (“System support”)	ONVIF
Multi-streaming	Min. Dual stream
Temperatura e operimit (“Operating Temperature”)	-10°C - +50°C
Ushqimi (“Power”)	PoE

Aksesore per montimin	Po, sipas tipit të kamerës dhe menyres së montimit
------------------------------	--

Lutem AK të saktësojë :

Me çfare do lidhet kamera me NVR? Me wireles apo me kabull?

Nqs duhet kabell sa metra duhen ? Si do kaloje. Kerkojme te rishikoni te gjitha specifikimet e mesiperme te kamerës pasi jane vetem per nje prodhues te paracaktuar?

ANKESË NR.19

Pika 9.2.1.3 Sëitch për sistemin e kamerave parashikon se: Sëitch do të përdoret për të ushqyer me POE kamerat e instaluara per monitorimin e dhomes së serverave.

Modeli	I montueshem ne rack, 1U, aksesore te perfshira
Nderfaqet	24 RJ-45 auto-negotiating 10/100/1000 PoE+ ports
Memorja	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Min 32MB flash ▪ Min 128MB RAM ▪ Min 512 KB packet buffer
Kapaciteti/Performanca	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Switching capacity min: 50 Gbps ▪ Throughput min.: deri ne 40 Mpps ▪ Mac-Address table: Min 8000 Entries ▪ Routing Table min 32 entries
Karakteristika L2 Switch	Spanning Tree Protocol (STP) BPDU filtering Jumbo frame support VLAN support and tagging supports IEEE 802.1Q; 256 VLANs ëith a VLAN ID range 2-4093
Karakteristika L3	<ul style="list-style-type: none"> ● Static IPv4 routing ● DHCP relay ● Address Resolution Protocol (ARP)
Siguria	<ul style="list-style-type: none"> ● Advanced access control lists (ACLs) ● IEEE 802.1X and RADIUS network logins ● Secure Socket Layer (SSL) ● Port Isolation ● Automatic VLAN assignment ● Automatic denial-of-service protection ● Management passëord
QoS	<ul style="list-style-type: none"> ● 802.1p Quality of Service ● Type of Service (ToS) ● CoS based on: 802.1p priority Queues, DSCP ● Advanced Classifier based QoS ● Rate Limit

Manaxhimi	<ul style="list-style-type: none"> ● WEB with SSL (HTTPS) ● SNMP: Supports v1/v2c/v3 ● Remote Monitoring (RMON) ● FTP, TFTP, or SFTP support ● Network Time Protocol (NTP) ● Port mirroring
PoE poëer	<ul style="list-style-type: none"> ▪ 370 W PoE+
Fuqia/Ambienti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ AC Poëer Input ▪ Temperature operationale: 0 – 40 degree Celsius ▪ Lageshtira: 15% to 90%, noncondensing
Garancia	Min 1 vit

Specifikimet Teknike te sëitch jane marre COPY PASTE nga nje prodhues i paracaktuar per të fituar kete projekt.

1. *Kerkojme per kthimin ne gjuhen shqipe te ketyre specifikimeve teknike*
 2. *Kerkojme riformulimin e ketyre specifikimeve duke pare qe kerkoni ta bllokoni projektin me kete sëitch. E*
 3. *Si mundet te kerkoni nje sëitch qe do mbaje ne pune 5 kamera dhe sëitchi ka parametra per te mbajtur edhe 25 kamera apo 100? Si ta quajme kete fakt shperdorim fondesh ne kohe Pandemie apo bllokim projekti me nje prodhues te paracaktuar?*
 4. *Per cfare kerkohen porta 1000 Mbps kur kamerat jane 100 mpbs???*
 5. *Si e shpjegoni qe ju si njesi per pergatitjen e kritereve ne disa produkte vendosni kritere deri ne detaje ku vetem nje operator i permbush dhe ne disa produkte nuk vendosni asnje kriter?*
 6. *Si shpjegohet nga ana e AK qe disa specifikime teknike jane ne shqip dhe disa te tjera anglisht? Të gjitha ankesat e listuara më sipër tregojnë haptazi se kemi të bëjmë me një përpjekje të AK për të paracaktuar fituesin e kësaj procedure duke sajuar një tender të dyshimtë dhe duke vendosur kritere kufizuese e përjashtuese flagrante.*
- Në lidhje me këtë fakt dëshirojmë të sjellim në vëmendje të AK kërkesat e legjislacionit të prokurimeve si më poshtë: Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. [...]*

II.3. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, konstatohet se autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën, operatorit ekonomik ankimues “Integrated Security Solutions” sh.p.k., me anë të shkresës nr.1836/3prot., datë 23.06.2020, duke e pranuar pjesërisht atë, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“[...]1) Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për ndarjen e procedurës në lote pasi kërkohen mallra të fushave të ndryshme brenda të njëjtit objekt Komisioni relaton: Objekti i kontratës është : “Realizimi i dhomës së Serverave (BCC SITE) në Vaun e Dejës dhe krijimi i kushteve teknike në HEC Vau i Dejës, HEC Koman dhe HEC Fierzë” dhe nuk është blerje mallrash, punë apo shërbime homogjene. Realizimi i saj kërkon punime dhe produkte specifike për dhoma të tilla që të operojnë së bashku në mënyre të tillë që të krijojnë kushtet e nevojshme për instalimin e pajisjeve në BCC Site (Business Continuity Site Dhoma e Vazhdimësisë së Proceseve). Si e tillë ajo nuk mund të ndahet pasi kërkohet që OE duhet të marrë përsipër të furnizojë, instalojë dhe të bëjë të mundur integrimin, monitorimin dhe komandimin e pajisjeve të kërkuara brenda sipërfaqes së venë në dispozicion nga KESH SH.A për të krijuar kushtet e nevojshme për instalimin e serverave dhe pajisjeve të tjera të nevojshme që lejojnë vazhdimësinë e punës në korporatë pa humbje të proceseve dhe të të dhënave. Për me tepër, e njëjta procedurë është përdorur edhe për gjithë institucionet e tjera të rëndësishme. Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

2) Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për përcaktimin e nën kontraktimit në DTS Komisioni relaton: Në zbatim të nenit 75, pika 2 dhe 3, të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar ku ndër të tjera citohet se: Në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohet qartë nëse lejohet ose jo nën kontraktimi, si dhe nëse autoriteti kontraktor do t'i bëjë pagesa të drejtpërdrejta nën kontraktorit, si dhe në asnjë rast nën kontraktimi nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës së kontratës, Komisioni pasi u njoh me objektin e prokurimit dhe specifikimet teknike, duke marrë në konsideratë faktin se ky prokurim ka një ndërthurje mallrash të ndryshëm, gjykon se në funksion të zgjerimit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik duhet të lejohet mundësia e nën kontraktimit të operatorëve të tjerë. Theksojmë se pavarësisht se lejohet nën kontraktimi, sipas ligjit, përgjegjësia për plotësimin e kriterëve të kualifikimit i mbetet Operatorit Ekonomik, apo Bashkimit të Operatoreve Ekonomike që garojnë. Bazuar sa me sipër, Komisioni vlerëson përcaktimin në DT të lejimit të nën kontraktimit dhe përcaktimit të përqindjes së nën kontraktimit jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Në lidhje me këtë pretendim, Njësia e Prokurimit të modifikojë pikën 2.14.1 të DTS me anë të shtojcës të modifikimit të DT. Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron.

3) Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për përcaktimin në DTS të plotësimin të fushave në lidhje me standardet e përgatitura nga AKSHI Komisioni relaton: Në lidhje me përcaktimin në DTS të plotësimin të fushave në lidhje me standardet e përgatitura nga AKSHI, Komisioni vlerëson se për këtë pretendim, Njësia e Prokurimit të plotësojë dhe modifikojë pikën 2.15 dhe 2.16 të DTS me anë të shtojcës të modifikimit të DT. Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron.

4) Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për kriterin teknik 2.3.1 “Për furnizime të ngjashme ndaj organeve publike: Vërtetime të lëshuara nga enti publik dhe fatura tatimore shitje ku shenohen datat shumë dhe shërbimet e realizuara” në shtimin e lidhëzës ose në këtë kriter Komisioni relaton: Në zbatim të nenit 27, pika 4, të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar ku ndër të tjera citohet se: Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një

ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, Komisioni sqaron se kriteri i kërkuar nga AK në të cilën janë përfshirë si vërtetimet e lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së mëparshme të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Megjithatë, Komisioni vlerëson se për këtë pretendim, Njësia e Prokurimit të modifikojë pikën 2.3.1 të DTS me anë të shtojcës të modifikimit të DT, si më poshtë :

2.3.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e hapjes së tenderit, furnizime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë jo më të vogël se 11,100,000 (Njëmbëdhjetë milion e njëqind mijë) Lekë. Në lidhje me këtë pikë, Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë : Për furnizime të ngjashme ndaj organeve publike: Vërtetime të lëshuara nga ent publik ose/dhe fatura tatimore shitje ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Ose Për furnizime të ngjashme ndaj privateve: Fatura tatimore shitjesh ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Sa më sipër, pretendimi i ankimesit qëndron.

5) Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për heqjen e kriterit teknik 2.3.2. Operatori Ekonomik ofertues në realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të zotërojë dhe të paraqesë Licencën Profesionale të lëshuar nga institucione të autorizuar me ligj, në kategoritë si më poshtë: NP-3A NS-12A NS-13A NS-14A. Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomike Licencat profesionale duhet të paraqesë operatorit ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licenca Profesionale Komisioni relaton: Objekti prokurimit është deklaruar mallra pasi siç parashikohet në ligj, kur procedura parashikon edhe punë, edhe mallra, edhe shërbime, deklarohet cili nga zërat zë peshën më të madhe. Në këtë rast mallrat zënë zërin me të madh dhe procedura është zgjedhur mallra. Pavarësisht kësaj, kjo procedurë parashikon punime të specializuara duke filluar nga kafazi i Faradejit, veshje të mureve dhe tavanit me kartonxhes antizjarr, trajtim të dyshemesë, sistem kondicionimi, sistem UPS-je, Panele elektrike sipas fuqive të përcaktuara, Rrjet kompjuterik të paraterminuar nga fabrika, etj. Për të garantuar punimet e cituara, Autoriteti Kontraktor bazuar në ligj kërkon nga Operatori Ekonomik apo Bashkimi i Operatoreve Ekonomik të jenë të licensuar sipas ligjit për punimet që kërkohen.

Sa më sipër, pretendimi i ankimesit nuk qëndron.

6) Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për heqjen nga kriteri teknik 2.3.3 të ISO 14001:2015 ose të përditësuar "Sistemi i menaxhimit të mjedisit" dhe ISO 18001 - 2007 ose 45001 :2018 "Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë" Komisioni relaton: Duke theksuar se është e drejta ligjore e Autoritetit Kontraktor të vendosë kriteret në përputhje me objektin e prokurimit, Komisioni i konsideron të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit ISO-t që pretendohen që të hiqen, pasi Operatori Ekonomik apo Bashkimi i Operatoreve Ekonomik që do të kryejë punimet e parashikuara në këtë procedurë duhet t'i kryej ato duke respektuar siç parashikohet në ligj mjedisin, si dhe duke respektuar shëndetin dhe sigurinë në punë. Komisioni, nga rekomandimi i dhënë nga APP, vendos që Njësia e Prokurimit të modifikojë pikën 2.3.3 të DTS me anë të shtojcës të modifikimit të DT, si më poshtë :

2.3.3. Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat ISO ose ekuivalentin e tyre si më poshtë:

1) ISO 9001:2015/ ose të përditësuar "Sistemi i menaxhimit të cilësisë" ;

- 2) ISO 14001:2015/ ose të përditësuar “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;
- 3) ISO 18001-2007 ose 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;
- 4) ISO/IEC 200001:2011 / 2018 ose të përditësuar “Për menaxhimin e shërbimeve sistemeve IT”.
- 5) ISO 27001:2013 ose të përditësuar “Për menaxhimin e sigurisë së informacionit”.

Çertifikatat e mësipërme kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, dhe të jenë në përputhje me nenin 30 të V.K.M. Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar. Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatat ISO sipas zëra ve të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes. Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

7) Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “ISS” sh.p.k për kriterin teknik 2.3.6 për punësimin mesatar të kerkuar 30 punonjës dhe modifikimin e këtij kriteri në të paktën 15 punonjës Komisioni relaton: Ky kriter vihet në përputhje me nenin 46 pika 1/8 e LPP Ku citohet se a) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Konkretisht : Komisioni pasi u njoh me objektin e prokurimit dhe specifikimet teknike, duke marrë në konsideratë faktin se ky prokurim ka një ndërthurje mallrash /shërbime/punime, e konsideron minimale që Operatori Ekonomik apo Bashkimi i Operatoreve Ekonomike që do të marrë pjesë në këtë procedurë të ketë të paktën 30 punonjës për të kryer objektin e procedurës. Janë kërkuar 15 punonjës staf inxhiniero-teknik të certifikuar dhe specializuar për zërat kryesore dhe që do të udhëheqin punimet, por nga ana tjetër AK nuk ka kërkuar punonjës të specializuar për shume zëra si për kafazin e faradejit, punimet civile, dyshtimet teknologjike, kanalinën e verdhë, Raket, PDU-të, trajnimin etj. Pa llogaritur që një shoqëri ka në administratë punonjës finance, magazinierë, shoferë, etj, duke llogaritur punimet e tjera që OE janë duke kryer, riskun e ndikimit nga pandemia ekzistuese etj, theksojmë se kërkesa për 30 punonjës për këtë objekt prokurimi konsiderohet minimale. Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

8) Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “ISS” sh.p.k për heqjen nga kriteri teknik 2.3.7 të 1 (një) inxhinieri mekanik ose mekatronik i certifikuar nër sistemet e kondicionimit që do të ofertojë dhe certifikimet e inxhinierëve, Komisioni relaton: Ky kriter vihet në përputhje me nenin 46 pika 1/B e LPP Ku citohet se a) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Konkretisht : 1) Autoritetit Kontraktor ka kërkuar staf tekniko-inxhinierik të specializuar dhe certifikuar për pajisjet dhe punimet që do të kryhen. Kërkesa e ankimuesit për heqjen e inxhinierit mekanik/mekatronik pasi është e ekzagjeruar dhe e pambështetur në nevojat konkrete të këtij prokurimi, është krejtësisht e pabazuar. Sistemi i kondicionimit i dhomës të serverave është një nga komponentët më të rëndësishëm të kesaj procedure. Për këtë arsye janë kërkuar 2 (dy) kondicionerë me fryrje nga poshtë për dhomat e serverave pasi nëse njeri nuk do të punojë tjetri duhet të hyjë menjëherë në punë, për të garantuar vazhdimin e punës. Nëse sistemi i ftohjes dështon, e vetmja zgjidhje është fikja e menjëhershme e gjithë serverëve dhe pajisjeve të instaluar në dhomën e serverëve pasi

temperatura ngrihet menjëherë. Pra, sistemi i kondicionimit është nga sistemet më të rëndësishme të dhomave të serverave. Nga ana tjetër, sistemi kondicionimit klasifikohet tek sistemet mekanike, dhe AK ka kërkuar ose inxhinier mekanik ose mekatronik për të lejuar një gamë sa më të gjerë inxhinieresh. Ne lidhje me argumentin se autorizimi i prodhuesit/distributorit për sistemin e kondicionerëve zëvendëson kërkesën për inxhinierin mekanik/mekatronik të certifikuar nga prodhuesi nuk qëndron, pasi është tjetër gjë që një operator te jete i autorizuar të shesë dhe tjetër gjë që ai është i aftë të instalojë dhe konfigurojë këto pajisje. Përkundrazi përvoja tregon se për të dhëne garancinë prodhuesi kërkon që instalimi të bëhet nga staf i specializuar për të fituar garancinë. Pretendimi i ankimuesit për heqjen e inxhinierit mekanik/mekatronik nuk qëndron.

2) Në lidhje me kërkesën që AK të përcaktojë institucionin kompetent për të lëshuar certifikatat për secilën pikë, Komisioni sqaron se specialist apo teknik i specializuar do të pranohet cdo inxhinier apo teknik që disponon një certifikatë të lëshuar në fushën përkatëse (për të cilën kërkohet në kriteret e kualifikimit) nga institucionet përkatëse kompetente kombëtare/ndërkombëtare, ose çdo certifikatë e lëshuar për specialistin (inxhinierin apo teknikun) nga kompania/kompanitë prodhuese të sistemeve që do të instalohen. Megjithatë, Komisioni vlerëson se për këtë pretendim, Njësia e Prokurimit të modifikojë pikën 2.3.7 të DTS me anë të shtojcës të modifikimit të DT.

3) Ne lidhje me kërkesën që AK të përcaktojë nëse do të pranohet që një individ të ketë më shumë se 2 (Dy) certifikime psh. O.E të ketë në staf vetëm një inxhinier elektronik dhe ky person të ketë certifikatë edhe për sistemet BMS, sistemet e kamerave, akseseve, ITIL, Data etj, sqarojmë se edhe pse është e pa arsyeshme që vetëm një inxhinier të ketë gjithë specializimet/certifikimet e kërkuara, nisur nga fakti që një inxhinier/specialist mund të ketë më shumë se 1 (një) specializim/certifikim, për të lejuar sa më shumë konkurrencë, AK do të lejojë që një inxhinier mund të ketë deri në dy certifikime. Kjo lejon konkurrencën, por gjithashtu kufizon mundësinë dhe varësinë nga një inxhinier i vetëm.

Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

9) Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për kriterin teknik 2.3.8 "Operatori Ekonomik ofertues për pajisjet duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/ve të përkthyer në gjuhën shqipe në pjesën ku janë paraqitur të dhënat dhe karakteristikat teknike në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi" Komisioni relaton: Nisur nga fakti që gjuha teknike e pranuar ndërkombëtarësh është gjuha angleze, dhe me qëllimin për tu ardhur në ndihmë të gjithë operatorëve ekonomik, për të bërë të mundur uljen e kostove të përkthimit të katalogëve nga AK është kërkuar që të përkthehet në gjuhën shqipe vetëm pjesët ku janë paraqitur të dhënat dhe karakteristikat teknike, të mallrave objekt prokurimi. Por kjo kërkesë nuk e kufizon ofertuesin ta paraqesë materialin e mësipërm të përkthyer të gjithë në gjuhën shqipe.

Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

10) Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për kriterin teknik 2.3.10 Operatori Ekonomik ofertues për integrimin në BMS të paisjeve të sistemit elektrik sistemit të kondicionimt me fryrje nga poshtë, UPS, PDU-së, paneleve elektrike, matëseve të tensionit, duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton integrimin e tyre. Autoriteti Kontraktor në kriteret teknike ka kërkuar : 2.3.10. Operatori Ekonomik ofertues, për integrimin në BMS të paisjeve të

sistemit elektrik, sistemit të kondicionimt me fryrje nga poshtë, UPS, PDU-së, paneleve elektrike, matëseve të tensionit, duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton integrimin e tyre. Në rast se produktet janë të prodhuesve të ndryshëm, ofertuesit i duhet të paraqesë vërtetim nga secili prodhues, si ai i sistemeve ashtu dhe nga prodhuesi i BMS për integrimin e tyre. Mos paraqitja e vërtetimeve nga cdo prodhues është kusht për skualifikim. Bazuar sa më sipër, Komisioni sqaron se në lidhje me pikën 2.3.10 kërkohet integrimi në BMS të paisjeve të sistemit elektrik, sistemit të kondicionimt me fryrje nga poshtë, UPS, PDU-së, paneleve elektrike, matëseve të tensionit. Në rast se BMS do të jetë e të njëjtës markë/prodhuesi me një nga sistemet e kërkuara, do të pranohet vërtetimi i prodhuesit të BMS që ky sistem integrohet në BMS. Në rast se BMS do të jetë e një marke/prodhuesi të ndryshëm nga sistemi që kërkohet të integrohet do të pranohet si dokumentacion vërtetimi nga të dy prodhuesit, si nga prodhuesi i BMS-së ashtu dhe nga prodhuesi i sistemit që do të integrohet. Në këtë rast nuk do të pranohet si i vlefshëm vërtetimi nga vetëm një prodhues. Psh, nëse BMS dhe UPS janë të të njëjtit prodhues do të pranohet vërtetimi nga prodhuesi i vetëm. Nëse sistemi i kondicionimit është i ndryshëm nga ai i BMS, në këtë rast kërkohet nga prodhuesi i BMS se kondicioneri prodhim i prodhuesit përkatës integrohet në sistemin e tij, si dhe vërtetimi i prodhuesit të kondicionerit që sistemi tyre integrohet në BMS-në e prodhuesit përkatës. Vërtetimet duhet të përmbajnë përvec informacionit të integritetit: emrin e prodhuesit, emri i personit të autorizuar nga prodhuesi, të dhëna mbi kompaninë si : numri i telefonit të prodhuesit, adresë e-mail.

Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k, për specifikimet teknike, Komisioni relaton:

11) Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për pajisjet e kamerave dhe NVR nëpër HEC -et ekzistuese, Komisioni relaton: Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k, për pajisjet e kamerave dhe NVR nëpër HEC-et ekzistuese, Komisioni sqaron se ky pretendim është jashtë objektit të kësaj procedure. Kjo procedurë prokurimi ka të bëjë me krijimin e dhomës së serverave për vazhdueshmërinë e shërbimeve në KESH SH.A. Nga vetë fjala dhoma e serverave ka të bëjë me instalimin e serverave, storage dhe shumë pajisje të tjera që duhet të garantojnë vazhdimësinë e punës në rast të një difekti të mundshëm në site-in primar të KESH.

Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

12) Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për pikën 2.1 "Objektivi i Përgjithshëm" Komisioni relaton : Konkretisht : 1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për standartet teknike termin BCC-Site, për transferimin e pajisjeve dhe linjave të komunikimit ekzistuese sqarojmë : Bëhet fjalë për krijimin e dhomës së serverave për vazhdueshmërinë e shërbimeve (BCC-Site) sipas gjithë standarteve teknike për Institucion KESH. Për Standartet teknike për ndërtimin e dhomës së Serverave sipas ligjit, ankimuesi duhet ti referohet standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare. BCC-Site është term teknik ndërkombëtar i njohur nga cdo aktor i kësaj fushe. BCC është shkurtim i Business Continuity Center Site e cila përkthet Qendra e Vazhdimësisë së Shërbimeve. Në lidhje me transferimin e pajisjeve dhe linjave të komunikimit ekzistuese, cdo informacion jepet në mënyrë të detajuar në paragrafët 9.4, Instalimi i FO midis dy rack në HEC Vau i Dejës dhe 9.5. Spostimi i pajisjeve. "Transferimi i pajisjeve dhe linjave të komunikimit ekzistuese" i referohet instalimit të një fibre

optike me 24 fije midis dy rack që ndodhen në një distancë prej rreth 500 m nga njëri-tjetri dhe terminimit në patch panel FO i kësaj fibre me konektorë SC, si edhe spostimin fizik te pajisjeve ne paragrafin 9.5. Theksojme se OE është përgjegjës vetëm për çmontimin edhe ri-instalimin në rack te pajisjeve dhe etiketimin e tyre. Nuk nevojitet transferim i linjave te pajisjeve te video-monitorimit.

Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

13) Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për afatin e përcaktuar Komisioni relaton : Autoriteti Kontraktor ka parashikuar se periudha kohore prej 3 muajsh është e mjaftueshme për realizmin e projektit. Autoriteti Kontraktor ka përllogaritur një periudhë 30-45 ditore për porosinë edhe lëvrimin e mallrave, 20-40 ditë kryerja e instalimeve edhe konfigurimeve në site si dhe 5 ditë në përfundim të projektit për dorëzimin e projektit. Lidhur me faktin e COVID 19, theksojmë se as në Shqipëri dhe as në ndonjë vend të Evropës apo botës nuk është pezulluar biznesi dhe nuk ka kufizime për lëvizjen e mallrave. Gjithsesi, nëse situata bëhet me kritike, kontrata parashikon shtyrje për shkak të forcave madhore.

Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

14) Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k në tabelën e planifikimit të buxhetit për zërat "11 -15", Komisioni relaton: Për zërat 11-15, është përshkruar në mënyrë të detajuar se çfarë përmban secili zë, përkatësisht në paragrafët e DT:

9.1.7.2. Network

9.1.8.1.1. Sistem automatik i Fikjes zjarrit me gas te paster

9.1.8.1.2. Sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit

9.2.1. Sistemi CCTV

9.2.2. Sistemi i kontrollit te aksesit (access Control)

Arsyeja që këto zëra kërkohen si "set" është sepse AK është i interesuar për zgjidhje totale nga ana e operatorit ekonomik. AK për të mos përfshiruar asnjë propozim, nuk ka renditur një list produktesh të parapërcaktuar, por i ka lenë dorë të lirë OE të propozoni zgjidhjen tuaj më të mirë teknike dhe ekonomik që plotëson specifikimet e kërkuara. Në dokumentin e tenderit janë dhënë se çfarë përmban cdo set, por janë dhenë sipas propozimit të AK sasitë dhe gjatësitë të kablllove të paraterminuar, por theksohet që gjatësitë janë sipas plan vendosjes të AK, Operatori ekonomik është i lirë të beje zgjidhjen e tij dhe të përcaktojë vete gjatësitë. Citojmë, psh nga zëri 11: Kabllot Bakër të Para Terminuar. Kabllot e Bakrit Ethernet duhet të jenë të para-terminuar në gjatësitë e duhura në fabrikë dhe do të jenë të para-terminuara me koka RJ 45 Cat. 6A. Karakteristikat teknike të tyre mund të përmbliidhen si më poshtë: Kabllo të para-terminuara me konektorë RJ 45 të kategorisë Cat.6A ISO të skermuar. Materiali: Bakër, Twisted Pair, i skermuar (S/FTP), Cat.6A Gjatësitë e kablllove për lidhjen midis rack-eve:

Pre-Trem x6 RJ45-RJ45 Cat 6A LSZH F/FTP R1-R2 - 7 ml

Pre-Term x6 RJ45 RJ45 Cat 6A LSZH F/FTP R1-R2 - 7 ml

Pre-Term x6 R145 RJ45 Cat 6A LSZH F/FTP R1-R3 - 8 ml

Pre-Term x6 RJ45 RJ45 Cat 6A LSZH F/FTP R1-R3 - 8 ml

Pre-Term x6 RJ45 RJ45 Cat 6A LSZH F/FTP R1-R4 - 9 ml

Pre-Term x6 RJ45 RJ45 Cat 6A LSZH F/FTP R1-R4 - 9 ml

Karakteristika e kabllit: Kabell 6x4 çifte (pair) Zjarr durues, pa halogen LSZH/LSOH

Shenim: Te gjitha gjatesite e mesiperme te kabllave jane llogaritur referuar planimetrise ne Fig. 2. Kontraktori eshte pergjegjes per percaktimin e gjatesive te sakta te kabllave ne varesi te zgjidhjes qe do ofertoje. Për ti dhenë përgjigje edhe pyetjes së dytë, nëse ka elemente të fshehur brenda këtij seti të cilat duhet ti bëhen me dije OE, kërkesa është bërë e tillë që cdo operator ekonomik të mund të bejë zgjidhjen e tij teknike që përmbush kërkesat e AK dhe të jap njëkohësisht ofertën e tij më ekonomike.

15) Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për Sistemin e dedektimit të zjarrit Komisioni relaton: Autoriteti Kontraktor ka shpjeguar qartë se dhoma e serverave duhet që të pajiset me sistem detektimi dhe sinjalizimi të zjarrit për të gjithë hapësirën (si për hapësirën e cila kufizohet nga dyshemeja teknologjike dhe tavani, ashtu edhe për hapësirën e cila kufizohet nga dyshemeja teknologjike dhe dyshemeja fikse. Pajisjet e alarmit të zjarrit do të instalohen sipas rregullave dhe standarteve lokale. Për detektimin e zjarrit duhet të vendosen në dhomën e serverave detektorë temperature dhe detektorë optikë tymi. Për sinjalizimin e alarmit të zjarrit do të vendosen sirena. Ky sistem duhet të ketë aftësi për t'u integruar me sistemet e tjera.

Konkretisht :

A. Kerkoni nje sistem per detektimin e zjarrit dhe nuk specifikoni cfare paisje do vendosen?

Ne DT jane shpjeguar fare qarte se cfare kerkohet nga sistemi detektimit dhe fikjes se zjarrit. Me poshte edhe nje here specifikimet e dhena ne DT. Kerkohet panel i dedektimit dhe fikjes se zjarrit me gjithë pajisjet dhe aksesoret e nevojshem te pershkruar.

1.1.1.1.1. Sistem automatik i fikjes zjarrit me gas te paster

Sistemi i detektimit te zjarrit

Dhoma e serverave duhet që të pajiset me sistem detektimi dhe sinjalizimi të zjarrit për të gjithë hapësirën (si për hapësirën e cila kufizohet nga dyshemeja teknologjike dhe tavani, ashtu edhe për hapësirën e cila kufizohet nga dyshemeja teknologjike dhe dyshemeja fikse. Pajisjet e alarmit të zjarrit do të instalohen sipas rregullave dhe standarteve lokale. Për detektimin e zjarrit duhet të vendosen në dhomën e serverave detektorë temperature dhe detektorë optikë tymi. Për sinjalizimin e alarmit të zjarrit do të vendosen sirena. Ky sistem duhet të ketë aftësi për t'u integruar me sistemet e tjera.

Sistemi i fikjes se zjarrit

Sistemi duhet të bazohet në një panel kontrolli kryesor të pavarur dhe me burim ushqimi nga bateria në rast të shkeputjeve të energjisë. Sistemi duhet të jetë i pajisur me pajisje sinjalizuese alarmi të dëgjueshme dhe të shikueshme të cilet duhet të montohen jashtë dhomave të monitoruara.

Butoni i aktivizimi dhe çaktivizimit të alarmit duhet të montohet brenda dhomës së serverave. Nje sinjalistike per alarmin e zjarrit (psh. "Stop Gaz") gjithashtu duhet të montohet në hyrje të derës se dhomës së serverave.

Duke qenë se në këto ambjente akomodohen pajisje elektrike dhe elektronike, si agjent për shuarjen e zjarrit duhet të perdoret gaz NOVEC ose ekuivalent (me perjashtim te gazrave jo te paster dhe imitime), i cili ruhet ne cilindra ne temperature dhome ne gjendje te lenget dhe shkarkohet ne ambjent ne momentin e aktivizimit si gaz.

Sistemi duhet të jetë i programuar për këto skenarë:

- **Stand by** - Sistemi është në gatishmeri.

Në këtë gjendje sistemi nuk kryen asnjë veprim por vetëm lexon të dhënat nga detektorët e zjarrit në zonat e përcaktuara më lart.

- **Prealarm** – (**Pre-activated**) Sistemi ka sinjal alarmi (**Fire Alarm**) nga një prej zonave të mbulimit të zjarrit (kur aktivizohet një sensor në zonën e mbrojtur nga zjarri-temperature ose tym) dhe duhet të iniciojë një alarm në panelin e kontrollit, duhet të aktivizojë sirenat dhe dritat pulsuese në zonën e mbuluar nga ky sensor. Këto sinjale i dergohen dhe personelit për kontrollin dhe monitorimin e mbrojtjes nga zjarri.

Në këtë gjendje nuk duhet të aktivizohet menjëherë sistemi i shuarjes së zjarrit për të shmangur alarmet “false”, qe mund te vijne si rezultat i faulteve te sitemit. Pas ndërhyrjes së operatorëve të sigurisë, në rastin e alarmeve “false”, sistemi mund të kthehet në gjendjen e tij normale nëpërmjet butonave të komandimit në panelin e kontrollit.

- **Alarm** – (**Activated**) Sistemi ka sinjal alarmi nga të dy zonat e dhomes (sensore temperature dhe detektor tymi). Detektimi i zjarrit nga një sensori i dytë aktivizon “alarmin nga zjarri” dhe kalimin në fazën e shuarjes së zjarrit; edhe në këtë fazë, operatorët mund të ndalojnë manualisht kalimin në procesin e shuarjes së zjarrit (në rast se zjarri mund te shuhet nëpërmjet shuarësve portabël me pluhur ose nëse kemi të bëjmë me një alarm “fals”). Sistemi i projektuar i mbrojtjes nga zjarri duhet t’i mundësojë operatorëve edhe aktivizimin manual në procesin e shuarjes së zjarrit nëpërmjet butonit përkatës në ambjent. Në këtë gjendje sistemi jep alarmin per evakuimin e ambjenteve duke ndezur sinjalet dalje dhe duke aktivizuar alarmin e përgjithshem. Njëkohesisht behet caktivizimi i magneteve te dyerve nga sistemi i kontrollit, monitorimit dhe menaxhimit.

Pas një kohe relativisht të shkurtër (e cila duhet të përcaktohet nga administratori i sistemit) kohë e mjaftueshme për evakuimin e personelit, nëse ka, behet aktivizimi i paisjes për fikjen e zjarrit.

Pas aktivizimit të fazes së shuarjes së zjarrit dhe shuarjes së tij dhe para se personeli të futet përsëri në ambjentet ku është gjeneruar gazi duhet të kryhet ajrimi i detyruar i ambjentit, në të cilat është aktivizuar sistemi i mbrojtjes nga zjarri, për të evituar dëmtimin shëndetësor të personelit.

Sistemi i dedektimit dhe shuarjes se zjarrit duhet te kete komponentet e meposhtem:

- Paneli i Kontrollit
- Detektorët e tymit dhe të temperaturës
- Cilinder me agjentin e shuarjes
- Pajisjet e Sinjalizimit (Alarmit)
- Butonat e Aktivizimit dhe Ndalimit Manual
- Tubat dhe nozolat e shkarkimit

Paneli i kontrollit

Nga pikepamja llogjike ky panel duhet te jete i ndare ne zonen e hyrjeve (mbledhja e sinjaleve hyrese nga dedektore ose butona qe aktivizojne nje alarm), dhe ne zonen e daljeve (gjenerimi i sinjaleve nepermjet sirenave te alarmit dhe aktivizimi i shuarjes).

Paneli i kontrollit duhet të jetë i pozicionuar ngjitur me hyrjen kryesore ose brenda dhomës së serverave. Aktivizimi i lëndës shuarëse mund të konfigurohet për të aktivizuar nga çdo kombinim i inpleteve të zonave të mbulimit.

Paneli duhet të ketë bateri backup për të siguruar vazhdimësinë e funksionit të tij edhe në rast se mungon energjia kryesore e tij.

Dedektor Tymi & Temperature

Te këne shperndarje te tille qe te mbulojne te gjithë hapësirën e dhomes se serverave. Te jene ne perputhje te plote me sistemin e panelit te kontrollit.

Sirenat

Duhet te perdoret nje sirene me sinjalizues (autoparlant dhe/ose tabele sinjalizimi) ne hyrje te dhomes se serverave ku duhet te implementohet ky sistem. Sirena duhet te jete ne perputhje te plote me sistemin e panelit te kontrollit.

Extinguishant Release Control

Duhet të jepet mundësia për clirimin e agjentit shuarës të zjarrit manualisht me anë të një sëitch të veçantë (një Button Push ose ekuivalent).

Butonat e Aktivizimit dhe Ndalimit Manual

Ne hyrjen e dhomes se serverave, jashte dhome, duhet te montohen butonat e Aktivizimit Manual dhe te Ndalimit Manual te sistemit te shuarjes.

Butoni i Aktivizimit manual

Mund te perdoret nese kerkohet aktivizim i menjehershëm i sistemit te shuarjes (ne rast se vetem njeri nga dedektoret eshte aktivizuar dhe paneli ka kaluar ne gjendjen “Pre-alarm”, personeli pergjegjes mund te shtype kete buton dhe te aktivizojë manualisht sistemin e shuarjes).

Butoni i Ndalimit (ose vonimit) te aktivizimit

Mund te perdoret ne rastet kur paneli ka kaluar ne gjendje “Alarm”, por duam te vonojme ose ndalojme aktivizimin e sistemit te shuarjes pasi personeli pergjegjes verën se eshte alarm fals ose ne dhome ka rënë zjarr qe mund te shuhet ne menyra te tjera (psh. me nje fikse dore).

Butonat duhet te jene ne perputhje te plote me sistemin e panelit te kontrollit.

Cilindri me agjent shuares

- a) Cilindri duhet te kete perberje celiku. Çdo cilindër që mund të instalohet duhet të testohet presioni në një presion provë me te lartë se presioni i punës.
- b) Cilindri duhet te respektojë normat e percaktuara ne NFPA2001 (National Fire Protection Association)
- c) Cilindri duhet të montohet dhe të lidhet në mënyrë të sigurtë.
- d) Kerkohet që mbi cilindër të shënohen informacione si psh:
 - i) Kapaciteti Volume (lt) dhe dendësia e mbushjes
 - ii) Pesha neto (kg) e cilindrit.
 - iii) Sasia e shuarjen që përmban (Kg)
 - iv) Pesha bruto (kg)
 - v) Presioni maksimal i lejuar.

Valvula e Shkarkimit

Valvula e cilindrit duhet te mundesojë rrjedhje te shpejte, qe ne rast aktivizimi te alarmit te beje te mundur shkarkimin e cilindrit ne me pak se 15 sekonda. Valvula e cilindrit duhet te mundesojë aktivizimin me ane te lidhjes elektrike, me aktivizues pneumatik, ose manual duke ushtruar presion mbi pistonin e cilindrit.

Sprucatorët e gazit në dalje

Sprucatorët e daljes së gazit duhet të jenë prej alumini për të parandaluar korredimin. Duhet të jenë nga i njëjti prodhues me atë të fikjes së zjarrit me gas.

Agjenti Shuarës

- a) Agjenti Shuarës duhet të jetë i pastër (Novec ose ekuivalent, por në asnjë mënyrë nuk duhet përdorur kopje të tyre dhe gaze jo të pastër) - avullon shpejt dhe pa lënë mbetje, nuk demton pajisjet elektronike.*
- b) Duhet të mos shkaktojë dëmtime anësore në ambjent në rast klirimi (të sigurojë mbrojtjen e pajisjeve elektronike)*
- c) Duhet të jetë projektuar volumetrik*
 - Instalimet duhet të behen në përputhje me rekomandimet dhe standardet e prodhuesit.*
 - Në fund të instalimit personeli përgjegjës për Dhomen e Serverave duhet të trajnohet për përdorimin e sistemit.*
 - Projekti i sistemit me agjentin shuarës të ofruar në zgjidhje duhet të jetë testuar/simuluar nga një softëare i certifikuar nga vete prodhuesi. Pas implementimit dhe testimit të sistemit, këto dokumenta duhet të dorëzohen autoritetit.*

Manualet e përdorimit dhe studimi (projekti) i kryer me softëare nga prodhuesi duhet të dorëzohen së bashku me planvendosjen e komponenteve në dhomen e serverave në përfundim të realizimit të projektit

B. Sa do të jetë sasia e detektoreve të temperaturës ?

Në DT e tenderit është dhënë sipërfaqja e dhomes, planimetria e saj, një planvendosje e gjithë pajisjeve. Nga OE kërkohet zgjidhje e plote për të gjithë elementet sipas pajisjeve që do të ofrohen nga Operatori përfshi dhe sistemin e dedektimit. Në lidhje me sensorët e detektoreve të temperaturës OE, në bazë të sistemit të propozuar, përlogarit me SË përkatës sasinë e këtyre sensorëve. Në specifikimet e Tenderit janë kërkuar: Projekti i sistemit me agjentin shuarës të ofruar në zgjidhje duhet të jetë testuar/simuluar nga një softëare i certifikuar nga vete prodhuesi. Pas implementimit dhe testimit të sistemit, këto dokumenta duhet të dorëzohen autoritetit. Manualet e përdorimit dhe studimi (projekti) i kryer me softëare nga prodhuesi duhet të dorëzohen së bashku me planvendosjen e komponenteve në dhomen e serverave në përfundim të realizimit të projektit

C. Sa do të jetë sasia e detektorëve optik të tymit? Përgjigjen për këtë pyetje e gjeni në përgjigjen e pikës B.

D. Shkruani që do të duhen sirena në numrin shumë? Sa sirena ? Përgjigjen për këtë pyetje e gjeni në përgjigjen e pikës B. Gjithsesi, për më shumë shpjegime sipas standarteve kërkohet një sirena brenda dhomes së Serverave, dhe një sirena jashtë dhomes së serverave

E. Ku do vendosen këto detektore ? Detektorët do të përcaktohen nga OE në bazë të zgjidhjes së Simuluar.

F. Ku do vendosen sirenat ? Edhe kjo percaktohet nga OE, pavaresisht se standartet percaktojne vendet me te dukshme, dhe ne rastin klasik ne deren e jashtme si ne hyrje ashtu edhe ne dalje.

G. Me cfare do lidhen sirenat me panelin e alarmit? Kerkohet zgjidhje, pra OE do te jape zgjidhjen ne baze te produktit qe do te ofertoje.

H. Me cfare do lidhen detektorët me Panelin e alarmit ? Me kabull? Me ëireless? Me radio? Lidhja do te jete ne varesi te zgjidhjes qe OE do te propozoje. Nese dedektorët lidhen me kabell (Cfaredo lloj kabili) atehere OE duhet t'i lidhe me kabell, nese OE do te propozoje zgjidhje me dedektore ëireless, duhet te lidhen sipas menyres qe do te propozohet. AK per te mos perjashtuar asnje propozim ka lene dore te lire qe OE te propozojne zgjidhjen e tyre me te mire teknike qe ploteson specifikimet e kerkuar, njekohesisht edhe me ekonomike.

I. Kush jane specifikimet teknike te pajisjeve qe do te pranohen nga AK? Përgjigjen për këtë pyetje e gjeni ne pergjigjen e pikes A.

J. Sa eshte sasisa e kabullit qe duhet për te lidhur pajisjet? Sasia e kabllit edhe cdo element tjetër i zgjidhjes do te percaktohet nga OE ne baze te zgjidhjes se Simuluar.

K. Paneli i sistemit te detektimit dhe sinjalizimit te zjarrit do te kete nje kabinet dhe çfarë do vendoset aty? Ne specifikimet teknike te sistemit te detektimit dhe shuarjes se zjarrit, nuk percaktohet zgjidhje me kabinet. Zgjidhjet klasike te ketyre sistemeve parashikojne nje panel i cili, ne planvendosjen ilustruese te pajisjeve te dhomes se serverave eshte paraqitur ne hyrje te dhomes. Megjithate AK nuk do te perjashtoje asnje propozim, i cili ploteson kerkesat funksionale edhe specifikimet teknike te komponenteve te pershkruar ne DT.

L. Ku do transmetoje ky panel? Ne rast dedektimi te zjarrit sistemi do te veproje sic pershkruhet ne Dokumentat e tenderit dhe te ri-thena ne pergjigjen e pikes A.

Për sa i takon pyetjeve të ankimesit mbi përgatitjen e procedurës: Sqarojme se AK ka përgatitur procedurën e prokurimit duke respektuar Ligjin e Prokurimeve Publike dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

16) Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për manualin e sistemit Komisioni relaton: Paragrafet e përmendur nga OE, përshkruajnë anën funksionale të sistemit edhe skenarët për të cilët duhet të jetë i programuar sistemi. Këto janë gjendje te sistemi te dedektimit te zjarrit dhe jane ne cdo sistem dedektimi dhe Fikje zjarri. Sa më sipër, pretendimi i ankimesit nuk qëndron.

17) Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për specifikimin teknik të butonave Komisioni relaton: Keto butona duhet te jene pjese integrale te panelit dhe duhen apo aktivizohen apo caktivizohen sipas rastit. Aktivizohet butoni i shkarkimit te gazit kur eshte e qarte prezenca e zjarrit pa prituri qe sistemi te beje vertetimin e pranise se zjarrit ose e kunderta çaktivizon kohen e plasjes se gazit ne rast se dyshohet per prezence zjarri apo Fikja e tij mund te behet pa shperthimin e gazit. Sa më sipër, pretendimi i ankimesit nuk qëndron.

18) Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për sistemin CCTV Komisioni relaton: Përveç infrastruktures kryesore si pajisje kondicionimi, sisteme UPS-je, panele elektrike, Sistem menaxhimi e komandimi, sistem dedektimi dhe fikje te zjarrit, eshte parashikuar nje sistem vezhgimi me kamera. Per kete kerkohet nje NVR dhe pese kamera. Ne varesi te vendosjes se pajisjeve te kondicionimit, UPS-ve panele, BMS, etj etj nisur prej faktit qe prodhues te ndryshem kane zgjidhje te ndryshme per keto sisteme si dhe dimensione te ndryshme, per te mos kufizuar asnje operator ekonomik potencial, AK ka dhene vetem permasat e dhomes, ka percaktuar kerkesat teknike baze te pajisjeve, ka bere nje projekt-ide te vendosjes se pajisjeve nisur nga eksperienca ne site-n e saj primar, dhe ka lene qe cdo operator ekonomik te sjelle zgjidhjen e tij per te gjitha sistemet e kerkuara.

Kjo vlen edhe per sistemin e kamerave. Duke qene se pozicionet e kamerave i jane lene te vendosen nga Operatori ekonomik, ai vete eshte pergjegjes per zgjidhjen qe ofron. AK kerkon nje NVR me 5 kamera bashke me sëitch set furnizim vendosje, pra ne zgjidhje duhet te perfshihen te gjithe pajisjet NVR kamera sëitch, dhe vendosjen e tyre ne pune. Keshtu pyetjet e OE nuk marrin kuptim pasi ai duhet te parashikojë si cdo operator tjetër ne baze te zgjidhjes se tij cdo aksesori qe i nevojitet.

Ne DT e tenderit eshte dhëne qarte se netëork midis rakeve kërkohet me kabell bakri te paraterminuar i kategorisë 6a. Për me tepër dhoma e serverave eshte kerkuar te ndertohet konform standarteve kombetare dhe nderkombetare. OE, po t'i referohet atyre do te shohe qe nuk lejohet zgjidhje me koka RJ45. Por duhet te vendose konektore RJ45 dhe lidhja e kamerave te behet me Patch Corda. Kabllot do te perfundojne ne Patch Panele dhe kategoria e gjithë kablllove te bakrit eshte kerkuar 6A.

Ne DT e tenderit ka nje pike te tere , 9.1.5.5 vetem per kanalinat metalike:

9.1.5. 5 Kanalinat metalike

Sistemi i kanalineve metalike duhet të ndërtohet i tillë që kabllot data dhe të fuqisë të jenë në kanalina të ndara nga njera-tjetra. Kanalinat që do të përdoren për kalimin e kablllove nën dyshemenë teknologjike dhe ne tavan duhet te jene kanalina metalike rrjetë si për kabllot data dhe per kablot e fuqisë. Kanalinat duhet të montohen poshtë dyshemesë teknologjike në lartësi te ndyshme nga dyshemeja. Çdo dalje nga kjo kanaline duhet të bëhet me tuba fleksibel, ose rigid sipas nevojës e shoqeruar me aksesoret përkatës. Kanalina që do të shërbejë për instalimet elektrike do të jetë gjatë perimetrin të dhomës, kurse kanalina për instalimin e rrjetit të të dhenave duhet të përshkojë perimetrin e Rack-ëve. Per te gjithë instalimet e tjera te mundshme, si per prizat elektrike te sherbimit, duhet te perdoret kanalinë plastike ne lartesi 30-40 cm nga dyshemeja teknologjike.

Kanalinat që duhet të përdoren për instalimet tavanore si CCTV, zjarr, ndricim etj. duhet të jenë e tipit metalik të galvanizuar, e shoqeruar aksesoret e nevojshem si pjastrat bashkuese, kapak, si dhe kthesat 90° në plan. Cdo dalje nga kjo kanaline duhet të bëhet me tuba fleksibël, ose rigid Sipas nevojës e shoqeruar me aksesoret përkatës. Gjithashtu ne paragrafme 9.1. AMBJENTI I DHOMËS SË SERVERAVE percaktohet qarte "Kamera IP duhet të instalohen për të monitoruar plotesisht këtë ambjent. Kanalina metalike duhet të instalohen ne menyre perimetrare ne tavan, ose te pakten aty ku do te jete e nevojshme."

Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k, për uljen e rezolucionit minimal të NVR nga 12MPX ne 8MPX, e cila është bërë me idene e pranimit të kamerave me rezolucion më të larte, megjithatë Komisioni vlerëson se për këtë pretendim, Njësia e Prokurimit të modifikojë këtë pikë me anë të shtojcës të modifikimit të DT. Për riformulimin e të gjitha parametrave

Teknik të NVR sqarojmë se në zgjidhjen e CCTV, nuk kërkohet zgjidhje me server, por me NVR. Jo të gjithë prodhuesit e NVR përcaktojnë procesorin e instaluar në pajisjet e tyre. Çdo prodhues serioz kamerash dhe sistemesh CCTV, e OE që ofrojnë zgjidhje të tilla, e dinë se parametra të rëndësishme për vlerësimin e NVR janë numri i kanaleve/ nr i kamerave të suportuara, ndërkohe që për vlerësimin e një server/workstation mund të jenë RAM, CPU etj. AK për të mos përjashtuar asnjë propozim, nuk e ka kufizuar zgjidhjen duke kërkuar një procesor specifik. Do të pranohet cdo zgjidhje që plotëson kërkesat e projektit. AK për të mos kufizuar zgjidhjet e mundshme, nuk e ka përcaktuar bandwidth-in në hyrje. Do të pranohet cdo zgjidhje që plotëson kërkesat e projektit. AK nuk ka kufizuar numrin e portave VGA ose HDMI. Të gjithë prodhuesit e NVR kanë minimalisht një port VGA që mund të shërbejë për lidhjen e NVR me ekran. Për sa kohë AK nuk kufizon numrin apo llojin e portave, do të pranohet cdo zgjidhje që plotëson kërkesat e projektit. Kapaciteti fizik i disqeve 8TB nënkupton kapacitetin e disqeve që duhet të suportojë NVR. Pra, NVR duhet të suportojë disqe me kapacitet deri në 8TB (pra 1TB, 2TB, 4TB, 6TB deri në 8TB). Nëse NVR suporton edhe HDD me kapacitet me të madh, patjetër që do të jete zgjidhje e pranueshme. Në këtë projekt, HDD kërkohen nga 4TB, por me qëllimin që e njëjta NVR mund të përdoret edhe për kamera shtese në të ardhmen. Për këtë arsye, është kërkuar një kapacitet rezerve me qëllimin që sistemi të jete i zgjerueshem për të ardhmen. Për sa kohë OE plotëson kërkesën që NVR të jete e pajisur me 2 HDD nga 4TB secili, madhësia Fizike e HDD nuk është e rëndësishme. Do të pranohen të dy zgjidhjet 2.5" apo 3.5". Sa me sipër, ankimesi ti referohet specifikimeve teknike të kërkuara.

Në lidhje me kërkesën për të bërë përkthimin në gjuhën shqipe, AK thekson se ka bërë përkthimin e të gjithë parametrave teknik të cilët kanë kuptim të përkthehen në gjuhën shqipe. Nga ana tjetër, parametrat teknik të cilët njihen gjerësisht në gjuhën angleze referuar edhe standarteve ndërkombëtare, AK zgjedhur mos t'i shqipërojë për të mos krijuar konfuzion tek OE.

Në lidhje e kamerave ri sqarojmë perseri se standardi është me kabell Cat 6a FTP LSZH. Gjithsesi nëse OE jep zgjidhje tjetër me ëireless do të pranohet. Sasia do të llogaritet nga OE në varësi të pozicionimit të kamerave dhe kjo në varësi të vendosjes së pajisjeve. Kjo është arsyeja pse AK kërkon projektet me përmasat reale të pajisjeve që do të propozohen për të instaluar.

19. Në lidhje me retendimet e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për Switchet në do të përdoret për të ushqyer me POE kamerat e instaluara në monitorimin e dhomës së serverave, Komisioni relaton: Në lidhje me kërkesën për të bërë përkthimin në gjuhën shqipe, AK thekson se ka bërë përkthimin e të gjithë parametrave teknik të cilët kanë kuptim të përkthehen në gjuhën shqipe. Nga ana tjetër, parametrat teknik të cilët njihen gjerësisht në gjuhën angleze referuar edhe standarteve ndërkombëtare, AK ka zgjedhur mos t'i shqipërojë për të mos krijuar konfuzion tek OE. Në lidhje me Switch e kërkuar, sqarojmë se Switch-i i parashikuar në këtë projekt do të shërbejë për: lidhjen e kamerave dhe ushqimin me PoE, lidhjen e këtij switch-i me pjesën tjetër të infrastrukturës së rrjetit, lidhjen e pajisjeve të tjera në rrjet që ofrojnë mundësi për lidhje në rrjet, si PDU, sistemi i akses kontrollit, karta rrjeti të pajisjeve UPS, CRAC etj. me qëllim integrimin sistemin e monitorimit dhe menaxhimit, mundësi për shtim të kamerave në të ardhmen, në një infrastrukturë që mund të zgjerohet lehtësisht. I njëjti argument sqarues është edhe për kërkesën e ankimesit për portat 1000 Mbps. Sjellim në vëmendje se flasim për dhomën e serverëve të vazhdueshmërisë së punës (BCC-site), në të cilën do të instalohen sisteme kompjuterike shumë kritike dhe sensitive. Në lidhje me përkthimin, risqarojmë se AK ka bërë përkthimin e të gjithë parametrave teknik të cilët kanë kuptim të përkthehen në gjuhën shqipe.

Nga ana tjetër, parametrat teknik të cilët njihen gjerësisht në gjuhën angleze referuar edhe standarteve ndërkombëtare, AK zgjedhur mos t'i shqipërojë për të mos krijuar konfuzion tek OE. Për sa i takon pretendimeve të ankimesit për rishikimin apo riformulimin e specifikimeve teknike, janë dhënë sqarimet e nevojshme mbi pretendimet. Specifikimet Teknike nuk kufizojnë apo ndalojnë asnjë operator ekonomik të jap ofertën dhe zgjidhjen e vetë për këtë procedurë.[...]”

II.4.Në datën 30.06.2020, operatori ekonomik ankimes “Integrated Security Solutions” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“ [...].1. ANKESË NR.1

AK pas shpalljes së procedurës kishte përcaktuar se afati i fundit për dorëzimin e ofertave ishte data 06.07.2020. Me pranimin “pjesërisht” të ankesës tonë AK bëri modifikimin e DST dhe ndryshoi datën e fundit për dorëzimin e ofertave në 10.07.2020. Nguti i AK për të shpallur fituesin e paracaktuar të kësaj procedure, ka bërë që të mos respektojë as kufijtë më minimal ligjor të përcaktuar në Nenin 42 të LPP i cili parashikon se: 2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë. Sic mund të kuptohet lehtësisht edhe nga kushdo që nuk ka njohuri minimale për LPP, afati kohor për dorëzimin e ofertave duhej të zgjatej me 5 ditë dhe jo me 4 (në rastin më të mirë) sic ka bërë AK. Sjellim në vëmendjen Tuaj se parimi kryesor i legjislacionit shqiptar civil e administrative është se: Kur afati është caktuar me ditë dhe me orë, përjashtohet dita dhe ora në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati.

Kërkojmë që të zgjatet afati kohor për dorëzimin e ofertave në përputhje me Nenin 42 të LPP.

ANKESË NR.2

I.S.S shpk në ankesën drejtuar AK ka kërkuar që: Të bëhet ndarja në Lote pasi AK kërkon 2 mallra të fushave të ndryshme brenda të njëjtit objekt. Konkretisht kërkohet prokurimi i sistemeve të kondicionit dhe sistemeve të sigurisë në përbërje të të njëjtit tender. Ne Nenin 9 pika 5 te VKM Nr. 914 “ Per rregullat e Prokurimit Publik” percaktohet se: “Kontrata ndahet në lote, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t'i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor. Në çdo rast, kur kontrata ndahet në lote, për efekt të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit, vlera limit e kontratës do të jetë shuma e vlerës së secilit lot.” Nderkohe qe ne Nenin 29 nder te tjera percaktohet se: Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.“

Sa më sipër duke marrë në konsideratë faktin se kompanitë që ofrojnë sisteme sigurie nuk montojnë kondicionera sic pretendon AK, kërkojmë minimalisht ndarjen e kësaj procedure në Lote. Pika 2.11 të modifikohet si më poshtë: 2.11 Ndarja në LOTE: Po X Jo

Në përgjigjen e tij AK ka refuzuar këtë ankesë me një arsyetim sipërfaqësor e minimalist si më poshtë: “Realizimi i saj kërkon punime dhe produkte specifike për dhoma të tilla që të operojnë së bashku në mënyrë të tillë që të krijojnë kushtet e nevojshme për instalimin e pajisjeve në BCC Site. Si e tillë ajo nuk mund të ndahet pasi kërkohet që OE duhet të marrë përsipër të furnizojë, instalojë dhe të bëjë ë mundur integrimin, monitorimin, komandimin, e pajisjeve të kërkuara brenda sipërfaqes së vënë në dispozicion nga KESh sh.a për të krijuar kushtet e nevojshme për instalimin e serverave dhe pajisjeve të tjera të nevojshme që lejojnë vazhdimësinë e punës në korporatë pa humbje të proceseve dhe të tët dhënave. Për më tepër e njëjta procedurë është përdorur edhe për të gjithë institucionet e tjera të rëndësishme ?! ”

Në lidhje me refuzimin e kësaj kërkesë dëshiron të sjellim në vëmendje të KPP se argumenti se e njëjta procedurë është përdorur për të gjithë institucionet e tjera të rëndësishme nuk është as serioz dhe as ligjor. AK është e detyruar të japi argumenta ligjor për vendimet që merr. AK bie në kontradiktë me pohimet e veta pasi në përgjigjen e ankesës nr.2 ndër të tjera citon se: Ky prokurim ka një ndërthurje mallrash të ndryshëm.

I.S.S sh nk kërkon ndarjen e procedurës në lote pasi përbehet nga në ndërthurje mallrash të ndryshëm. Ndarja e kësaj procedure ne lote shërben për të nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik dhe rritjen e konkurrencës.

3. Ankesa jonë në lidhje me pranimin e mundësisë së nënkontraktimit është pranuar nga AK.

4. Kërkesa jonë në lidhje me përcaktimin nëse në hartimin e specifikimeve teknike është marrë miratimi i AKSHI është marrë në konsideratë nga AK dhe është përcaktuar JO.

5. Ankesa jonë në lidhje me modifikimin e kriterit 2.3.1 të Kapacitetit Teknik sa i përket furnizimeve të ngjashme është marrë në konsideratë nga AK.

ANKESË NR. 3

I.S.S shpk ka paraqitur ankesë pranë AK në lidhje 2.3.2 të DST në të cilën parashikohet se: 2.3.2. Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zotërojë dhe të paraqesë Licencën Profesionale të lëshuar nga institucione të autorizuara me ligj, në kategoritë si më poshtë: NP-3A , NS-12A, NS-13A, NS-14A. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike, Licensat profesionale duhet ti paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

Në lidhje me këtë kërkesë I.S.S shpk ka pretenduar që: Licenca e kërkuar më sipër lëshohet për kompanitë që ushtrojnë veprimtari ndërtuese zbatimi ndërkohë që objekti i prokurimit të këtij tenderi është blerje e mallrave të nevojshëm për ndërtimin e dhomës së serverave kryesisht pajisje sigurie dhe kondicioner. Nga konsultimi me VKM Nr. 943, datë 28.12.2016, i ndryshuar rezulton se kategoritë e kërkuara nga AK janë si më poshtë:

NP-3 Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada. Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

N.S-12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit. Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve të prodhimit të energjisë termike

nga burime të rinovueshme, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

N.S-13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni. Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

N.S-14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV. Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Duke marrë në konsideratë Zërin "Punime civile të specializuara" në DST gjykojmë se kërkesa për paraqitjen e licencës me kategoritë si më sipër është e ekzagjeruar dhe diskriminuese ndaj kërkojmë heqjen e këtij kriteri.

Nga AK kërkesa jonë është refuzuar me argumentin e mëposhtëm: Kjo procedurë parashikon punime të specializuara duke filluar nga Kafazi i Faradejit, veshje të mureve dhe tavanit me kartonxhes antizjarr, trajtim të dyshemesë, sistem kondicionimi, sistem UPS-je, panele elektrike sipas fuqive të përcaktuara, rrjet kompjuterik të parateminuar nga fabrika etj...

Nga vetë përgjigjja e AK rezulton se për kryerjen e punimeve të mësipërme është e mjaftueshme vetëm pasja e licencës së punimeve NP-3. Të gjitha kategoritë e tjera janë të ekzagjeruara dhe shërbejnë për kufizimin e konkurrencës ndaj kërkojmë heqjen e tyre.

ANKESË NR. 4

I.S.S shpk ka paraqitur ankesë pranë AK në lidhje me pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik ku parashikohet se: Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat ISO ose ekuivalentin e tyre si me poshte:

ISO 9001 :2015/ ose të përditësuar "Sistemi i menaxhimit të cilësisë" ;

ISO 14001 :2015/ ose të përditësuar "Sistemi i menaxhimit të mjedisit";

ISO 18001-2007 ose 45001:2018 "Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë";

ISO/IEC 20000-1:2011 / 2018 ose të përditësuar "Për menaxhimin e shërbimeve sistemeve IT".

ISO 27001 :2013 ose të përditësuar "Për menaxhimin e sigurisë së informacionit".

Certifikatat e mësipërme kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, dhe të jenë në përputhje me nenin 30 të V.K.M. Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar. Ne rast të bashkimit të operatoreve ekonomike ISO duhen plotësuar prej secili nga operatorët ekonomike.

Kërkojmë heqjen e : ISO 14001 :2015/ ose të përditësuar "Sistemi i menaxhimit të mjedisit";

ISO 18001-2007 ose 45001:2018 "Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë";

...pasi nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit !!!

Kërkesa jonë është refuzuar nga AK me pretendimin se: Duke theksuar se është e drejtë ligjore e AK të vendosë kriteret në përputhje me objektin e prokurimit, Komisioni i konsideron të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit ISO-t që pretendohen që të hiqen, pasi O.E. apo BOE që do të kryejë punimet e parashikuara në këtë procedurë duhet ti kryejë ato duke respektuar sic parashikohet në ligj mjedisin si dhe duke respektuar shëndetin dhe sigurinë në punë.

Vetë përgjigjja e dhënë nga AK është sa për të qeshur edhe për të qarë. Si do të kryhen punimet duke respektuar mjedisin apo shëndetin dhe sigurinë në punë. Për respektimin e këtyre standarteve shteti shqiptar ka ngritur mekanizma konkret që bëjnë kontrollin dhe evidentimin e tyre. Certifikata ISO i referohen standarteve që duhet të përfushë kompania etë në sistemin e saj të brendshëm të menaxhimit dhe nuk ka asnjë lidhje me kryerjen e punimeve sic pretendohet nga AK!!! ISO në lidhje me menaxhimin e mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë të ekzagjeruara dhe nuk përputhen në asnjë këndvështrim me objektin e kësaj procedure prokurim ndaj kërkojmë heqien e tyre.

ANKESË NR. 5

I.S.S shpk ka paraqitur ankesën në lidhje me pikën 2.3.6 ku parashikohet se: 2.3.6. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mesatarisht të paktën 30 punonjës, të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Mars 2020 - Maj 2020. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqitet: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ose nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ku te specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën Mars 2020 - Maj 2020. Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore si pas formularit E/Sig-25 për periudhën e mësipërme Mars 2020 - Maj 2020.

Ankesa jonë lidhet me faktin se numri i punonjësve të kërkuar në këtë pikë është i ekzagjeruar dhe synon kufizimin e konkurrencës. Nëse numërojmë numrin e inxhinierëve dhe specialistëve që vetë AK ka kërkuar në pikën tjetër rezulton se numri total është 15. Nuk e kuptojmë pse AK duhet të dyfishojë numrin e fuqisë punëtore??? Njëpërmjet kërkesës për disponimin në staf të 30 punonjësve, autoriteti kontraktor ka tejkaluar natyrën dhe përmasat e kontratës pasi një numër i tillë punonjësish është tërësisht joproporcional me objektin e prokurimit. Sjellim në vëmendjen tuaj përcaktimet ligjore se Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura. Kërkojmë që pika 2.3.6 të modifikohet si më poshtë: 2.3.6. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mesatarisht të paktën 15 punonjës, të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Mars 2020 - Maj 2020. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqitet:

Nga AK kjo kërkesë e jona është refuzuar me pretendimin se: ...Janë kërkuar 15 punonjës staf inxhiniero-teknik të certifikuar dhe specializuar për zërat kryesorë dhe që do të udhëheqin punimet, por nga ana tjetër AK nuk ka kërkuar punonjës të specializuar për shumë zëra si për kafazin e faradejt, punimet civile, dyshtimet teknologjike, kanalinën e verdhë, Raket, PDU-të, trajnimin etj. Pa llogaritur që një shoqëri ka në administratë punonjës finance, magazinierë, shoferë, etj duke llogaritur punimet e tjera që O.E janë duke kryer, riskun e ndikimit nga pandemia ekzistuese etj theksojmë se kërkesa për 30 punonjës për këtë objekt prokurimi konsiderohet minimale!!! Nuk e kuptojmë se me çfarë të drejtë AK përdor si argumentim ligjor kushte që nuk i ka parashikuar në DST sic është prezenca në staf e fuqisë punëtore të specializuar duke shpikur nga një profesion për çdo punim ndërkohë që në DST përvec inxhinierëve ka kërkuar edhe specialistë. Akoma dhe më absurde bëhet përpjekja e AK për të justifikuar numrin joreal me financiarë, magazinierë, roje dhe sanitare...

Nëpërmjet kërkesës për disponimin në staf të 30 punonjësve, autoriteti kontraktor ka tejkaluar natyrën dhe përmasat e kontratës pasi një numër i tillë punonjësish është tërësisht joproportional me objektin e prokurimit. Për autoritetin kontraktor e rëndësishme të provohet disponimi i punonjësve por kjo duhet të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme duke pasur parasysh elementë të tillë si natyra e kontratës dhe volumi i saj, për më tepër kur vetë autoriteti kontraktor ka parashikuar se realizimi i kontratës do të bëhet në një periudhë të shtrirë 3-mujore. Sjellim në vëmendjen tuaj përcaktimet ligjore se Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura. I.S.S shpk vlerëson se kriteri i sipërcituar nuk është hartuar tërësisht në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik pasi ka kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë duke përfshirë në të vetëm ata operatorë të cilët plotësojnë numrin e kërkuar prej 30 punonjësish, duke përjashtuar kështu operatorë të tjerë ekonomikë të cilët edhe pse mund të garantojnë punë të ngjashme me objektin si dhe mund të përmbushin të gjitha kriteret kualifikuese për këtë procedurë prokurimi do të penalizohen vetëm për faktin se nuk përmbushin numrin e kërkuar të punonjësve e cila në rastin konkret nuk është i argumentuar dhe justifikuar nga autoriteti kontraktor.

Në këtë kuptim i kërkojmë KPP ta detyrojë AK të modifikojë kriterin sa më sipër duke përcaktuar një numër të arsyeshëm dhe proporcional me volumin e punimeve të nevojshme që do të kryhen për realizimin e kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP.

ANKESË NR.6

Në pikën 2.3.7 të Kapacitetit teknik është parashikuar: Operatori Ekonomik ofertues duhet këtë pjesë të stafit të tij, minimalisht punonjësit si më poshtë:

(një) inxhinier mekanik ose mekatronik i certifikuar për sistemet e kondicionimit që do të ofertojë.

(një) inxhinier elektrik, ose inxhinier elektronik /informatikë, i certifikuar për sistemin e BMS që do të ofertojë.

1 (një) inxhinier elektronik ose telekomunikacioni/informatikë i certifikuar për sistemin e Kamerave që do të ofertojë.

1 (një) inxhinier elektronik ose telekomunikacioni /informatikë i certifikuar për sistemin e akses kontrollit që do të ofertojë.

1 (një) inxhinier elektronik, ose telekomunikacioni/informatikë i certifikuar për Menaxhim të Shërbimeve IT (Certifikata ITIL ose ekuivalente).

1 (një) inxhinier elektronik ose telekomunikacioni /informatikë i specializuar për ndertimin e rrjetit Data dhe fiber optike që do të ofertojë.

2 (dy) specialist ose teknik për instalime në tension të ulët.

1 (një) specialist ose teknik të specializuar në instalimet e sistemit të kondicionit.

1 (një) specialist ose teknik të specializuar në instalimet e sistemit të BMS.

1 (një) specialist ose teknik të specializuar për instalim kamerash.

1 (një) specialist ose teknik të specializuar për akses kontroll.

1 (një) specialist ose teknik të specializuar për sistemin e zjarrit

1 (nje) specialist ose teknike të certifikuar për instalime te rrjetit Data dhe fiber optike.

Për të vërtetuar këtë pikë, duhet të paraqitet: Për inxhinierët: Diplomë inxhinierike, Kontratë Pune, CV, Certifikatat përkatëse dhe Listëpagesat e si gurimeve shoqërore dhe shëndetsore sipas formularit E/Sig-25 për periudhën Mars 2020 - Maj 2020. Për specialistët ose teknikët: Kontrate Pune, CV, Certifikatat përkatëse dhe Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore sipas formularit E/Sig-25 për periudhën Mars 2020 - Maj 2020.

I.S.S shpk ka pretenduar në ankesën drejtuar AK se të gjitha kërkesat e mësipërme janë të ekzagjeruara dhe kufizojnë pjesëmarrjen në mënyrë të pandershme në këtë tender. Konkretisht: AK kërkon inxhinier mekanik për sistemet e kondicionimit??? Në VKM 514 datë 20.09.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve" jepen këto funksione për profesionin e inxhinierit mekanik : Inxhinieri mekanik kryen studime, këshillon, dizajnon dhe drejton prodhimin e makinerive, avionëve, anijeve, impianteve mekanike dhe ndustrial, pajisjeve dhe sistemeve. Ai këshillon dhe drejton funksionimin e këtyre pajisjeve, mirëmbajtjen dhe riparimin. Studion dhe këshillon mbi aspektet mekanike të materialeve, proceseve apo produkteve të veçanta.

Për aq kohë sa AK kërkon autorizim prodhuesi për kondicionerët rezulton që nuk është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë në staf një inxhinier mekanik për prodhimin e kondicionerëve!!! Si ka mundësi që për të instaluar 2 kondicionerë duhet edhe një inxhinier mekanik edhe një specialist për montimin???

Kërkojmë heqjen e kërkesës për 1 inxhinier mekanik/mekatronik pasi është e ekzagjeruar dhe e pambështetur në nevojat konkrete të këtij prokurimi. AK në mënyrë evasive ka kërkuar certifikime të ndryshme pa përcaktuar se nga cili institucion duhet të jenë lëshuar këto certifikata. P.SH AK kërkon që OE të ketë në staf 1 (një) specialist ose teknik të specializuar për sistemin e zjarrit por nuk përcakton nëse ky specialist duhet të ketë një certifikatë të lëshuar nga prodhuesi i sistemeve të zjarrit apo një certifikatë të lëshuar nga MZSH. Sa më sipër , kërkojmë që AK të përcaktojë institucionin kompetent për të lëshuar certifikatat për secilën pikë. Gjithashtu AK të përcaktojë nëse do të pranohet që një individ të ketë më shumë se 2 certifikime psh. O.E të ketë në staf vetëm një inxhinier elektronik dhe ky person të ketë certifikatë edhe për sistemet BMS, sistemet e kamerave, akseseve, ITL, Data etj.

Në përgjigje AK pretendon shkurtimisht se: Janë kërkuar 2 kondicionerë me fryrje nga poshtë për dhomat e serverave pasi nëse njëri nuk do të punojë tjetri duhet të hyjë menjëherë në punë, për të garantuar vazhdimin e punës....Sistemi i kondicionimit klasifikohet tek sistemet mekanike, dhe AK ka kërkuar inxhinier mekanik ose mekatronik për për të lejuar një gamë sa më të gjerë inxhinierësh....

Kërkojmë heqjen e kërkesës për 1 inxhinier mekatronik pasi AK thjesht do të blejë kondicionerë, nuk kërkon prodhimin e tyre!!! Kërkesa për inxhinier mekanik/mekatronik është e ekzagjeruar dhe kufizon pjesëmarrjen!

Më tej AK vijon: Tjetër gjë është të shesë dhe tjetër gjë është të instalojë dhe konfigurojë pajisjen. AK justifikon nevojën për inxhinierin mekanik/mekatronik me instalimin e kondicionerëve?! Po specialisti për instalimin e kondicionerëve çfarë pune do të bëjë??? AK ka saktësuar autoritetin kompetent për lëshimin e certifikatave dhe më tej përcaktuar se: AK do të lejojë që një inxhinier mund të ketë deri në 2 certifikime. Kërkojmë heqjen e këtij kriteri pasi është kufizues dhe përjashton mundësinë e pjesëmarrjes së profesionistëve të vërtetë të cilët zotërojnë më shumë se 2 kualifikime.

ANKESË NR.7

I.S.S ka paraqitur ankesë në lidhje me pikën 2.3.8 ku përcaktohet se 2.3.8. Operatori Ekonomik ofertues për paisjet duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/ve të përkthyer në gjuhën shqipe në pjesën ku janë paraqitur të dhënat dhe karakteristikat teknike, në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike, të mallrave objekt prokurimi.

Nuk e kuptojmë se çfarë dëshiron të thotë AK me pjesën: të përkthyer në gjuhën shqipe në pjesën ku janë paraqitur të dhënat dhe karakteristikat. Në DST është përcaktuar qartë se gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe ndaj i gjithë dokumentacioni që do të paraqitet do të jetë në gjuhën Shqipe. A do të pranojë AK që një pjesë e katalogur të jetë në gjuhë kineze psh dhe vetëm pjesa e specifikimeve teknike të jetë në shqip??? Sjellim në vëmendje të AK se të gjithë dokumentat e dorëzuar në tender duhet të jenë të përkthyer dhe noterizuar sipas ligjit dhe këto parashikime nga AK shërbejnë vetëm për të krijuar konfuzion tek O.E dhe për ti dhënë AK mudësinë që të jetë abuziv gjatë procesit të kualifikimit.

Kërkojmë modifikimin e pikës 2.3.8 si më poshtë: 2.3.8. Operatori Ekonomik ofertues për paisjet duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/ve të përkthyer në gjuhën shqipe në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike, të mallrave objekt prokurimi.

Në përgjigjen e tij AK ka refuzuar ankesën tonë me pretendimin se: Nisur nga fakti se gjuha e pranuar ndërkombëtaësh është gjuha angleze, dhe me qëllimin për tu ardhur në ndihmë operatorëve ekonomik, për të bërë të mundur uljen e kostove të përkthimit, është kërkuar që të përkthehen në gjuhën shqipe vetëm pjesët ku janë paraqitur të dhënat dhe karakteristikat teknike të mallrave objekt prokurimi.

Kërkojmë detyrimin e AK të zbatojë ligjin dhe të përcaktojë se të gjithë dokumentat që do të dorëzohen duhet të jenë në gjuhën Shqipe!!! Nuk ka asnjë fakt që përcakton se gjuha angleze është gjuha e pranuar ndërkombëtarisht!!!

ANKESË NR. 8

Në pikën 2.3.10 parashikohet se: 2.3.10. Operatori Ekonomik ofertues, për integrimin në BMS të paisjeve të sistemit elektrik, sistemit të kondicionimit me fryrje nga poshtë, UPS, PDU-së, paneleve elektrike, matëseve të tensionit, duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton integrimin e tyre.

Formulimi i këtij kriteri është evaziv dhe madje krijon përshtypjen se AK as nuk e ka idenë se çfarë kërkon. AK të përcaktojë se çfarë dokumentacioni konkretë kërkon për këtë pikë!!!

Në përgjigjen e tij ndonëse ka përcaktuar se kërkohet vërtetim prodhuesi ka refuzuar ankesën tonë. Kërkojmë detyrimin e AK për të formuluar saktë këtë kërkesë pasi vijon të mbetet evaziv dhe i paqartë. Kriteret e mësipërme të kualifikimit bien në kundërshtim me: Gërmën “c” dhe “ç” të nenit 1 të LPP, i cili parashikon se qëllimi i këtij ligji është: c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; Nenin 20 të LPP, i cili parashikon se: Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre.

Nenin 28/2 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për R.P.P”, përcaktohet se në Kontratat e shërbimeve: Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të

përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

Në lidhje me specifikimet teknike I.S.S shpk ka paraqitur pranë AK ankesat si më poshtë:

ANKESË NR. 9

Në Shtojcën 10 Specifikimet Teknike pika 1.2 Situata Aktuale rezulton si më poshtë

Ne kete paragraf permenden disa herë pajisjet e kamerave dhe NVR neper Hecet ekzistuese. Video monitorimi ne keto objekte eshte pothuajse jashte funksionit, kjo e vertetuar me sakte dhe nga vizita e MB para disa ditesh qe u pasqyrua dhe ne media dhe ku me shume se 80% e kamerave nuk funksionojne. Ju lutem një sqarim si ka mundësi që Ju si AK kerkoni te beni nje projekt per dhomen e serverit nderkohe shumica e paisjeve fundore nuk u punojne? Kerkojme te na behet e ditur e gjithe infrastruktura ekzistuese qe keni per video monitorimin ne Digat e Vaut te Dejes dhe ne Hidrocentralet e tjera. Gjithashtu të jepet informacion nëse keto sisteme jane funksionale apo jo. AK pretendon se këto kërkesa janë jashtë objektit të kësaj procedure.

Kërkojmë detyrimin e AK të përgjigjet e saktësojë për sa më sipër.

ANKESË NR. 10

Në Shtojcën 10 Specifikimet Teknike pika 2.1 Objektivi i Përgjithshëm rezulton si më poshtë: Krijimi i dhomes se serverëve (BCC-Site) sipas standarteve Teknike për KESH SH.A. Kërkojmë nga AK të na vërë në dispozicion standartet teknike për KESH sh.a !!! Ju lutem ne baze te ligjtit te APP kerkojme perkthimin e kesaj fjalie ? Transferimi i pajisjeve dhe linjave të komunikimit ekzistuese. Lutem sqaroni nëse kerkohet dhe transferim i pajisjeve te video monitorimit ? Nëse po të jepen të dhëna të sakta në mënyrë që të kemi mundësi të llogarisim kostot. Minimizimi i probabilitetit të mosfunksionimit të sistemeve të informacionit nga faktorë të jashtëm; Rritja e sigurisë së informacionit. Ky term qe perdorni per objektivat eshte shume evaziv. Ju kerkoni te kryeni nje investim dhe thjesht doni te minimizoni probabilitetin? Sa esht koeficienti i minimizimit? Në përgjigjen e tij AK përcakton se: Për standartet teknike ankimesi duhet ti referohet standarteve kombëtare e ndërkombëtare!!! Lutemi detyrimin e AK për të përcaktuar se cilat janë këto standarte konkrete si dhe përgjigjen për pikat e tjera të cilat i ka lënë pa trajtuar.

ANKESË NR.11

Në Shtojcën 10 Specifikimet Teknike pika 4.3 “Data e Fillimit dhe Periudha e implementimit të Detyrave“ përcaktohet se: Zbatimi i projektit do të fillojë menjëherë me nënshkrimin e kontratës nga të dy palët dhe periudha e implementimit te detyrave do te jete 3 muaj nga kjo datë.

Kerkojme shtyrjen e ketij afati ne 6 muaj duke pare kushtet e veshtira qe ndodhet Republika e Shqiperise dhe gjithe bota. Dihet boterisht qe per shkak te COVID19 prodhimi dhe transportet kane vonesa te konsiderueshme ne gjithe boten. Eshte teknikisht dhe llogjikisht e pamundur të bëhet realizimi i ketij projekti per 3 muaj nqs paisjet qe kerkohen do porositen. E vetmja mënyrë që ky projekt të realizohet me sukses brenda afatit 3-mujor ndërkohë që të gjithë shtetet e botës kanë mbyllur kufijtë është që O. E i parapercaktuar per ta fituar kete gare ti kete produktet në magazinë?!!

Kjo kërkesë është refuzuar nga AK me pretendimin se nuk ka kufizime për lëvizjen e mallrave.

Kërkojmë detyrimin e AK të shikojë një mënyrë më të arsyeshme për datën e Fillimit dhe Periudhën e Implementimit të Detyrave.

ANKESË NR. 12

Ne tabelen e planifikimit te buxhetit për zërta 11-15 në mënyrë skandaloze jepet emërtimi i përgjithshëm pa përshkruar se çfarë pajisjesh përmban një set: Ju kerconi:

F.V. Network (perfshi FO, CU, patchpanele dhe menaxhues kablli, menaxhues ajri, kanalinen e verdhe, aksesori etj.)	set	1
12 F.V. Sistem i detektimit dhe fikjes se zjarrit	set	1
13 F.V. Sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit	set	1
14 F.V. Sistem CCTV (5 kamera, NVR, sëtich PoE)	set	1
15 F.V. Sistem akses kontrolli	set	1

Te gjitha keto jane sisteme qe perbehen nga disa elemente te ndryshem. Kerkojme ndarjen e te gjitha ketyre elementeve ne sasi dhe jo ne set pasi nuk perlllogaritet sakte kosto. Gjithashtu ka dhe elemente te fshehur brenda ketij seti te cilat duhet ti behen me dije O.E.

Ak në përgjigjen e tij argumenton se: AK nuk ka renditur një listë produktesh të parapërcaktuar por i ka lënë dorë të lirë o.e të propozoni zgjidhjen tuaj më të mirë teknike dhe ekonomike që plotëson specifikimet e kërkuara!!!

Ky formulim është evaziv dhe krijon mundësinë e subjektivizmit në vlerësimin e ofertave dhe vështirësi në përpilimin e ofertave nga ana e O.E. Kërkojmë përcaktimin e saktë dhe konkret të përbërësve të setit të kërkuar.

ANKESË NR.13

Në Dst , për pikën 1 I “Sistemi i detektimit te zjarrit” përcaktohet se: Dhoma e serverave duhet që të pajiset me sistem detektimi dhe sinjalizimi të zjarrit per te gjithë hapësirën (si per hapësirën e cila kufizohet nga dyshemeja teknologjike dhe tavani, ashtu edhe per hapësirën e cila kufizohet nga dyshemeja teknologjike dhe dyshemeja fikse. Pajisjet e alarmit të zjarrit do të instalohen sipas rregullave dhe standarteve lokale. Për detektimin e zjarrit duhet të vendosen në dhomën e serverave detektorë temperature dhe detektorë optikë tymi. Për sinjalizimin e alarmit të zjarrit do te vendosen sirena. Ky sistem duhet të ketë aftësi per t’u integruar me sistemet e tjera.

I.S.S shpk ka kërkuar në AK sqarimin e pikave si më poshtë: Kerkoni nje sistem per detektimin e zjarrit dhe nuk specifikoni çfare paisjesh do vendosen? Sa do jete sasia e detektoreve te temperatures? Sa do jete sasia e detektoreve optik te tymit? Shkruani qe do duhen sirena ne numrin shumes... SA SIRENA ??? KU do vendosen keto detektore ? Ku do vendosen sirenat ? Me çfare do lidhen sirenat me panelin e alarmit? Me çfare do lidhen detektorët me Panelin e alarmit? Me kabull? Me ëireless? Me radio? Kush jane specifikime teknike te paisjseve qe do pranohen nga AK? Sa eshte sasisa e kabullit qe duhet per te lidhur paisjet? Paneli I sistemit te detektimit dhe sinjalizimit te zjarrit do kete nje cabinet dhe çfare do vendoset aty? Ku do transmetoje dhe sinjalizoje ky panel? Si shpjegohet qe nje AK ben nje projekt dhe nuk jep asnje specifikim Teknik per sistemin qe kërkon? Si e keni parashikuar fondin limit te ketij projekti kur nuk keni asnje te dhene per keto paisje qe ju kerconi? A eshte kryer ligjerisht procedura per llogaritjen e fondit limit ? A jane te faktuara kerkesat qe u keni bere OE qe kane marre pjese ne perrlllogaritjen e fondit limit ?

Në përgjigjen e tij sërish AK i ka lënë evazive të gjitha kërkesat tona duke përcaktuar se cdo gjë do të jetë në varësi të zgjidhjes që O.E do të propozojë...ky është një tender furnizimi mallrash dhe jo një konkurs projektimi. Me çfarë kriteresh do të vlerësojë AK zgjidhje e ndryshme???

Kërkojmë përcaktimin dhe saktësimin e të gjitha zgjidhjeve të kërkuara nga AK dhe jo lënien e tyre në dorë të propozimeve të O.E pasi ky nuk është një konkurs. AK të përcaktojë sasi të materialeve të nevojshme dhe jo ti lërë në dorë të zgjidhjes së O.E. Nuk e kuptojmë se çfarë do të thotë përgjigjja: “Sasia e kabllit dhe cdo element tjetër i zgjidhjes do të përcaktohet nga OE në bazë të zgjidhjes së Simuluar”

Kërkojmë që AK të detyrohet të përcaktojë saktë cdo mall që kërkon qoftë në sasi qoftë në specifikime teknike.

ANKESË NR.14

Paragrafet me poshte jane manuali i sistemit qe keni parapercaktuar per kete procedure ???

Sistemi duhet të jetë i programuar për këto skenarë:

Stand by - Sistemi është në gatishmeri. Në këtë gjendje sistemi nuk kryen asnjë veprim por vetëm lexon të dhënat nga detektorët zjarrit në zonat e përcaktuara më lart.

Prealarm (Pre-activated) - Sistemi ka sinjal alarmi (Fire Alarm) nga një prej zonave të mbulimit të zjarrit (kur aktivizohet një sensor në zonën e mbrojtur nga zjarri- temperature ose tym) dhe duhet të iniciojë një alarm në panelin e kontrollit, duhet të aktivizojë sirenat dhe dritat pulsuese në zonën e mbuluar nga ky sensor. Këto sinjale i dergohen dhe personelit për kontrollin dhe monitorimin e mbrojtjes nga zjarri. Në këtë gjendje nuk duhet të aktivizohet menjëherë sistemi i shuarjes së zjarrit për të shmangur alarmet "false", qe mund te vijne si rezultat i faulteve te sitemit. Pas ndërhyrjes së operatorëve të sigurisë. në rastin e alarmeve "false", sistemi mund të kthehet në gjendjen e tij normale nëpërmjet butonave të komandimit në panelin e kontrollit.

Alarm (Activated) - Sistemi ka sinjal alarmi nga të dy zonat e dhomes (sensore temperature dhe detektor tymi). Detektimi i zjarrit nga një sensori i dytë aktivizon "alarmin nga zjarri" dhe kalimin në fazën e shuarjes së zjarrit; edhe në këtë fazë, operatorët mund të ndalojnë manualisht kalimin në procesin e shuarjes së zjarrit (në rast se zjarri mund te shuhet nëpërmjet shuarësve portabël me pluhur ose nëse kemi të bëjmë me një alarm "fals"). Sistemi i projektuar i mbrojtjes nga zjarri duhet t'i mundësojë operatorëve edhe aktivizimin manual në procesin e shuarjes së zjarrit nëpërmjet butonit përkatës në ambjent. Në këtë gjendje sistemi jep alarmin per evakuimin e ambjenteve duke ndezur sinjalet dalje dhe duke aktivizuar alarmin e përgjithshem. Njëkohësisht behet caktivizimi i magneteve te dyerve nga sistemi i kontrollit, monitorimit dhe menaxhimit.

Kerkojme rishikimin e ketyre fjalive pasi jane copy paste!

Ak në përgjigjen e tij pretendon se këto janë në gjëndje të sistemi të zjarrit dhe janë në cdo sistem. Kërkojmë rishikimin e tyre pasi orientojnë drejt një prodhuesi të vetëm.

ANKESE NR. 15

Në Dst përcaktohet se: Extinguishant Release Control. Duhet të jepet mundësia për clirimin e agjentit shuarës të zjarrit manualisht me anë të një sëitch të veçantë (një Button Push ose ekuivalent).

Butonat e Aktivizimit dhe Ndalimit Manual. Ne hyrjen e dhomes se serverave, jashte dhome, duhet te montohen butonat e Aktivizimit Manual dhe te Ndalimit Manual te sistemit te shuarjes.

Butoni i Aktivizimit manual. Mund te perdoret nese kerkohet aktivizim i menjehershem i sistemit te shuarjes (ne rast se vetem njeri nga dedektorët eshte aktivizuar dhe paneli ka kaluar ne

gjendjen "Pre-alarm", personeli pergjegjes mund te shtype kete buton dhe te aktivizojë manualisht sistemin e shuarjes).

Butoni i Ndalimit (ose vonimit) te aktivizimit. Mund te perdoret ne rastet kur paneli ka kaluar ne gjendje "Alarm", por duam te vonojme ose ndalojme aktivizimin e sistemit te shuarjes pasi personeli pergjegjes veren se eshte alarm fals ose ne dhome ka rene zjarr qe mund te shuhet ne menyra te tjera (psh. me nje fikse dore)

I.S.S shpk ka kërkuar në AK një përgjigje për sa më poshtë: Kush jane specifikimet teknike te ketyre butonave? Mund te sjellim nje buton qe ka nje Madhesi 1 mm apo nje buton qe ka nje Madhesi 10 metra ? Me cfare do lidhet me sistemin?

Kërkojmë detyrimin e AK të kthejë përgjigje për pyetjet e mësipërme pasi i ka lënë evazive.

ANKESË NR.16

Në pikën 9.2.1 Sistemi CCTV përcaktoni se: Dhoma e serverave duhet te pajiset me sistem CCTV dhe sistem te kontrollit te aksesit. Brenda dhomes se serverave duhet te instalohen 5 kamera per vezhgimin e gjithë hapësirës se dhomes. Gjithashtu, dhoma e serverave duhet te pajiset me sistem kontrolli aksesi me dy readera per deren e dhomes se serverave (Brenda dhe jashte dhome). Regjistrimi i kamerave në dhomen e serverave do të behet me ane të NVR-se lokale, ndersa kamerat do të ushqehen nëpërmjet teknologjisë POE për të evituar instalimet e rrymës elektrike. Të gjithë aksesorët e nevojshëm për montimin e kamerave duhet të jenë të përfshira. Për ushqimin e kamerave me POE duhet të instalohet nje sëitch sipas specifikimeve te percaktuara me poshte. Me poshtë janë specifikimet teknike për komponentët kryesore të sistemit CCTV.

I.S.S shpk i ka kërkuar AK saktësimin e pikave si më poshtë: a.Kërkoni më sipër qe aksesorët duhet te jene te përfshirë. Si mundet qe nje AK te mos japi informacion se kush jane keto aksesorë ndihmës? Ky term qe ju perdorni konfondon O.E pjesëmarrës duke mos llogaritur dot kostot pasi ju nuk përcaktoni produktet. Sa metra kabull kerkojne keto kamera per tu instaluar? A duhen kanalina duhen? Tubo duhen? Kuti per kamerat duhen? Koka rrjeti duhen?

Karakteristikat Vlerat specifike minimale

Numri i kanaleve hyrëse 8 kanale ose me shume

Outgoing Bandwidth Min 150 Mbps

Rezolucioni maksimal në regjistrim Min 12 MP Synchron Playback deri në 8 kanale

Formati i Videos H.264 ose me mire

Kapaciteti i numrit të Hard-disqeve 2

Kapaciteti fizik i disqeve Deri në 8 TB

HDD te përfshira 2x4TB HDD

Porta e rrjetit Min 2x RJ-45 10/100/ 1000 Mbps

Portat USB 2xUSB 2.0 ose me shume; 1xUSB 3.0 ose me shume;

Temperaturat e operimit 0 deri në +45° C

Me Siper kerkoni nje NVR qe te jete minimalisht 12 MPX nderkohe qe kamerat i kerkoni jo me shume se 8 MPX. Keni Arsye? Kerkojme uljen e rezolucionit minimal te NVR nga 12 MPX ne 8 MPX. Kerkojme riformulimin e te gjitha parametrave Teknik te NVR pasi nuk jepni informacione cili do të jete procesori minimal i pranuar per NVR? Kush do jete bandëithi ne hyrje i kesaj NVR pasi kerkoni vetem daljen? NVR duhet te kete minimalisht nje porte VGA apo nje Porte HDMI apo 10 porta ??? Nuk e kuptojmë se si AK ka marrë oferta për një projekt ku nuk janë

përcaktuar as specifikimet teknike minimale!!! Kur thoni kapaciteti fizik i disqeve 8 TB kuptoni nje HDD duhet te jete 8 apo te dy 8? Cfare lloji duhet te jene HDD 2.5 apo 3.5?

Kerkojme që AK minimalisht të bëjë perkthimin ne gjuhen shqipe te fjalive qe jane Anglisht dhe COPY Paste nga katalogët e operatorit të paracaktuar per të fituar këtë kete procedure.

Karakteristikat Vlerat specifike minimale

Tipi i kameres (“Type of camera”) Bullet

Procesori i figures (“Image Sensor”) Progressive Scan CMOS sensor 1/2”

*Rezolucioni i figures (“Resolution”) Minimumi 3840*2160*

Frekuenca e kuadrove (“Frame Rate”) 20 fps

Reduktimi i zhurmes (“Noise Reduction”) 3D DNR

Tipi i lenteve (“Lens Type”) E Motorizuar

Gjatesia fokale (“Local length”) 2.8 ~ 12mm,

Ndjeshmeria drites në 50 IRE, (“Min. Illumination @50IRE,) Color 0.01 lux; B/W 0 lux with IR

Ndriçimi Infra të Kuqe (“IR illuminators”) 40 m;

Rezistenca ndaj pluhurit dhe shiut IP67

Dite/Nate (“Day/Night”) R cut filter

Diapazoni dinamik i djeshmerise, (Wide Dynamic range) Po (“Yes”), min 120 dB

Formati i kompresimit të Videos H.264 ose me mire

Dedektim i levizjes (“Motion Detection”) Po

Formati i kompresimit të Videos H.264 ose me mire

Dedektim i levizjes (“Motion Detection”) Po

Pajtueshmeria e sistemit (“System support”) ONVIF

Multi-streaming Min. Dual stream

Temperatura e operimit (“Operating Temperature”) -10°C +50°C

Ushqimi (“Power”) PoE

Aksesore per montimin Po, sipas tipit të kameres dhe menyres se montimit

I.S.S shpk i ka kërkuar AK të saktësojë : Me cfare do lidhet kamera me NVR? Me ëireles apo me kabull? Nqs duhet kabell sa metra duhen ? Si do kaloje. Kerkojme te rishikoni te gjitha specifikimet e mesiperme te kameres pasi janë vetëm për një prodhues të paracaktuar?

Edhe në lidhje me sa më sipër AK pretendon AK ka lënë që cdo operator ekonomik të sjellë zgjidhjen për të gjitha sistemet e kërkuara! Kjo vlen edhe për sistemin e kamerave! Të gjitha pikat e tjera janë lënë evazive, madje edhe kërkesa për të përkthyer është refuzuar me pretendimin se: Parametrat teknik të cilët njihen gjerësisht në gjuhën angleze referuar edhe standarteve ndërkombëtare, AK ka zgjedhur mos ti shqipërojë për të mos krijuar konfuzion tek OE!!!

Kërkojmë që AK të detyrohet të përcaktojë saktë cdo mall që kërkon qoftë në sasi qoftë në specifikime teknike pasi kjo është një procedurë blerje dhe jo konkurs projektimi që të lihet në dorë të zgjidhjeve të ofruara nga operatorët ekonomik.

ANKESË NR.17

Pika 9.2.1.3 Sëitch për sistemin e kamerave parashikon se: Sëitch do të përdoret për të ushqyer me POE kamerat e instaluara per monitorimin e dhomes se serverave.

Modeli I montueshem ne rack, 1U, aksesore te perfshira

Nderfaqet 24 RJ-45 auto-negotiating 10/100/1000 POE+ ports

Memorja Min 32MB flash

Min 128MB RAM
Min 512 KB packet buffer
Kapaciteti/Performanca Switching capacity min: 50 Gbps
Throughput min.: deri ne 40 Mpps
Mac-Address table: Min 8000 Entries
Routing Table min 32 entries
Karakteristika L2 Switch Spanning Tree Protocol (STP)
BPDU filtering
Jumbo frame support
VLAN support and tagging
supports IEEE 802.1Q; 256 VLANs with a VLAN ID range 2-4093
Karakteristika L3 Static IPv4 routing
DHCP relay
Address Resolution Protocol (ARP)
Siguria Advanced access control lists (ACLs)
IEEE 802.1X and RADIUS network logins
Secure Socket Layer (SSL)
Port Isolation
Automatic VLAN assignment
Automatic denial-of-service protection
Management password
QoS 802.1p Quality of Service
Type of Service (ToS)
COS based on: 802.1p priority Queues, DSCP
Advanced Classifier based QoS
Rate Limit
Manaxhimi WEB with SSL (HTTPS)
SNMP: Supports v1/v20/v3
Remote Monitoring (RMON)
FTP, TFTP, or SFTP support
Netëork Time Protocol (NTP)
Port mirroring
POE poëer 370 W PoE+
Fuqia/Ambienti AC Poëer Input
Temprature operacionale: 0 - 40 degree Celsius
Lageshtira: 15% to 90%, noncondensing
Garancia Min 1 vit

Specifikimet Teknike te switch jane marre COPY PASTE nga nje prodhues i paracaktuar per të fituar kete projekt.

Kerkojme perkthimin ne gjuhen shqipe te ketyre specifikimeve teknike. Kerkojme riformulimin e ketyre specifikimeve duke pare qe kerkoni ta bllokoni projektin me kete switch. Si mundet te kerkoni nje sëitch qe do mbaje ne pune 5 kamera dhe sëitchi ka parametra per te mbajtur edhe 25 kamera apo 100? Si ta quajmë kete fakt shperdorim fondesh ne kohe Pandemie apo bllokim projekti me nje prodhues te paracaktuar? Per cfare kerkohen porta 1000 Mbps kur kamerat jane 100 mpbs??? Si e shpjegoni qe ju si njesi per pergatitjen e kritreve ne disa produkte vendosni

kritere deri ne detaje ku vetem nje operator i permbush dhe ne disa produkte nuk vendosni asnje kriter? Si shpjegohet nga ana e AK qe disa specifikime teknike jane ne shqip dhe disa te tjera anglisht?

Të gjitha ankesat e listuara më sipër tregojnë haptazi se kemi të bëjmë me një përpjekje të AK për të paracaktuar fituesin e kësaj procedure duke sajuar një tender të dyshimtë dhe duke vendosur kritere kufizuese e përjashtuese flagrante. Në lidhje me këtë fakt dëshirojmë të sjellim në vëmendje të AK kërkesat e legjislacionit të prokurimeve si më poshtë: Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Vetë KPP, në një sërë vendimesh të vetat e ka qartësuar qëndrimin e vet në lidhje me metodologjinë që duhet ndjekur nga AK në hartimin e specifikimeve teknike. P.sh. në Vendimin nr.256/2017, KPP shprehet se: "Në hartimin e kritereve dhe/ose specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se kriteret dhe/ose specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, parashikuar edhe nga neni 27 pika 1 e aktit nënligjor në zbatim të ligjit VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Edhe kjo kërkesë është refuzuar nga AK ndaj kërkojmë ndërhyrjen e KPP për korrigjimin e këtyre shkëlqjeve dhe detyrimin e AK të përkthjejë specifikimet teknike në gjuhën shqipe. [...]"

II.5.Në datë 09.07.2020, nëpërmjet shkresës me nr.2038/1prot., datë 08.07.2020, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Integrated Security Solutions" sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: "[...]ANKESË NR.1. AK pas shpalljes së procedurës kishte përcaktuar se afati i fundit për dorëzimin e ofertave ishte data 06.07.2020. Me pranimin "pjesërisht" të ankesës tonë AK bëri modifikimin e DST dhe ndryshoi datën e fundit për dorëzimin e ofertave në 10.07.2020.

Nguti i AK për të shpallur fituesin e paracaktuar të kësaj procedure, ka bërë që të mos respektojë as kufijtë më minimal ligjor të përcaktuar në Nenin 42 të LPP i cili parashikon se: 2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë. Sic mund të kuptohet lehtësisht edhe nga kushdo që nuk ka njohuri minimale për LPP, afati kohor për dorëzimin e ofertave duhej të zgjatej me 5 ditë dhe jo me 4 (në rastin më të mirë) sic ka bërë AK. Sjellim në vëmendjen Tuaj se parimi kryesor i legjislacionit shqiptar civil e administrative është se: Kur afati është caktuar me ditë dhe me orë, përjashtohet dita dhe ora në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Kërkojmë që të zgjatet afati kohor për dorëzimin e ofertave në përputhje me Nenin 42 të LPP [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Pretendimi i mësipërm është ngritur vetëm në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe jo në ankesën e depozituar pranë autoritetit kontraktor, në respekt të shkallëve të ankimimit përcaktuar në ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 63, pika 1.1 dhe 7 ku parashikohet se: “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni. [...]. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme.”

III.1.2. KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues, në respektim të shkallëve të ankimit, duhet të kishte ngritur këto pretendime pranë autoritetit kontraktor, ashtu sikurse është përcaktuar specifikisht në ligjin e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se nuk mund të shprehet mbi pretendime të cilat nuk janë bërë paraprakisht objekt ankese pranë autoritetit kontraktor. Objekti i ankesës së paraqitur pranë autoritetit kontraktor, në respekt të shkallëve të ankimit, nuk mund të shtohet në momentin e paraqitjes në KPP.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk merret në shqyrtim.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Integrated Security Solutions” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]ANKESË NR.2 I.S.S shpk në ankesën drejtuar AK ka kërkuar që: Të bëhet ndarja në Lote pasi AK kërkon 2 mallra të fushave të ndryshme brenda të njëjtit objekt. Konkretisht kërkohet prokurimi i sistemeve të kondicionit dhe sistemeve të sigurisë në përbërje të të njëjtit tender. Ne Nenin 9 pika 5 te VKM Nr. 914 “ Per rregullat e Prokurimit Publik” percaktohet se: “Kontrata ndahet në lote, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t’i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor. Në çdo rast, kur kontrata ndahet në lote, për efekt

të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit, vlera limit e kontratës do të jetë shuma e vlerës së secilit lot.” Nderkohe që në Nenin 29 ndër të tjera përcaktohet se: Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit. “ Sa më sipër duke marrë në konsideratë faktin se kompanitë që ofrojnë sisteme sigurie nuk montojnë kondicionera sic pretendon AK, kërkojmë minimalisht ndarjen e kësaj procedure në Lote [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Referuar Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2 prashikohet shprehimisht se: *“Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik d) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; e) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;”*

III.2.2. Në nenin 9, pika 5 e të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Kontrata ndahet në LOTE, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i vogël operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t’i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit, të vogël e të mesëm, apo për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor.”*

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, KPP konstaton se objekti i këtij prokurimi është realizimi i dhomës së serverave, në vaun e dejës dhe krijimi i kushteve teknike në hec vau i dejës, hec koman dhe hec fierzë, furnizimit dhe vendosjes të pajisjeve të ndryshme.

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit (hartimit të kriterëve kualifikuese nga njësia e prokurimit) pasi ndikon drejtperdrejt në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit. Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit sipas pretendimit të ankimuesit, një lot furnizimin dhe vendosjen e kondicionerëve dhe një lot furnizimin dhe vendosjen e pajisjeve të tjera, do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësisë duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës, ndërkohë që në thelb të gjithë artikujt që do të furnizohen dhe vendosen, janë pjesë e një projekti dhe për realizimin e një qëllimi. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor ka vepruar drejtë dhe në përputhje me frymën e legjislacionit të sipërpërmendur.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Integrated Security Solutions” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]ANKESË NR. 3

I.S.S shpk ka paraqitur ankesë pranë AK në lidhje 2.3.2 të DST në të cilën parashikohet se: 2.3.2. Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zotërojë dhe të paraqesë Licencën Profesionale të lëshuar nga institucione të autorizuar me ligj, në kategoritë si më poshtë: NP-3A , NS-12A, NS-13A, NS-14A. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike, Licensat profesionale duhet ti paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale. Në lidhje me këtë kërkesë I.S.S shpk ka pretenduar që: Licenca e kërkuar më sipër lëshohet për kompanitë që ushtrojnë veprimtari ndërtuese zbatimi ndërkohë që objekti i prokurimit të këtij tenderi është blerje e mallrave të nevojshëm për ndërtimin e dhomës së serverave kryesisht pajisje sigurie dhe kondicioner. Nga konsultimi me VKM Nr. 943, datë 28.12.2016, i ndryshuar rezulton se kategoritë e kërkuara nga AK janë si më poshtë: NP-3 Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada. Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. N.S-12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit. Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi. N.S-13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni. Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme. N.S-14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV. Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme. Duke marrë në konsideratë Zërin “Punime civile të specializuara” në DST gjykojmë se kërkesa për paraqitjen e licencës me kategoritë si më sipër është e ekzagjeruar dhe diskriminuese ndaj kërkojmë heqjen e këtij kriteri. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën nr.9, pika 2.3.2 “Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zotërojë dhe të paraqesë Licencën Profesionale të lëshuar nga institucione të autorizuar me ligj, në kategoritë si më poshtë: NP- 3A , NS-12A, NS-13A, NS-14A .

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike, Licensat profesionale duhet ti paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale”

III.3.2. Në shtojcën nr.12, “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

“

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	<i>Punime civile jo te specializuara</i>	<i>set</i>	<i>1</i>
2	<i>F.V. Dysheme Teknologjike</i>	<i>m2</i>	<i>25</i>
3	<i>F.V. Dere zjarrduruese</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>
4	<i>F.V. Kafaz Faradai</i>	<i>set</i>	<i>1</i>
5	<i>F.V. Panel Elektrik jashte murit te kompletuar me te gjithë aksesoret per montim</i>	<i>set</i>	<i>2</i>
6	<i>Instalime elektrike ne dhomen e serverave (perfshi ndricuesit linear, ndricues emergjence dhe aksesoret perkates, kanalinat dhe kabllot, tokezim etj.)</i>	<i>set</i>	<i>1</i>
7	<i>F.V. UPS 20KVA me 25 min autonomi</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>
8	<i>F.V. PDU 32A</i>	<i>copë</i>	<i>8</i>
9	<i>F.V. Sistem Kondicionimi min. 17kW</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>
10	<i>F.V. Rack 42U 800 x 1200mm</i>	<i>copë</i>	<i>4</i>
11	<i>F.V. Network (perfshi FO, CU, patchpanele dhe menaxhues kablli, menaxhues ajri, kanalinen e verdhe, aksesor etj.)</i>	<i>set</i>	<i>1</i>
12	<i>F. V. Sistem i detektimit dhe fikjes se zjarrit</i>	<i>set</i>	<i>1</i>
13	<i>F.V. Sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit</i>	<i>set</i>	<i>1</i>
14	<i>F.V. Sistem CCTV (5 kamera, NVR, switch PoE)</i>	<i>Set</i>	<i>1</i>
15	<i>F.V. Sistem akses kontrolli</i>	<i>Set</i>	<i>1</i>
16	<i>F.V Rack outdoor në HEC Vau i Dejës</i>	<i>cope</i>	<i>2</i>
17	<i>Sistemim rack 42 U me aksesore +2 PDU 10A në HEC Fierzë</i>	<i>set</i>	<i>1</i>
18	<i>F.V Kondicioner 18.000 BTU në HEC Fierzë</i>	<i>cope</i>	<i>1</i>
19	<i>Zhvendosje, Instalim dhe sistemim rack-u ekzistues 42 U me aksesore +2 PDU 10A në HEC Koman</i>	<i>set</i>	<i>1</i>
20	<i>F.V KVM console me ekran min 17” + KVM switch per te lidhur min 4 pajisje</i>	<i>cope</i>	<i>1</i>
21	<i>F.V KVM Switch per të lidhur min 4 pajisje</i>	<i>cope</i>	<i>2</i>
22	<i>F.V Fiber optike 24SM dhe terminim</i>	<i>set</i>	<i>1</i>
23	<i>Trajnim</i>	<i>ditë</i>	<i>3</i>

”

III.3.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.3.4. Në lidhjen nr.3 të VKM nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, sqarohet:

“N.P. 3 Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje

N.S - 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

N.S - 13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

N.S- 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t’u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme”.

III.3.5. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjestim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.3.6. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.3.7. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, ku të përfshihen kategoritë e punimeve NP- 3A , NS-12A, NS-13A, NS-14A. Bazuar në specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, pajisjet që do të blihen dhe instalohen, si dhe punimet që janë parashikuar të kryhen për instalimin e tyre, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është një kërkesë në përputhje VKM nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, si dhe volumin dhe objektin e kontratës që prokurohet, pasi janë parashikuar të kryhen punime dhe instalime të tilla që kërkojnë disponimin e kategorive të licencës profesionale NP- 3A , NS-12A, NS-13A, NS-14A.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Integrated Security Solutions” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]ANKESË NR. 4

I.S.S shpk ka paraqitur ankesë pranë AK në lidhje me pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik ku parashikohet se: Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat ISO ose ekuivalentin e tyre si me poshte: ISO 9001 :2015/ ose të përditësuar “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” ; ISO 14001 :2015/ ose të përditësuar “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”; ISO 18001-2007 ose 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”; ISO/IEC 20000-1:2011 / 2018 ose të përditësuar “Për menaxhimin e shërbimeve sistemeve IT”. ISO 27001 :2013 ose të përditësuar “Për menaxhimin e sigurisë së informacionit”. Certifikatat e mësipërme kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, dhe të jenë në përputhje me nenin 30 të V.K.M. Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar. Në rast të bashkimit të operatoreve ekonomike ISO duhen plotësuar prej secili nga operatorët ekonomike. Kërkojmë heqjen e : ISO 14001 :2015/ ose të përditësuar “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”; ISO 18001-2007 ose 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”; ...pasi nuk kanë lidhje me objektin e prokurimit !!! [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën nr.9, pika 2.3.3 “Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat ISO ose ekuivalentin e tyre si më poshtë:

- 1)ISO 9001:2015/ ose të përditësuar “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” ;*
- 2)ISO 14001:2015/ ose të përditësuar “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;*
- 3)ISO 18001-2007 ose 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;*
- 4)ISO/IEC 20000- 1:2011 / 2018 ose të përditësuar “Për menaxhimin e shërbimeve sistemeve IT”.*
- 5)ISO 27001:2013 ose të përditësuar “Për menaxhimin e sigurisë së informacionit”.*

Çertifikatat e mësipërme kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, dhe të jenë në përputhje me nenin 30 të V.K.M. Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.

Ne rast të bashkimit të operatoreve ekonomike ISO duhen plotësuar prej secili nga operatorët ekonomike”

III.4.2. Më anë të shtojcë mbi modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka ndryshuar kriterin e mësipërm, si më poshtë vijon:

“Pika 2.3.3 Ishte:

2.3.3. Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat ISO ose ekuivalentin e tyre si më poshtë:

- 1)ISO 9001:2015/ ose të përditësuar “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” ;*
- 2)ISO 14001:2015/ ose të përditësuar “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;*
- 3)ISO 18001-2007 ose 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;*
- 4)ISO/IEC 20000- 1:2011 / 2018 ose të përditësuar “Për menaxhimin e shërbimeve sistemeve IT”.*
- 5)ISO 27001:2013 ose të përditësuar “Për menaxhimin e sigurisë së informacionit”.*

Çertifikatat e mësipërme kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, dhe të jenë në përputhje me nenin 30 të V.K.M. Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike ISO duhen plotësuar prej secili nga operatorët ekonomike.

Pika 2.3.3 Bëhet:

2.3.3. Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat ISO ose ekuivalentin e tyre si më poshtë:

- 1)ISO 9001:2015/ ose të përditësuar “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” ;*
- 2)ISO 14001:2015/ ose të përditësuar “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;*
- 3)ISO 18001-2007 ose 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;*
- 4)ISO/IEC 20000- 1:2011 / 2018 ose të përditësuar “Për menaxhimin e shërbimeve sistemeve IT”.*
- 5)ISO 27001:2013 ose të përditësuar “Për menaxhimin e sigurisë së informacionit”.*

Çertifikatat e mësipërme kërkohen të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit, dhe të jenë në përputhje me nenin 30 të V.K.M. Nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomike:

-Secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 18001-2007 ose 45001:2018.

-Operatori Ekonomik, i cili do të kryej integrimin dhe instalimin e të gjithë pajisjeve në BMS, duhet të dorëzojë certifikatat ISO/IEC 20000- 1:2011 / 2018 dhe ISO 27001:2013”

III.4.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”.

III.4.4. Në nenin 30 të Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, “Kërkesat e cilësisë”, përcaktohet se: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”

III.4.5. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik kryen aktivitetin objekt prokurimi sipas standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes të certifikatave si ISO 9001:2015/ ose të përditësuar “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”; ISO 14001:2015/ ose të përditësuar “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”; ISO 18001-2007 ose 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”; ISO/IEC 20000- 1:2011 / 2018 ose të përditësuar “Për menaxhimin e shërbimeve sistemeve IT”; ISO 27001:2013 ose të përditësuar “Për menaxhimin e sigurisë së informacionit”. KPP thekson se, autoriteti kontraktor duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Certifikatave ISO 14001:2015/ ose të përditësuar “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”; ISO 18001-2007 ose 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”, është në përpjesëtim me objektin e kontratës si dhe

në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Ndaj KPP gjykon se në përgjigje të testit të proporcionalitetit, kërkitimi i autoritetit kontraktor mbi disponueshmërinë e certifikatave të mësipërme, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e procedurës dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme. Këto certifikime i japin garanci autoritetit kontraktor lidhur me aftësinë dhe kapacitetet që disponon operatori ekonomik për menaxhimin e shëndetit e sigurisë në punë, si dhe menaxhimin e mjedisit, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Integrated Security Solutions” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]ANKESË NR. 5

I.S.S shpk ka paraqitur ankesën në lidhje me pikën 2.3.6 ku parashikohet se: 2.3.6. Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mesatarisht të paktën 30 punonjës, të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Mars 2020 - Maj 2020. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqitet: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ose nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën Mars 2020 - Maj 2020. Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore si pas formularit E/Sig-25 për periudhën e mësipërme Mars 2020 - Maj 2020. Ankesa jonë lidhet me faktin se numri i punonjësve të kërkuar në këtë pikë është i ekzagjeruar dhe synon kufizimin e konkurrencës. Nëse numërojmë numrin e inxhnierëve dhe specialistëve që vetë AK ka kërkuar në pikën tjetër rezulton se numri total është 15. Nuk e kuptojmë pse AK duhet të dyfishojë numrin e fuqisë punëtore??? Njëpër një kërkesës për disponimin në staf të 30 punonjësve, autoriteti kontraktor ka tejkaluar natyrën dhe përmasat e kontratës pasi një numër i tillë punonjësish është tërësisht joproporcional me objektin e prokurimit. Sjellim në vëmendjen tuaj përcaktimet ligjore se Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën nr.9, pika 2.3.6 “Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar mesatarisht të paktën 30 punonjës, të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Mars 2020 - Maj 2020. Në lidhje me këtë pikë duhet të paraqitet: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ose nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën Mars 2020 - Maj 2020. Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore sipas formularit E/Sig-25 për periudhën e mësipërme Mars 2020 - Maj 2020”

III.5.2. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që

autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

III.5.3. Në interpretim literal të bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni vlerëson se, kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën, si dhe përmasat/volumin e kontratës. Megjithatë, referuar kriterit për disponimin nëpërmjet listpagesave, të një numri mesatar prej 30 punonjësish, Komisioni vlerëson se autoriteti kontraktor ka tejkaluar natyrën dhe përmasat e kontratës, pasi një numër i tillë punonjësish është joproportional me objektin e prokurimit. Për autoritetin kontraktor e rëndësishme të provohet disponimi i punonjësve, por kjo duhet të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme duke pasur parasysh elementë të tillë si natyra e kontratës dhe volumi i saj. Komisioni vlerëson se, kriteri i sipërcituar nuk është hartuar tërësisht në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, pasi ka kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke përfshirë në të vetëm ata operatorë të cilët plotësojnë numrin e kërkuar prej 30 punonjësish, si dhe duke përjashtuar kështu operatorë të tjerë ekonomikë të cilët edhe pse mund të garantojnë zbatimin e kontratës, si dhe mund të përmbushin të gjitha kriteret kualifikuese për këtë procedurë prokurimi, do të penalizohen vetëm për faktin se nuk përmbushin numrin e kërkuar të punonjësve, i cili në rastin konkret është i ekzagjeruar. Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm, duke e ulur numrin mesatar të punonjësve të cilët duhet të jenë të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Mars 2020 - Maj 2020.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Integrated Security Solutions” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]Kërkojmë heqjen e kërkesës për 1 inxhinier mekatronik pasi AK thjesht do të blejë kondicionerë, nuk kërkon prodhimin e tyre!!! Kërkesa për inxhinier mekanik/mekatronik është e ekzagjeruar dhe kufizon pjesëmarrjen! Më tej AK vijon: Tjetër gjë është të shesë dhe tjetër gjë është të instalojë dhe konfigurojë pajisjen. AK justifikon nevojën për inxhinierin mekanik/mekatronik me instalimin e kondicionerëve?! Po specialisti për instalimin e kondicionerëve çfarë pune do të bëjë??? AK ka saktësuar autoritetin kompetent për lëshimin e certifikatave dhe më tej përcaktuar se: AK do të lejojë që një inxhinier mund të ketë deri në 2 certifikime. Kërkojmë heqjen e këtij kriteri pasi është kufizues dhe përjashton mundësinë e pjesëmarrjes së profesionistëve të vërtetë të cilët zotërojnë më shumë se 2 kualifikime. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën nr.9, pika 2.3.7 “Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“2.3.7. Operatori Ekonomik ofertues duhet ketë pjesë të stafit të tij, minimalisht punonjësit si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier mekanik ose mekatronik i certifikuar për sistemet e kondicionimit që do të ofertojë.*
- 1 (një) inxhinier elektrik, ose inxhinier elektronik/informatikë, i certifikuar për sistemet e UPS që do të ofertojë.*

- 1 (një) inxhinier elektrik, ose inxhinier elektronik /informatikë, i certifikuar për sistemin e BMS që do të ofertojë.
 - 1 (një) inxhinier elektronik ose telekomunikacioni/informatikë i certifikuar për sistemin e Kamerave që do të ofertojë.
 - 1 (një) inxhinier elektronik ose telekomunikacioni /informatikë i certifikuar për sistemin e akses kontrollit që do të ofertojë.
 - 1 (një) inxhinier elektronik, ose telekomunikacioni/informatikë i certifikuar për Menaxhim të Shërbimeve IT (Certifikata ITIL ose ekuivalente).
 - 1 (një) inxhinier elektronik ose telekomunikacioni /informatikë i specializuar për ndertimin e rrjetit Data dhe fiber optike që do të ofertojë.
- 2 (dy) specialist ose teknik për instalime në tension të ulët.
 - 1 (një) specialist ose teknik të specializuar në instalimet e sistemit të kondicionit.
 - 1 (një) specialist ose teknik të specializuar në instalimet e sistemit të BMS.
 - 1 (një) specialist ose teknik të specializuar për instalim kamerash.
 - 1 (një) specialist ose teknik të specializuar për akses kontroll.
 - 1 (një) specialist ose teknik të specializuar për sistemin e zjarrit
 - 1 (një) specialist ose teknike të certifikuar për instalime të rrjetit Data dhe fiber optike.

Për të vërtetuar këtë pikë, duhet të paraqitet:

Për inxhinierët: Diplomë inxhinierike, Kontratë Pune, CV, Certifikatat përkatëse dhe Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore sipas formularit E/Sig-25 për periudhën Mars 2020 - Maj 2020.

Për specialistët ose teknikët: Kontrate Pune, CV, Certifikatat përkatëse dhe Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore sipas formularit E/Sig-25 për periudhën Mars 2020 - Maj 2020”

III.6.2. Më anë të shtojcës mbi modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka ndryshuar kriterin e mësipërm, si më poshtë vijon:

“Pika 2.3.7 Ishte:

2.3.7. Operatori Ekonomik ofertues duhet ketë pjesë të stafit të tij, minimalisht punonjësit si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier mekanik ose mekatronik i certifikuar për sistemet e kondicionimit që do të ofertojë.
- 1 (një) inxhinier elektrik, ose inxhinier elektronik/informatikë, i certifikuar për sistemet e UPS që do të ofertojë.
- 1 (një) inxhinier elektrik, ose inxhinier elektronik /informatikë, i certifikuar për sistemin e BMS që do të ofertojë.
- 1 (një) inxhinier elektronik ose telekomunikacioni/informatikë i certifikuar për sistemin e Kamerave që do të ofertojë.
- 1 (një) inxhinier elektronik ose telekomunikacioni /informatikë i certifikuar për sistemin e akses kontrollit që do të ofertojë.
- 1 (një) inxhinier elektronik, ose telekomunikacioni/informatikë i certifikuar për Menaxhim të Shërbimeve IT (Certifikata ITIL ose ekuivalente).

•1 (një) inxhinier elektronik ose telekomunikacioni /informatikë i specializuar per ndertimin e rrjetit Data dhe fiber optike që do të ofertojë.

•2 (dy) specialist ose teknik për instalime në tension të ulët.

•1 (një) specialist ose teknik të specializuar në instalimet e sistemit të kondicionit.

•1 (një) specialist ose teknik të specializuar ne instalimet e sistemit te BMS.

•1 (një) specialist ose teknik të specializuar për instalim kamerash.

•1 (një) specialist ose teknik të specializuar për akses kontroll.

•1 (një) specialist ose teknik të specializuar për sistemin e zjarrit

•1 (nje) specialist ose teknike të certifikuar për instalime te rrjetit Data dhe fiber optike.

Për të vërtetuar këtë pikë, duhet të paraqitet:

Për inxhinierët: Diplomë inxhinierike, Kontratë Pune, CV, Certifikatat përkatëse dhe Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore sipas formularit E/Sig-25 për periudhën Mars 2020 - Maj 2020.

Për specialistët ose teknikët: Kontrate Pune, CV, Certifikatat përkatëse dhe Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore sipas formularit E/Sig-25 për periudhën Mars 2020 - Maj 2020

Pika 2.3.7 Bëhet:

2.3.7. Operatori Ekonomik ofertues duhet ketë pjesë të stafit të tij, minimalisht punonjësit si më poshtë:

•1 (një) inxhinier mekanik ose mekatronik i certifikuar për sistemet e kondicionimit që do të ofertojë.

•1 (një) inxhinier elektrik, ose inxhinier elektronik/informatikë, i certifikuar për sistemet e UPS që do të ofertojë.

•1 (një) inxhinier elektrik, ose inxhinier elektronik /informatikë, i certifikuar per sistemin e BMS që do të ofertojë.

•1 (një) inxhinier elektronik ose telekomunikacioni/informatikë i certifikuar për sistemin e Kamerave që do të ofertojë.

•1 (një) inxhinier elektronik ose telekomunikacioni /informatikë i certifikuar për sistemin e akses kontrollit që do të ofertojë.

•1 (një) inxhinier elektronik, ose telekomunikacioni/informatikë i certifikuar për Menaxhim të Shërbimeve IT (Certifikata ITIL ose ekuivalente).

•1 (një) inxhinier elektronik ose telekomunikacioni /informatikë i specializuar per ndertimin e rrjetit Data dhe fiber optike që do të ofertojë.

•2 (dy) specialist ose teknik për instalime në tension të ulët.

•1 (një) specialist ose teknik të specializuar në instalimet e sistemit të kondicionit.

•1 (një) specialist ose teknik të specializuar ne instalimet e sistemit te BMS.

•1 (një) specialist ose teknik të specializuar për instalim kamerash.

•1 (një) specialist ose teknik të specializuar për akses kontroll.

•1 (një) specialist ose teknik të specializuar për sistemin e zjarrit

•1 (nje) specialist ose teknike të certifikuar për instalime te rrjetit Data dhe fiber optike.

Për të vërtetuar këtë pikë, duhet të paraqitet:

Për inxhinierët: Diplomë inxhinierike, Kontratë Pune, CV, Certifikatat përkatëse të lëshuara nga institucionet kompetente kombëtare/ndërkombetare, ose çdo certifikatë e lëshuar për inxhinierin nga kompania/kompanitë prodhuese të sistemeve që do të instalohen, dhe Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore sipas formularit E/Sig-25 për periudhën Mars 2020 - Maj 2020.

Për specialistët ose teknikët: Kontratë Pune, CV, Certifikatat përkatëse të lëshuara nga institucionet kompetente kombëtare/ndërkombetare, ose çdo certifikatë e lëshuar për specialistin ose teknikun nga kompania/kompanitë prodhuese të sistemeve që do të instalohen, dhe Listëpagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore sipas formularit E/Sig-25 për periudhën Mars 2020 - Maj 2020.”

III.6.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.6.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar instalimeve që do të kryhen, të cilat lidhen drejtëpërdrejtë me sistemin e ftohjes, si dhe karakteristikat e këtyre instalimeve, vëren se kërkesa për disponimin e një inxhinieri mekanik ose mekatronik, i certifikuar për sistemet e kondicionimit që do të ofertojë dhe do të montojë/instalojë, është e justifikuar, si dhe nuk është një kërkesë e ekzagjeruar. Sa më sipër, K.P.P. gjykon se kriteri i mësipërm i vendosur nga autoritetit kontraktor që pjesë e stafit të jetë dhe një inxhinieri mekanik ose mekatronik, i certifikuar për sistemet e kondicionimit që do të ofertojë është në përputhje me volumin dhe natyrën e kontratës.

III.6.5. Ndërsa lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “AK do të lejojë që një inxhinier mund të ketë deri në 2 certifikime. Kërkojmë heqjen e këtij kriteri pasi është kufizues dhe përjashton mundësinë e pjesëmarrjes së profesionistëve të vërtetë të cilët zotërojnë më shumë se 2 kualifikime”, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkretë, Komisioni gjykon se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të sigurohet që operatorët ekonomik të disponojnë staf inxhinier të certifikuar në fushat përkatëse,

me qëllim kryerjen e instalimeve sipas ekspertizës më të mirë të mundshme, ndaj dhe kërkesa për disponimin e stafit inxhinier të certifikuar është tërësisht e përligjur. Por, përcaktimi i autoritetit kontraktor, se një inxhinier mund të ketë maksimumi 2 (dy) certifikime/kualifikime, është një kërkesë kufizuese dhe e panevojshme, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që operatorët ekonomik të disponojnë të gjithë kualifikimet dhe ekspertizën e nevojshme inxhinierike, pavarësisht nëse kjo ekspertizë ofrohet nëpërmjet një inxhinieri, apo disa inxhinierëve. Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipër, duke mos e kufizuar numrin e certifikimeve/kualifikimeve që duhet të disponojë një inxhinier për të përmbushur këtë kriter.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Integrated Security Solutions” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]ANKESË NR.7

I.S.S ka paraqitur ankesë në lidhje me pikën 2.3.8 ku përcaktohet se 2.3.8. Operatori Ekonomik ofertues për paisjet duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/ve të përkthyer në gjuhën shqipe në pjesën ku janë paraqitur të dhënat dhe karakteristikat teknike, në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike, të mallrave objekt prokurimi. Nuk e kuptojmë se çfarë dëshiron të thotë AK me pjesën: të përkthyer në gjuhën shqipe në pjesën ku janë paraqitur të dhënat dhe karakteristikat. Në DST është përcaktuar qartë se gjuha e përdorur do të jetë Gjuha Shqipe ndaj i gjithë dokumentacioni që do të paraqitet do të jetë në gjuhën Shqipe. A do të pranojë AK që një pjesë e katalogur të jetë në gjuhë kineze psh dhe vetëm pjesa e specifikimeve teknike të jetë në shqip??? Sjellim në vëmendje të AK se të gjithë dokumentat e dorëzuar në tender duhet të jenë të përkthyer dhe noterizuar sipas ligjit dhe këto parashikime nga AK shërbejnë vetëm për të krijuar konfuzion tek O.E dhe për ti dhënë AK mudësinë që të jetë abuziv gjatë procesit të kualifikimit. Kërkojmë modifikimin e pikës 2.3.8 si më poshtë: 2.3.8. Operatori Ekonomik ofertues për paisjet duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/ve të përkthyer në gjuhën shqipe në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike, të mallrave objekt prokurimi. Në përgjigjen e tij AK ka refuzuar ankesën tonë me pretendimin se: Nisur nga fakti se gjuha e pranuar ndërkombëtaësh është gjuha angleze, dhe me qëllimin për tu ardhur në ndihmë operatorëve ekonomik, për të bërë të mundur uljen e kostove të përkthimit, është kërkuar që të përkthehen në gjuhën shqipe vetëm pjesët ku janë paraqitur të dhënat dhe karakteristikat teknike të mallrave objekt prokurimi. Kërkojmë detyrimin e AK të zbatojë ligjin dhe të përcaktojë se të gjithë dokumentat që do të dorëzohen duhet të jenë në gjuhën Shqipe!!! Nuk ka asnjë fakt që përcakton se gjuha angleze është gjuha e pranuar ndërkombëtarisht!!! [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën nr.9, pika 2.3.8 “Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon: “Operatori Ekonomik ofertues për paisjet duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/ve të përkthyer në gjuhën shqipe në pjesën ku janë paraqitur të dhënat dhe karakteristikat teknike, në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike, të mallrave objekt prokurimi”

III.7.2. Në nenin 14 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar shprehimisht: *“Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”*

III.7.3. Bazuar në përcaktimin e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Komisioni vlereson se, në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetar, gjuha e përdorur duhet të jetë tërësisht në gjuhën shqipe, si nga ana e autoritetit kontraktor në hartimin e dokumentave të tenderit, gjithashtu edhe nga ana e operatorëve ekonomik ofertues në hartimin e ofertave, ku pjesë e ofertës janë edhe dokumentacioni tekniko-ligjor, me anë të të cilit vërtetohet përmbushja e kriterëve të kualifikimit. Në rastin konkretë, Komisioni gjykon se kriteri mësipërm i kualifikimit, nuk është hartuar në përputhje të plotë me aktin nënligjor të sipërcituar. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm në përputhje me nenin 14 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Integrated Security Solutions” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: *“[...]Në pikën 2.3.10 parashikohet se: 2.3.10. Operatori Ekonomik ofertues, për integrimin në BMS të paisjeve të sistemit elektrik, sistemit të kondicionimt me fryrje nga poshtë, UPS, PDU-së, paneleve elektrike, matëseve të tensionit, duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton integrimin e tyre. Formulimi i këtij kriteri është evaziv dhe madje krijon përshtypjen se AK as nuk e ka idenë se çfarë kërkon. AK të përcaktojë se çfarë dokumentacioni konkretë kërkon për këtë pikë!!! Në përgjigjen e tij ndonëse ka përcaktuar se kërkohet vërtetim prodhuesi ka refuzuar ankesën tonë. Kërkojmë detyrimin e AK për të formuluar saktë këtë kërkesë pasi vijon të mbetet evaziv dhe i paqartë. Kriteret e mësipërme të kualifikimit bien në kundërshtim me: Gërmën “c” dhe “ç” të nenit 1 të LPP, i cili parashikon se qëllimi i këtij ligji është: c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; Nenin 20 të LPP, i cili parashikon se: Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre. Nenin 28/2 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për R.P.P”, përcaktohet se në Kontratat e shërbimeve: Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.8.1. Në shtojcën nr.9, pika 2.3.2 “Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon: *“Operatori Ekonomik ofertues, për integrimin në BMS të paisjeve të sistemit elektrik, sistemit të kondicionimt me fryrje nga poshtë, UPS, PDU-së, paneleve elektrike, matëseve të tensionit, duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton integrimin e tyre.*

Në rast se produktet janë të prodhuesve të ndryshëm, ofertuesit i duhet të paraqesë vërtetim nga secili prodhues, si ai i sistemeve ashtu dhe nga prodhuesi i BMS për integrimin e tyre. Mos paraqitja e vërtetimeve nga cdo prodhues është kusht për skualifikim”

III.8.2. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, konstatohet se me anë të shkresës nr.1836/3prot., datë 23.06.2020, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues lidhur me pretendimin e mësipërm, si më poshtë vijon:

“10) Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “ISS” sh.p.k për kriterin teknik 2.3.10 Operatori Ekonomik ofertues për integrimin në BMS të paisjeve të sistemit elektrik sistemit të kondicionimt me fryrje nga poshtë, UPS, PDU-së, paneleve elektrike, matëseve të tensionit, duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton integrimin e tyre. Autoriteti Kontraktor në kriteret teknike ka kërkuar : 2.3.10. Operatori Ekonomik ofertues, për integrimin në BMS të paisjeve të sistemit elektrik, sistemit të kondicionimt me fryrje nga poshtë, UPS, PDU-së, paneleve elektrike, matëseve të tensionit, duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton integrimin e tyre. Në rast se produktet janë të prodhuesve të ndryshëm, ofertuesit i duhet të paraqesë vërtetim nga secili prodhues, si ai i sistemeve ashtu dhe nga prodhuesi i BMS për integrimin e tyre. Mos paraqitja e vërtetimeve nga cdo prodhues është kusht për skualifikim. Bazuar sa më sipër, Komisioni sqaron se në lidhje me pikën 2.3.10 kërkohet integrimi në BMS të paisjeve të sistemit elektrik, sistemit të kondicionimt me fryrje nga poshtë, UPS, PDU-së, paneleve elektrike, matëseve të tensionit. Në rast se BMS do të jetë e të njëjtës markë/prodhuesi me një nga sistemet e kërkuara, do të pranohet vërtetimi i prodhuesit të BMS që ky sistem integrohet në BMS. Në rast se BMS do të jetë e një marke/prodhuesi të ndryshëm nga sistemi që kërkohet të integrohet do të pranohet si dokumentacion vërtetimi nga të dy prodhuesit, si nga prodhuesi i BMS-së ashtu dhe nga prodhuesi i sistemit që do të integrohet. Ne kete rast nuk do të pranohet si i vlefshëm vërtetimi nga vetëm një prodhues. Psh, nëse BMS dhe UPS janë të të njëjtit prodhues do të pranohet vërtetimi nga prodhuesi i vetëm. Nëse sistemi i kondicionimit është i ndryshëm nga ai i BMS, në këtë rast kërkohet nga prodhuesi i BMS se kondicioneri prodhim i prodhuesit përkatës integrohet në sistemin e tij, si dhe vërtetimi i prodhuesit të kondicionerit që sistemi tyre integrohet në BMS-në e prodhuesit përkatës. Vërtetimimet duhet të përmbajnë përvec informacionit të integrimit: emrin e prodhuesit, emri i personit të autorizuar nga prodhuesi, të dhëna mbi kompaninë si : numri i telefonit të prodhuesi, adresë e-mail.”

III.8.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “ [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.8.4. Në lidhje me kërkimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi para kërkimit për sqarime mbi kriterin e

vecantë të kualifikimit. Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimes nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteri kualifikues është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës), por në thelb është një paqartësi mbi kërkesën e autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik në ankesë në asnjë rast nuk ka pretenduar heqjen e këtij kriteri por ka theksuar paqartësinë në përmbushjen e tij.

Gjithashtu, KPP konstaton se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit, Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. 2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë.”*, ka dhënë sqarimet e nevojshme për operatorin ekonomik ankimes lidhur me kriterin e vendosur në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi, por këtë sqarim në zbatim të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së nuk e ka publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, me sqarimet e dhëna në kthimin e përgjigjes me anë të shkresës nr.1836/3prot., datë 23.06.2020, autoriteti kontraktor e ka bërë më të qartë se çfarë dokumentacioni kërkohet në përmbushje të kriterit të kualifikimit, por ky i fundit duhet të publikojë këtë sqarim me anë të shtojcës përkatëse, sikurse përcaktohet në nenin 42 pika 2 të L.P.P-së.

III.8.5. Ndërsa lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes *“ANKESË NR. 9*

Në Shtojcën 10 Specifikimet Teknike pika 1.2 Situata Aktuale rezulton si më poshtë Ne kete paragraf permenden disa herë pajisjet e kamerave dhe NVR neper Hecet ekzistuese. Video monitorimi ne keto objekte eshte pothuajse jashte funksionit, kjo e vertetuar me sakte dhe nga vizita e MB para disa ditesh qe u pasqyrua dhe ne media dhe ku me shume se 80% e kamerave nuk funksionojne. Ju lutem një sqarim si ka mundësi që Ju si AK kerkoni te beni nje projekt per dhomen e serverit nderkohe shumica e paisjeve fundore nuk u punojne? Kerkojme te na behet e ditur e gjithe infrastruktura ekzistuese qe keni per video monitorimin ne Digat e Vaut te Dejes dhe ne Hidrocentralet e tjera. Gjithashtu të jepet informacion nëse keto sisteme jane funksionale apo jo. AK pretendon se këto kërkesa janë jashtë objektit të kësaj procedure. Kërkojmë detyrimin e AK të përgjigjet e saktësojë për sa më sipër.

ANKESË NR. 10

Në Shtojcën 10 Specifikimet Teknike pika 2.1 Objektivi i Përgjithshëm rezulton si më poshtë: Krijimi i dhomes se serverëve (BCC-Site) sipas standarteve Teknike për KESH SH.A. Kërkojmë nga AK të na vërë në dispozicion standartet teknike për KESH sh.a !!! Ju lutem ne baze te ligjijt

te APP kerkojme perkthimin e kesaj fjalie ? Transferimi i pajisjeve dhe linjave të komunikimit ekzistuese. Lutem sqaroni nëse kerkohet dhe transferim i pajisjeve te video monitorimit ? Nëse po të jepen të dhëna të sakta në mënyrë që të kemi mundësi të llogarisim kostot. Minimizimi i probabilitetit të mosfunksionimit të sistemeve të informacionit nga faktorë të jashtëm; Rritja e sigurisë së informacionit. Ky term qe perdorni per objektivat eshte shume evaziv. Ju kerkoni te kryeni nje investim dhe thjesht doni te minimizoni probabilitetin? Sa esht koeficienti i minimizimit? Në përgjigjen e tij AK përcakton se: Për standartet teknike ankimesi duhet ti referohet standarteve kombëtare e ndërkombëtare!!! Lutemi detyrimin e AK për të përcaktuar se cilat janë këto standarte konkrete si dhe përgjigjen për pikat e tjera të cilat i ka lënë pa trajtuar.

ANKESË NR.13

Në Dst , për pikën 1.1 “Sistemi i detektimit te zjarrit” përcaktohet se: Dhoma e serverave duhet që të pajiset me sistem detektimi dhe sinjalizimi të zjarrit per te gjithë hapësiren (si per hapësiren e cila kufizohet nga dyshemeja teknologjike dhe tavani, ashtu edhe per hapësiren e cila kufizohet nga dyshemeja teknologjike dhe dyshemeja fikse. Pajisjet e alarmit të zjarrit do të instalohen sipas rregullave dhe standarteve lokale. Për detektimin e zjarrit duhet të vendosen në dhomën e serverave detektorë temperature dhe detektorë optikë tymi. Për sinjalizimin e alarmit të zjarrit do te vendosen sirena. Ky sistem duhet të ketë aftësi per t’u integruar me sistemet e tjera.

I.S.S shpk ka kërkuar në AK sqarimin e pikave si më poshtë: Kerkoni nje sistem per detektimin e zjarrit dhe nuk specifikoni cfare paisjesh do vendosen? Sa do jete sasia e detektoreve te temperatures? Sa do jete sasia e detektoreve optik te tymit? Shkruani qe do duhen sirena ne numrin shumes... SA SIRENA ??? KU do vendosen keto detektore ? Ku do vendosen sirenat ? Me cfare do lidhen sirenat me panelin e alarmit? Me cfare do lidhen detektorët me Panelin e alarmit? Me kabull? Me ëireless? Me radio? Kush jane specifikime teknike te paisjeve qe do pranohen nga AK? Sa eshte sasisa e kabullit qe duhet per te lidhur paisjet? Paneli I sistemit te detektimit dhe sinjalizimit te zjarrit do kete nje cabinet dhe cfare do vendoset aty? Ku do transmetoje dhe sinjalizoje ky panel? Si shpjegohet qe nje AK ben nje projekt dhe nuk jep asnje specifikim Teknik per sistemin qe kërkon? Si e keni parashikuar fondin limit te ketij projekti kur nuk keni asnje te dhene per keto paisje qe ju kerkoni? A eshte kryer ligjerisht procedura per llogaritjen e fondit limit ? A jane te faktuara kerkesat qe u keni bere OE qe kane marre pjese ne perrlllogaritjen e fondit limit ? Në përgjigjen e tij sërish AK i ka lënë evazive të gjitha kërkesat tona duke përcaktuar se cdo gjë do të jetë në varësi të zgjidhjes që O.E do të propozojë...ky është një tender furnizimi mallrash dhe jo një konkurs projektimi. Me cfarë kriteresh do të vlerësojë AK zgjidhje e ndryshme??? Kërkojmë përcaktimin dhe saktësimin e të gjitha zgjidhjeve të kërkuara nga AK dhe jo lënien e tyre në dorë të propozimeve të O.E pasi ky nuk është një konkurs. AK të përcaktojë sasi të materialeve të nevojshme dhe jo ti lërë në dorë të zgjidhjes së O.E. Nuk e kuptojmë se cfarë do të thotë përgjigjja: “Sasia e kabllit dhe cdo element tjetër i zgjidhjes do të përcaktohet nga OE në bazë të zgjidhjes së Simuluar” Kërkojmë që AK të detyrohet të përcaktojë saktë cdo mall që kërkon qoftë në sasi qoftë në specifikime teknike.

ANKESE NR. 15

Në Dst përcaktohet se: Extinguishant Release Control. Duhet të jepet mundësia për clirimin e agjentit shuarës të zjarrit manualisht me anë të një sëitch të veçantë (një Button Push ose ekuivalent). Butonat e Aktivizimit dhe Ndalimit Manual. Ne hyrjen e dhomes se serverave, jashte dhome, duhet te montohen butonat e Aktivizimit Manual dhe te Ndalimit Manual te sistemit te shuarjes. Butoni i Aktivizimit manual. Mund te perdoret nese kerkohet aktivizim i menjehershem

i sistemit te shuarjes (ne rast se vetem njeri nga dedektoret eshte aktivizuar dhe paneli ka kaluar ne gjendjen "Pre-alarm", personeli pergjegjes mund te shtype kete buton dhe te aktivizoj manualisht sistemin e shuarjes). Butoni i Ndalimit (ose vonimit) te aktivizimit. Mund te perdoret ne rastet kur paneli ka kaluar ne gjendje "Alarm", por duam te vonojme ose ndalojme aktivizimin e sistemit te shuarjes pasi personeli pergjegjes veren se eshte alarm fals ose ne dhoma ka rene zjarr qe mund te shuhet ne menyra te tjera (psh. me nje fikse dore)

I.S.S shpk ka kërkuar në AK një përgjigje për sa më poshtë: Kush jane specifikimet teknike te ketyre butonave? Mund te sjellim nje buton qe ka nje Madhesi 1 mm apo nje buton qe ka nje Madhesi 10 metra ? Me cfare do lidhet me sistemin? Kërkojmë detyrimin e AK të kthejë përgjigje për pyetjet e mësipërme pasi i ka lënë evazive., Komisioni konstaton se, autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje, duke sqaruar ankimesin si më poshtë:

"11) Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për pajisjet e kamerave dhe NVR nëpër HEC -et ekzistuese, Komisioni relaton: Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k, për pajisjet e kamerave dhe NVR nëpër HEC-et ekzistuese, Komisioni sqaron se ky pretendim është jashtë objektit të kësaj procedure. Kjo procedurë prokurimi ka të bëjë me krijimin e dhomës së serverave për vazhdueshmërinë e shërbimeve në KESH SH.A. Nga vetë fjala dhoma e serverave ka të bëjë me instalimin e serverave, storage dhe shumë pajisje të tjera që duhet të garantojnë vazhdimësinë e punës në rast të një difekti të mundshëm në site-in primar të KESH.

12) Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për pikën 2.1 "Objektivi i Përgjithshëm" Komisioni relaton : Konkretisht : 1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për standartet teknike termin BCC-Site, për transferimin e pajisjeve dhe linjave të komunikimit ekzistuese sqarojmë : Bëhet fjalë për krijimin e dhomës së serverave për vazhdueshmërinë e shërbimeve (BCC-Site) sipas gjithë standarteve teknike për Institucion KESH. Për Standartet teknike për ndërtimin e dhomës së Serverave sipas ligjit, ankimesi duhet ti referohet standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare. BCC-Site është term teknik ndërkombëtar i njohur nga cdo aktor i kësaj fushe. BCC është shkurtim i Business Continuity Center Site e cila përkthet Qendra e Vazhdimësisë së Shërbimeve. Në lidhje me transferimin e pajisjeve dhe linjave të komunikimit ekzistuese, cdo informacion jepet në mënyrë të detajuar në paragrafët 9.4, Instalimi i FO midis dy rack në HEC Vau i Dejës dhe 9.5. Spostimi i pajisjeve. "Transferimi i pajisjeve dhe linjave të komunikimit ekzistuese" i referohet instalimit të një fibre optike me 24 fije midis dy rack që ndodhen në një distancë prej rreth 500 m nga njëri-tjetri dhe terminimit në patch panel FO i kësaj fibre me konektorë SC, si edhe spostimin fizik te pajisjeve ne paragrafin 9.5. Theksojme se OE është përgjegjës vetëm për çmontimin edhe ri-instalimin ne rack te pajisjeve dhe etiketimin e tyre. Nuk nevojitet transferim i linjave te pajisjeve te video-monitorimit.

15) Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për Sistemin e dedektimit të zjarrit Komisioni relaton: Autoriteti Kontraktor ka shpjeguar qartë se dhoma e serverave duhet që të pajiset me sistem detektimi dhe sinjalizimi të zjarrit per te gjithë hapesiren (si per hapesiren e cila kufizohet nga dyshemeja teknologjike dhe tavani, ashtu edhe per hapesiren e cila kufizohet nga dyshemeja teknologjike dhe dyshemeja fikse. Pajisjet e alarmit të zjarrit do të instalohen sipas rregullave dhe standarteve lokale. Për detektimin e zjarrit duhet të vendosen në dhomën e serverave detektorë temperature dhe detektorë optikë tymi. Për sinjalizimin e alarmit

të zjarrit do të vendosen sirena. Ky sistem duhet të ketë aftësi për t'u integruar me sistemet e tjera.

Konkretisht :

A. Kerkoni nje sistem per detektimin e zjarrit dhe nuk specifikoni cfare paisje do vendosen?

Ne DT jane shpjeguar fare qarte se cfare kerkohet nga sistemi detektimit dhe fikjes se zjarrit. Me poshte edhe nje here specifikimet e dhena ne DT. Kerkohet panel i dedektimit dhe fikjes se zjarrit me gjithë pajisjet dhe aksesoret e nevojshem te pershkruar.

1.1.1.1.1.Sistem automatik i fikjes zjarrit me gas te paster

Sistemi i detektimit te zjarrit

Dhoma e serverave duhet që të pajiset me sistem detektimi dhe sinjalizimi të zjarrit për të gjithë hapësirën (si për hapësirën e cila kufizohet nga dyshemeja teknologjike dhe tavani, ashtu edhe për hapësirën e cila kufizohet nga dyshemeja teknologjike dhe dyshemeja fikse. Pajisjet e alarmit të zjarrit do të instalohen sipas rregullave dhe standarteve lokale. Për detektimin e zjarrit duhet të vendosen në dhomën e serverave detektorë temperature dhe detektorë optikë tymi. Për sinjalizimin e alarmit të zjarrit do të vendosen sirena. Ky sistem duhet të ketë aftësi për t'u integruar me sistemet e tjera.

Sistemi i fikjes se zjarrit

Sistemi duhet të bazohet në një panel kontrolli kryesor të pavarur dhe me burim ushqimi nga bateria në rast të shkeputjeve të energjisë. Sistemi duhet të jetë i pajisur me pajisje sinjalizuese alarmi të dëgjueshme dhe të shikueshme të cilët duhet të montohen jashtë dhomave të monitoruara.

Butoni i aktivizimi dhe çaktivizimit të alarmit duhet të montohet brenda dhomës së serverave. Nje sinjalistike per alarmin e zjarrit (psh. "Stop Gaz") gjithashtu duhet të montohet në hyrje të derës se dhomës së serverave.

Duke qenë se në këto ambjente akomodohen pajisje elektrike dhe elektronike, si agjent për shuarjen e zjarrit duhet të perdoret gaz NOVEC ose ekuivalent (me perjashtim te gazrave jo te paster dhe imitime), i cili ruhet ne cilindra ne temperature dhome ne gjendje te lenget dhe shkarkohet ne ambjent ne momentin e aktivizimit si gaz.

Sistemi duhet të jetë i programuar për këto skenarë:

● *Stand by - Sistemi është në gatishmeri.*

Në këtë gjendje sistemi nuk kryen asnjë veprim por vetëm lexon të dhënat nga detektorët e zjarrit në zonat e përcaktuara më lart.

● *Prealarm – (Pre-activated) Sistemi ka sinjal alarmi (Fire Alarm) nga një prej zonave të mbulimit të zjarrit (kur aktivizohet një sensor në zonën e mbrojtur nga zjarri- temperature ose tym) dhe duhet të iniciojë një alarm në panelin e kontrollit, duhet të aktivizojë sirenat dhe dritat pulsuese në zonën e mbuluar nga ky sensor. Këto sinjale i dergohen dhe personelit për kontrollin dhe monitorimin e mbrojtjes nga zjarri.*

Në këtë gjendje nuk duhet të aktivizohet menjëherë sistemi i shuarjes së zjarrit për të shmangur alarmet "false", qe mund të vijne si rezultat i faulteve të sistemit. Pas ndërhyrjes së operatorëve të sigurisë, në rastin e alarmeve "false", sistemi mund të kthehet në gjendjen e tij normale nëpërmjet butonave të komandimit në panelin e kontrollit.

● *Alarm – (Activated) Sistemi ka sinjal alarmi nga të dy zonat e dhomes (sensore temperature dhe detektor tymi). Detektimi i zjarrit nga një sensori i dytë aktivizon "alarmin nga zjarri" dhe kalimin në fazën e shuarjes së zjarrit; edhe në këtë fazë, operatorët mund të ndalojnë manualisht kalimin në procesin e shuarjes së zjarrit (në rast se zjarri mund të shuhet nëpërmjet shuarësve*

portabël me pluhur ose nëse kemi të bëjmë me një alarm “fals”). Sistemi i projektuar i mbrojtjes nga zjarri duhet t'i mundësojë operatorëve edhe aktivizimin manual në procesin e shuarjes së zjarrit nëpërmjet butonit përkatës në ambjent. Në këtë gjendje sistemi jep alarmin për evakuimin e ambjenteve duke ndezur sinjalet dalje dhe duke aktivizuar alarmin e përgjithshëm. Njëkohësisht behet caktivizimi i magneleve te dyerve nga sistemi i kontrollit, monitorimit dhe menaxhimit.

Pas një kohe relativisht të shkurtër (e cila duhet të përcaktohet nga administratori i sistemit) kohë e mjaftueshme për evakuimin e personelit, nëse ka, behet aktivizimi i paisjes për fikjen e zjarrit.

Pas aktivizimit të fazes së shuarjes së zjarrit dhe shuarjes së tij dhe para se personeli të futet përsëri në ambjentet ku është gjeneruar gazi duhet të kryhet ajrimi i detyruar i ambjentit, në të cilat është aktivizuar sistemi i mbrojtjes nga zjarri, për të evituar dëmtimin shëndetësor të personelit.

Sistemi i dedektimit dhe shuarjes se zjarrit duhet te kete komponentet e meposhtem:

- Paneli i Kontrollit
- Detektoret e tymit dhe te temperatures
- Cilinder me agjentin e shuarjes
- Pajisjet e Sinjalizimit (Alarmit)
- Butonat e Aktivizimit dhe Ndalimit Manual
- Tubat dhe nozolat e shkarkimit

Paneli i kontrollit

Nga pikepamja llogjike ky panel duhet te jete i ndare ne zonen e hyrjeve (mbledhja e sinjaleve hyrese nga dedektore ose butona qe aktivizojne nje alarm), dhe ne zonen e daljeve (gjenerimi i sinjaleve nepermjet sirenave te alarmit dhe aktivizimi i shuarjes).

Paneli i kontrollit duhet të jetë i pozicionuar ngjitur me hyrjen kryesore ose brenda dhomës së serverave. Aktivizimi i lëndës shuarëse mund të konfigurohet për të aktivizuar nga çdo kombinim i inpueteve të zonave te mbulimit.

Paneli duhet të ketë bateri backup për të siguruar vazhdimësinë e funksionit të tij edhe në rast se mungon energjia kryesore e tij.

Dedektor Tymi & Temperature

Te kene shperndarje te tille qe te mbulojne te gjithë hapësirën e dhomes se serverave. Te jene ne perputhje te plote me sistemin e panelit te kontrollit.

Sirenat

Duhet te perdoret nje sirene me sinjalizues (autoparlant dhe/ose tabele sinjalizimi) ne hyrje te dhomes se serverave ku duhet te implementohet ky sistem. Sirena duhet te jete ne perputhje te plote me sistemin e panelit te kontrollit.

Extinguishant Release Control

Duhet të jepet mundësia për clirimin e agjentit shuarës të zjarrit manualisht me anë të një sëitch të veçantë (një Button Push ose ekuivalent).

Butonat e Aktivizimit dhe Ndalimit Manual

Ne hyrjen e dhomes se serverave, jashte dhome, duhet te montohen butonat e Aktivizimit Manual dhe te Ndalimit Manual te sistemit te shuarjes.

Butoni i Aktivizimit manual

Mund te perdoret nese kerkohet aktivizim i menjehershem i sistemit te shuarjes (ne rast se vetem njeri nga dedektoret eshte aktivizuar dhe paneli ka kaluar ne gjendjen "Pre-alarm", personeli pergjegjes mund te shtype kete buton dhe te aktivizojë manualisht sistemin e shuarjes).

Butoni i Ndalimit (ose vonimit) te aktivizimit

Mund te perdoret ne rastet kur paneli ka kaluar ne gjendje "Alarm", por duam te vonojme ose ndalojme aktivizimin e sistemit te shuarjes pasi personeli pergjegjes veren se eshte alarm fals ose ne dhome ka rene zjarr qe mund te shuhet ne menyra te tjera (psh. me nje fikse dore).

Butonat duhet te jene ne perputhje te plote me sistemin e panelit te kontrollit.

Cilindri me agjent shuares

a) Cilindri duhet te kete perberje celiku. Çdo cilindër që mund të instalohet duhet të testohet presioni në një presion provë me te lartë se presioni i punës.

b) Cilindri duhet te respektojë normat e percaktuara ne NFPA2001 (National Fire Protection Association)

c) Cilindri duhet të montohet dhe të lidhet në mënyrë të sigurtë.

d) Kerkohet që mbi cilindër të shënohen informacione si psh:

i) Kapaciteti Volume (lt) dhe dendësia e mbushjes

ii) Peshë neto (kg) e cilindrit.

iii) Sasia e shuarjen që përmban (Kg)

iv) Peshë bruto (kg)

v) Presioni maksimal i lejuar.

Valvula e Shkarkimit

Valvula e cilindrit duhet te mundesoje rrjedhje te shpejte, qe ne rast aktivizimi te alarmit te beje te mundur shkarkimin e cilindrit ne me pak se 15 sekonda. Valvula e cilindrit duhet te mundesoje aktivizimin me ane te lidhjes elektrike, me aktivizues pneumatik, ose manual duke ushtruar presion mbi pistonin e cilindrit.

Sprucatorët e gazit në dalje

Sprucatorët e daljes së gazit duhet të jenë prej alumini për te parandaluar korredimin. Duhet të jenë nga i njejtë prodhues me atë të fikjes së zjarrit me gas.

Agjenti Shuarës

a) Agjenti Shuares duhet te jete i paster (Novec ose ekuivalent, por ne asnje menyre nuk duhen perdorur kopje te tyre dhe gaze jo te paster) - avullon shpejt dhe pa lene mbetje, nuk demton paisjet elektronike.

b) Duhet të mos shkaktojë dëmtime anësore ne ambjent ne rast clirimi (te siguroje mbrojtjen e pajisjeve elektronike)

c) Duhet të jetë projektuar volumetrik

● Instalimet duhet te behen ne perputhje me rekomandimet dhe standardet e prodhuesit.

● Ne fund te instalimit personeli pergjegjes per Dhomen e Serverave duhet te trajnohet per perdorimin e sistemit.

● Projekti i sistemit me agjentin shuares te ofruar ne zgjidhje duhet të jete testuar/simuluar nga një softëare i certifikuar nga vete prodhuesi. Pas implementimit dhe testimit te sistemit, keto dokumenta duhet ti dorezohen autoritetit.

Manualet e perdorimit dhe studimi (projekti) i kryer me softëare nga prodhuesi duhet te dorezohen se bashku me planvendosjen e komponenteve ne dhomen e serverave ne perfundim te realizimit te projektit

B. Sa do jete sasia e detektoreve te temperatures ?

Ne DT e tenderit eshte dhene siperfaqja e dhomes, planimetria e saj, nje planvendosje e gjithë pajisjeve. Nga OE kerkohet zgjidhje e plote per te gjithë elementet sipas pajisjeve qe do te ofertohehen nga Operatori perfshi dhe sistemin e dedektimit. Ne lidhje me sensorët e detektoreve te temperatures OE, ne baze te sistemit te propozuar, perlllogarit me SË perkates sasine e ketyre sensoreve. Ne specifikimet e Tenderit jane kerkuar: Projekti i sistemit me agjentin shuares te ofruar ne zgjidhje duhet të jete testuar/simuluar nga një softëare i certinkuar nga vete prodhuesi. Pas implementimit dhe testimit te sistemit, keto dokumenta duhet ti dorezohen autoritetit. Manualët e perdorimit dhe studimi (projekti) i kryer me softëare nga prodhuesi duhet te dorezohen se bashku me planvendosjen e komponenteve ne dhomen e serverave ne perfundim te realizimit te projektit

C. Sa do jete sasia e detektorëve optik te tymit? Përgjigjen për këtë pyetje e gjeni ne pergjigjen e pikes B.

D. Shkruani qe do duhen sirena ne numrin shumes? Sa sirena ? Përgjigjen për këtë pyetje e gjeni ne pergjigjen e pikes B. Gjithsesi, per me shume shpjegime sipas standarteve kerkohet nje sirene brenda dhomes se Serverave, dhe nje sirene jashte dhomes se serverave

E. Ku do vendosen keto detektore ? Detektoret do te percaktohen nga OE ne baze të zgjidhjes se Simuluar.

F. Ku do vendosen sirenat ? Edhe kjo percaktohet nga OE, pavaresisht se standartet percaktojne vendet me te dukshme, dhe ne rastin klasik ne deren e jashtme si ne hyrje ashtu edhe ne dalje.

G. Me cfare do lidhen sirenat me panelin e alarmit? Kerkohet zgjidhje, pra OE do te jape zgjidhjen ne baze të produktit qe do te ofertoje.

H. Me cfare do lidhen detektoret me Panelin e alarmit ? Me kabull? Me ëireless? Me radio? Lidhja do te jete ne varesi te zgjidhjes qe OE do te propozoje. Nese dedektoret lidhen me kabell (Cfaredo lloj kabili) atehere OE duhet t'i lidhe me kabell, nese OE do te propozoje zgjidhje me dedektore ëireless, duhet te lidhen sipas menyres qe do te propozohet. AK per te mos perjashtuar asnje propozim ka lene dore te lire qe OE te propozojne zgjidhjen e tyre me te mire teknike qe ploteson specifikimet e kerkuar, njekohesisht edhe me ekonomike.

I. Kush jane specifikimet teknike te pajisjeve qe do te pranohen nga AK? Përgjigjen për këtë pyetje e gjeni ne pergjigjen e pikes A.

J. Sa eshte sasisa e kabullit qe duhet për te lidhur pajisjet? Sasia e kabllit edhe cdo element tjetër i zgjidhjes do te percaktohet nga OE ne baze te zgjidhjes se Simuluar.

K. Paneli i sistemit te detektimit dhe sinjalizimit te zjarrit do te kete nje kabinet dhe çfarë do vendoset aty? Ne specifikimet teknike te sistemit te detektimit dhe shuarjes se zjarrit, nuk percaktohet zgjidhje me kabinet. Zgjidhjet klasike te ketyre sistemeve parashikojne nje panel i cili, ne planvendosjen ilustruese te pajisjeve te dhomes se serverave eshte paraqitur ne hyrje te dhomes. Megjithate AK nuk do te perjashtoje asnje propozim, i cili ploteson kerkesat funksionale edhe specifikimet teknike te komponenteve te pershkruar ne DT.

L. Ku do transmetoje ky panel? Ne rast dedektimi te zjarrit sistemi do te veproje sic pershkruhet ne Dokumentat e tenderit dhe te ri-thena ne pergjigjen e pikes A.

Për sa i takon pyetjeve të ankimesit mbi përgatitjen e procedurës: Sqarojme se AK ka përgatitur procedurën e prokurimit duke respektuar Ligjin e Prokurimeve Publike dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

17) Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik "ISS" sh.p.k për specifikimin teknik të butonave Komisioni relatton: Keto butona duhet te jene pjese integrale te panelit dhe duhen apo aktivizohen apo caktivizohen sipas rastit. Aktivizohet butoni i shkarkimit te gazit kur eshte e

qarte prezenca e zjarrit pa pritur qe sistemi te beje vertetimin e pranise se zjarrit ose e kunderta çaktivizon kohen e plasjes se gazit ne rast se dyshohet per prezence zjarri apo Fikja e tij mund te behet pa shperthimin e gazit”

III.8.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, ndodhemi përëri para kërkimit për sqarime mbi specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi. Operatori ekonomik në ankesë në asnjë rast nuk ka pretenduar heqjen e këtyre specifikimeve teknike por ka theksuar paqartësinë e tyre.

Gjithashtu, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka dhënë sqarimet e nevojshme për operatorin ekonomik ankimues lidhur me specifikimet teknike të vendosura në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi, por, nuk ka kthyer përgjigje për pyetjen “*Ju kerkoni te kryeni nje investim dhe thjesht doni te minimizoni probabilitetin? Sa esht koeficienti i minimizimit?*”, si dhe sqarimet e mësipërme nuk i ka publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në zbatim të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të sqarojë cdo paqartësi të ngritur nga operatorët ekonomik të interesuar, si dhe duhet ti publikojë këto sqarime me anë të shtojcës përkatëse, sikurse përcaktohet në nenin 42 pika 2 të L.P.P-së.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.9. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Integrated Security Solutions” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “*[...]Në Shtojcën 10 Specifikimet Teknike pika 4.3 “Data e Fillimit dhe Periudha e implementimit të Detyrave“ përcaktohet se: Zbatimi i projektit do të fillojë menjëherë me nënshkrimin e kontratës nga të dy palët dhe periudha e implementimit te detyrave do te jete 3 muaj nga kjo datë. Kerkojme shtyrjen e ketij afati ne 6 muaj duke pare kushtet e veshtira qe ndodhet Republika e Shqiperise dhe gjithe bota. Dihet boterisht qe per shkak te COVID19 prodhimi dhe transportet kane vonesa te konsiderueshme ne gjithe boten. Eshte teknikisht dhe llogjikisht e pamundur të bëhet realizimi i ketij projekti per 3 muaj nqs paisjet qe kerkohen do porositen. E vetmja mënyrë që ky projekt të realizohet me sukses brenda afatit 3-mujor ndërkohë që të gjithë shtetet e botës kanë mbyllur kufijtë është që O. E i parapercaktuar per ta fituar kete gare ti kete produktet në magazinë?! Kjo kërkesë është refuzuar nga AK me pretendimin se nuk ka kufizime për lëvizjen e mallrave. Kërkojmë detyrimin e AK të shikojë një mënyrë më të arsyeshme për datën e Fillimit dhe Periudhën e Implementimit të Detyrave [...]*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.9.1. Në shtojcën nr.12, “Sasia dhe grafiku i lëvrimit”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

“Afatet e lëvrimit: 3 (tre) muaj.”

III.9.2. Në nenin 27, pika 2 të VKM 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “*[...] Autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.[...]*”

III.9.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor përcaktimin e afateve kohore të zbatimit të kontratës duhet ta parashikojë në proporcion me natyrën e kontratës, sasisë dhe llojit të mallit të kërkuar. Në rastin konkret K.P.P konstaton se procedura e prokurimit objekt ankimi është një procedurë e përzierë, pasi përmban elementë konkretë të kontratës së “mallrave” si edhe kontratës së “punëve”. Duke iu referuar natyrës së furnizimit, (proceseve të saj), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se koha e përcaktuar prej 3 (tre) muajsh është e mjaftueshme dhe në proporcion me natyrën e kontratës. Për këto arsye, K.P.P gjykon se autoriteti kontraktor ka parashikuar një afat kohor të arsyeshëm për zbatimin e kontratës.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.10. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Integrated Security Solutions” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]ANKESË NR. 12

Ne tabelen e planifikimit te buxhetit për zërta 11-15 në mënyrë skandaloze jepet emërtimi i përgjithshëm pa përshkruar se çfarë pajisjesh përmban një set: Ju kerkoni:

F.V. Netëork (perfshi FO, CU, patchpanele dhe menaxhues kablli, menaxhues ajri, kanalinen e verdhe, aksesore etj.) set 1

12 F.V. Sistem i detektimit dhe fikjes se zjarrit set 1

13 F.V. Sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit set 1

14 F.V. Sistem CCTV (5 kamera, NVR, sëitch PoE) set 1

15 F.V. Sistem akses kontrolli set 1

Te gjitha keto jane sisteme qe perbehen nga disa elemente te ndryshem. Kerkojme ndarjen e te gjitha ketyre elementeve ne sasi dhe jo ne set pasi nuk perlllogaritet sakte kosto. Gjithashtu ka dhe elemente te fshehur brenda ketij seti te cilat duhet ti behen me dije O.E.

Ak në përgjigjen e tij argumenton se: AK nuk ka renditur një listë produktesh të parapërcaktuar por i ka lënë dorë të lirë o.e të propozoni zgjidhjen tuaj më të mirë teknike dhe ekonomike që plotëson specifikimet e kërkuara!!!

Ky formulim është evaziv dhe krijon mundësinë e subjektivizmit në vlerësimin e ofertave dhe vështirësi në përpilimin e ofertave nga ana e O.E. Kërkojmë përcaktimin e saktë dhe konkret të përbërësve të setit të kërkuar. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.10.1. Në shtojcën nr.10, “Specifikime teknike”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

“

Nr.	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Cmimi/Njesi	Vlera
1	Punime civile jo te specializuara	set	1		
2	F.V. Dysheme Teknologjike	m2	25		
3	F.V. Dere zjarrduruese	cope	1		
4	F.V. Kafaz Faradai	set	1		
5	F.V. Panel Elektrik jashte murit te kompletuar me te gjitha aksesoret per montim	set	2		
6	Instalime elektrike ne dhomen e serverave (perfshi ndricuesit linear, ndricues emergjence dhe aksesoret	set	1		

	<i>perkates, kanalinat dhe kabllot, tokezim etj.)</i>				
7	<i>F.V. UPS 20KVA me 25 min autonomi</i>	<i>cope</i>	2		
8	<i>F.V. PDU 32A</i>	<i>cope</i>	8		
9	<i>F.V. Sistem Kondicionimi min. 17kw</i>	<i>cope</i>	2		
10	<i>F.V. Rack 42U 800 x 1200mm</i>	<i>cope</i>	4		
11	<i>F.V. Network (perfshi FO, CU, patchpanele dhe menaxhues kablli, menaxhues ajri, kanalinen e verdhe, aksesor etj.)</i>	<i>set</i>	1		
12	<i>F. V. Sistem i detektimit dhe fikjes se zjarrit</i>	<i>set</i>	1		
13	<i>F.V. Sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit</i>	<i>set</i>	1		
14	<i>F.V. Sistem CCTV (5 kamera, NVR, switch PoE)</i>	<i>Set</i>	1		
15	<i>F.V. Sistem akses kontrolli</i>	<i>Set</i>	1		
16	<i>F.V Rack outdoor në HEC Vau i Dejës</i>	<i>cope</i>	2		
17	<i>Sistemim rack 42 U me aksesore +2 PDU 10A në HEC Fierzë</i>	<i>set</i>	1		
18	<i>F.V Kondicioner 18.000 BTU në HEC Fierzë</i>	<i>cope</i>	1		
19	<i>Zhvendosje, Instalim dhe sistemim rack-u ekzistues 42 U me aksesore +2 PDU 10A në HEC Koman</i>	<i>set</i>	1		
20	<i>F.V KVM console me ekran min 17” + KVM sëitch per te lidhur min 4 pajisje</i>	<i>cope</i>	1		
21	<i>F.V KVM Switch per të lidhur min 4 pajisje</i>	<i>cope</i>	2		
22	<i>F.V Fiber optike 24SM dhe terminim</i>	<i>set</i>	1		
23	<i>Trajnim</i>	<i>dite</i>	3		
TOTALI PA TVSH					
TVSH					
TOTALI ME TVSH					

”

III.10.2. Në nenin 23 pika 1, 2, 3 dhe 5 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se : “1. *Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*

2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar: a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve; b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton*

pajtueshmëri me kërkesat funksionale; c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj.

5. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimi të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime”

III.10.3. Lidhur me zërin nr.11 “F.V. Netëork (përfshi FO, CU, patchpanele dhe menaxhues kablli, menaxhues ajri, kanalinen e verdhe, aksesori etj.)”, Komisioni konstaton se në pikën 9.1.7.2, të shtojcës 10 “Specifikime teknike”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si vijon:

“Për të siguruar rrjedhjen e duhur të informacionit në dhomën e serverave duhet të lejohet mundësia për komunikim nepermjet teknologjise baker (Cat 6A FTP LSZH – Loë Smoke Zero Halogen) dhe fiber optike Multi Mode OM4.

Komunikimi me ane të rrjetit baker Cat 6A, FTP, LSZH, i para-terminuar me konektore RJ45-RJ45:

- Duhet të përdoret kabëll CU FTP LSZH Cat 6A i para-terminuar me konektorë RJ45 në të dyja anët.

- Kabllot e bakrit duhet të terminohen në Rack e Netëork R1.

- Nga Rack i Netëork R1 duhet të nisen tufa me 6 kablllo CU FTP Cat 6A të para-terminuara RJ45-RJ45, që përfundojnë në Rack-ët e serverave R2 deri në R4.

- Kabllot duhet të përfundojnë në patch panele CU Cat 6A si edhe duhet të përdoren manaxhues kablllosh horizontale 1U.

Komunikimi me ane të rrjetit Fiber Optike Multi Mode OM4, LSZH, i para-terminuar LC-LC:

- Duhet të përdoret Fibër Optike Multi Mode e para-terminuar me konektorë LC në të dyja anët.

- Kabllot FO Multi Mode duhet të terminohen në Rack e Network R1.

- Nga Rack i Network R1 duhet të nisen tufa me 12 Fibra Optike Multi Mode OM4 të para-terminuara LC-LC, që përfundojnë në Rack-ët e serverave R2 deri në R4.

- Kabllot duhet të përfundojnë në patch panele Fibër Optike, të cilat duhet të jenë të pajisur me adaptore LC duplex Multi Mode, si edhe duhet të përdoren manaxhues kablllosh horizontale 1U.

- Per menaxhimin e Fibres Optike Multi Mode në menyre sa më të sigurtë duhet të përdoret kanaline e verdhe e cila duhet të instalohet mbi Rack-e.

Për menaxhimin e kablllove në rack-et me gjeresi 800 mm duhet të përdoren manaxhues kablllosh vertikale.

Në menyre që të ketë menaxhim sa më efektiv të ajrit të ftohtë, që fryn nga grilat sipas metodës down-flow, kerkohet që të instalohen manaxhues të ajrit në hapësirat boshe tek Rack-et që do të instalohen në dhomen e serverave.

Për të lejuar kërkesa shtesë në të ardhme, sistemi i lidhjeve IT duhet të jetë i lehtë për tu zgjeruar dhe për tu mirëmbajtur. Instalimi i sistemit të network duhet të realizohet në përputhje me rekomandimet e bëra në standartet përkatëse, rekomandimet e prodhuesit si dhe/ose praktikat më të mira të industrisë.”

III.10.4. Lidhur me zërin nr.12 “F. V. Sistem i detektimit dhe fikjes së zjarrit”, Komisioni konstaton se në pikën 9.1.8.1.1, të shtojcës 10 “Specifikime teknike”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si vijon:

“Sistemi i detektimit të zjarrit

Dhoma e serverave duhet që të pajiset me sistem detektimi dhe sinjalizimi të zjarrit për të gjithë hapësirën (si për hapësirën e cila kufizohet nga dyshemeja teknologjike dhe tavani, ashtu edhe për hapësirën e cila kufizohet nga dyshemeja teknologjike dhe dyshemeja fikse. Pajisjet e alarmit të zjarrit do të instalohen sipas rregullave dhe standarteve lokale. Për detektimin e zjarrit duhet të vendosen në dhomën e serverave detektorë temperature dhe detektorë optikë tymi. Për sinjalizimin e alarmit të zjarrit do të vendosen sirena. Ky sistem duhet të ketë aftësi për t'u integruar me sistemet e tjera.

Sistemi i fikjes së zjarrit

Sistemi duhet të bazohet në një panel kontrolli kryesor të pavarur dhe me burim ushqimi nga bateria në rast të shkeputjeve të energjisë. Sistemi duhet të jetë i pajisur me pajisje sinjalizuese alarmi të dëgjueshme dhe të shikueshme të cilat duhet të montohen jashtë dhomave të monitoruara.

Butoni i aktivizimit dhe çaktivizimit të alarmit duhet të montohet brenda dhomës së serverave. Një sinjalistike për alarmin e zjarrit (psh. “Stop Gaz”) gjithashtu duhet të montohet në hyrje të derës së dhomës së serverave.

Duke qenë se në këto ambiente akomodohen pajisje elektrike dhe elektronike, si agjent për shuarjen e zjarrit duhet të perdoret gaz NOVEC ose ekuivalent (me përjashtim të gazrave jo të paster dhe imitime), i cili ruhet në cilindra në temperature dhomë në gjendje të lenget dhe shkarkohet në ambient në momentin e aktivizimit si gaz.

Sistemi duhet të jetë i programuar për këto skenarë:

●Stand by - Sistemi është në gatishmeri.

Në këtë gjendje sistemi nuk kryen asnjë veprim por vetëm lexon të dhënat nga detektorët e zjarrit në zonat e përcaktuara më lart.

●Prealarm – (Pre-activated) Sistemi ka sinjal alarmi (Fire Alarm) nga një prej zonave të mbulimit të zjarrit (kur aktivizohet një sensor në zonën e mbrojtur nga zjarri- temperature ose tym) dhe duhet të iniciojë një alarm në panelin e kontrollit, duhet të aktivizojë sirenat dhe dritat pulsuese në zonën e mbuluar nga ky sensor. Këto sinjale i dergohen dhe personelit për kontrollin dhe monitorimin e mbrojtjes nga zjarri.

Në këtë gjendje nuk duhet të aktivizohet menjëherë sistemi i shuarjes së zjarrit për të shmangur alarmet “false”, që mund të vijnë si rezultat i faulteve të sistemit. Pas ndërhyrjes së operatorëve të sigurisë, në rastin e alarmeve “false”, sistemi mund të kthehet në gjendjen e tij normale nëpërmjet butonave të komandimit në panelin e kontrollit.

●Alarm – (Activated) Sistemi ka sinjal alarmi nga të dy zonat e dhomes (sensore temperature dhe detektor tymi). Detektimi i zjarrit nga një sensori i dytë aktivizon “alarmin nga zjarri” dhe kalimin në fazën e shuarjes së zjarrit; edhe në këtë fazë, operatorët mund të ndalojnë manualisht kalimin në procesin e shuarjes së zjarrit (në rast se zjarri mund të shuhet nëpërmjet shuarësve portabël me pluhur ose nëse kemi të bëjmë me një alarm “fals”). Sistemi i projektuar i mbrojtjes nga zjarri duhet t'i mundësojë operatorëve edhe aktivizimin manual në procesin e shuarjes së zjarrit nëpërmjet butonit përkatës në ambient. Në këtë gjendje sistemi jep alarmin për evakuimin e ambienteve duke ndezur sinjalet dalje dhe duke aktivizuar alarmin e përgjithshëm. Njëkohësisht behet caktivizimi i magnetëve të dymëve nga sistemi i kontrollit, monitorimit dhe menaxhimit.

Pas një kohe relativisht të shkurtër (e cila duhet të përcaktohet nga administratori i sistemit) kohë e mjaftueshme për evakuimin e personelit, nëse ka, behet aktivizimi i paisjes për fikjen e zjarrit.

Pas aktivizimit të fazes së shuarjes së zjarrit dhe shuarjes së tij dhe para se personeli të futet përsëri në ambientet ku është gjeneruar gazi duhet të kryhet ajrimi i detyruar i ambientit, në të cilat është aktivizuar sistemi i mbrojtjes nga zjarri, për të evituar dëmtimin shëndetësor të personelit.

Sistemi i dedektimit dhe shuarjes së zjarrit duhet të ketë komponentet e mëposhtem:

- *Paneli i Kontrollit*
- *Detektorët e tymit dhe të temperaturës*
- *Cilinder me agjentin e shuarjes*
- *Pajisjet e Sinjalizimit (Alarmit)*
- *Butonat e Aktivizimit dhe Ndalimit Manual*
- *Tubat dhe nozolat e shkarkimit*

Paneli i kontrollit

Nga pikepamja llogjike ky panel duhet të jetë i ndarë në zonen e hyrjeve (mbledhja e sinjaleve hyrese nga dedektore ose butona që aktivizojnë një alarm), dhe në zonen e daljeve (gjenerimi i sinjaleve nepermjet sirenave të alarmit dhe aktivizimi i shuarjes).

Paneli i kontrollit duhet të jetë i pozicionuar ngjitur me hyrjen kryesore ose brenda dhomës së serverave. Aktivizimi i lëndës shuarëse mund të konfigurohet për të aktivizuar nga çdo kombinim i inpueteve të zonave të mbulimit.

Paneli duhet të ketë bateri backup për të siguruar vazhdimësinë e funksionit të tij edhe në rast se mungon energjia kryesore e tij.

Dedektor Tymi & Temperature

Te këne shpërndarje të tilla që të mbulojnë të gjithë hapësirën e dhomes së serverave. Te jënë në përputhje të plote me sistemin e panelit të kontrollit.

Sirenat

Duhet të përdoret një sirene me sinjalizues (autoparlant dhe/ose tabele sinjalizimi) në hyrje të dhomes së serverave ku duhet të implementohet ky sistem. Sirena duhet të jetë në përputhje të plote me sistemin e panelit të kontrollit.

Extinguishant Release Control

Duhet të jepet mundësia për clirimin e agjentit shuarës të zjarrit manualisht me anë të një sëitch të veçantë (një Button Push ose ekuivalent).

Butonat e Aktivizimit dhe Ndalimit Manual

Në hyrjen e dhomes së serverave, jashtë dhomes, duhet të montohen butonat e Aktivizimit Manual dhe të Ndalimit Manual të sistemit të shuarjes.

Butoni i Aktivizimit manual

Mund të përdoret nëse kërkohet aktivizim i menjehershëm i sistemit të shuarjes (në rast se vetëm njëri nga dedektorët është aktivizuar dhe paneli ka kaluar në gjendjen “Pre-alarm”, personeli përgjegjës mund të shtype këte buton dhe të aktivizojë manualisht sistemin e shuarjes).

Butoni i Ndalimit (ose vonimit) të aktivizimit

Mund të përdoret në rastet kur paneli ka kaluar në gjendje “Alarm”, por duam të vonojmë ose ndalojmë aktivizimin e sistemit të shuarjes pasi personeli përgjegjës verë se është alarm fals ose në dhomë ka rënë zjarr që mund të shuhet në mënyrë të tjera (psh. me një fikse dore).

Butonat duhet të jënë në përputhje të plote me sistemin e panelit të kontrollit.

Cilindri me agjent shuares

a) Cilindri duhet te kete perberje celiku. Çdo cilindër që mund të instalohet duhet të testohet presioni në një presion provë me te lartë se presioni i punës.

b) Cilindri duhet te respektoje normat e percaktuara ne NFPA2001 (National Fire Protection Association)

c) Cilindri duhet të montohet dhe të lidhet në mënyrë të sigurtë.

d) Kerkohet që mbi cilindër të shënohen informacione si psh:

i) Kapaciteti Volume (lt) dhe dendësia e mbushjes

ii) Pesha neto (kg) e cilindrit.

iii) Sasia e shuarjen që përmban (Kg)

iv) Pesha bruto (kg)

v) Presioni maksimal i lejuar.

Valvula e Shkarkimit

Valvula e cilindrit duhet te mundesoje rrjedhje te shpejte, qe ne rast aktivizimi te alarmit te beje te mundur shkarkimin e cilindrit ne me pak se 15 sekonda. Valvula e cilindrit duhet te mundesoje aktivizimin me ane te lidhjes elektrike, me aktivizues pneumatik, ose manual duke ushtruar presion mbi pistonin e cilindrit.

Sprucatorët e gazit në dalje

Sprucatorët e daljes së gazit duhet të jenë prej alumini per te parandaluar korredimin. Duhet të jenë nga i njejt prodhues me atë të fikjes së zjarrit me gas.

Agjenti Shuarës

a) Agjenti Shuares duhet te jete i paster (Novec ose ekuivalent, por ne asnje menyre nuk duhen perdorur kopje te tyre dhe gaze jo te paster) - avullon shpejt dhe pa lene mbetje, nuk demton paisjet elektronike.

b) Duhet të mos shkaktoje dëmtime anësore ne ambjent ne rast clirimi (te siguroje mbrojtjen e pajisjeve elektronike)

c) Duhet të jetë projektuar volumetrik

● *Instalimet duhet te behen ne perputhje me rekomandimet dhe standardet e prodhuesit.*

● *Ne fund te instalimit personeli pergjegjes per Dhomen e Serverave duhet te trajnohet per perdorimin e sistemit.*

● *Projekti i sistemit me agjentin shuares te ofruar ne zgjidhje duhet të jete testuar/simuluar nga një softëare i certifikuar nga vete prodhuesi. Pas implementimit dhe testimit te sistemit, keto dokumenta duhet ti dorezohen autoritetit.*

● *Manuallet e perdorimit dhe studimi (projekti) i kryer me softëare nga prodhuesi duhet te dorezohen se bashku me planvendosjen e komponenteve ne dhomen e serverave ne perfundim te realizimit te projektit”*

III.10.5. Lidhur me zërin nr.13 “F.V.Sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit”, Komisioni konstaton se në pikën 9.1.8.1.2, të shtojcës 10 “Specifikime teknike”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si vijon:

“Qëllimi është ndërtimi i një sistemi monitorimi, menaxhimi, kontrolli dhe ndërveprimi të unifikuar. Operatori duhet që nga një ekran te aksesojë njesine kryesore te sistemit te menaxhimit dhe monitorimit dhe të monitoroje punën e të gjithë nensistemeve që do të integrohen në kete sitem. Sistemi gjithashtu duhet të ofrojë mundësinë e zgjerimit ne te ardhmen.

Përshkrimi i sistemit

Sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit të dhomes se serverave është një sistem kontrolli kompjuterik i cili kontrollon dhe monitoron pajisjet mekanike dhe elektrike të ndërtesës ku instalohet. Ne te njejten menyre, duke u instaluar ne nje dhome serverash, ky sistem shfrytëzohet dhe sherben per monitorimin, kontrollin dhe menaxhimin e sistemeve te instaluara ne server room te integruara në një konsolle të vetme. Nepermjet sistemit te monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit, kontrolli i sistemeve behet jo vetem me i lehte per tu menaxhuar, por ofron mundesine per te komanduar keto sisteme ne distance. Per garantimin e mirefunksionimit te secilit sistem te integruar ne te, duhet te mundesohet mbledhja e informacioneve dhe sinjalizimeve nga sistemet, dhe menaxhimi i ketyre sistemeve (fikje/ndezeje etj) ne varesi te sinjaleve hyrese.

Sistemi duhet qe te jete ne gjendje qe ne rastin e detektimit te rrjedhjes se ujit te bllokoje furnizimin me uje te dhomes. Po ashtu duhet qe ne rast te detektimit te zjarrit te behet e mundur fikja e sistemit te kondicionimit. Ndersa ne rast se sistemi i zjarrit arrin ne fazen e leshimit te agjentit shuares te behet e mundur hapja ne menyre automatike e deres se dhomes.

Sistemet që duhet të monitorohen dhe integrohen ne sistemin e monitorimit dhe menaxhimit janë:

●UPS

Këto pajisje duhet të kenë karta komunikimi modbus ose TCP/IP nga ku duhet të merret informacioni mbi:

-Nivelin e ngarkesës

-Kohëzgjatja e furnizimit nga bateria në varësi të ngarkesës.

-Statuset e punës së UPS-së (from line1, from line 2, from batery, bypass).

-Parametrat e energjise ne hyrje-dalje te pajisjes.

-Kohen kur duhet te meren masa nese pjeset e brendshme te pajisjes jane amortizuar dhe duhen nderuar.

-Alarmet e ndryshme në lidhje me punën e UPS-së.

-Historikun e eventeve

-Informacioni duhet të ruhet për një periudhë kohe 3 mujore, etj.

Për secilin nga funksionet që bien në alarm, sistemi duhet të raportojë me ane te SMS, e-mail ose voice call, sipas prioritetit të alarmit.

●Kondicionim

Këto pajisje duhet të kenë karta komunikimi modbus nga ku duhet të merret informacioni mbi:

a)Nivelin e temperaturës.

b)Nivelin e lagështirës relative.

c)Nivelin e larte te presionit ne qarkun ftohes.

d)Nivelin e larte te presionit ne qarkun ftohes.

e)Gjendjen e filtrave

f)Mungesen ose tepricen e ujit ne lageshtues

g)Oret e punes se njesise

h)Oret e punes se kompresoreve

i)Informacionin nese eshte duke punuar ne gjendje normale apo ne alarm

j)Alarmet e ndryshme mbi punën e pajisjeve ftohëse.

k)Informacioni duhet të ruhet për një periudhë kohe 3 mujore, etj.

Për secilin nga funksionet që bien në alarm, sistemi duhet të raportojë me ane te SMS, e-mail ose voice call, sipas prioritetit të alarmit.

- *Sistemin e detektimit dhe fikjes së zjarrit*

Nga ky sistem duhet të merret informacioni mbi:

a) Statusin e sistemit (ne regjim normal apo fault)

b) Statusin Para-Alarm

c) Statusin Alarm

- *Panelet elektrike*

Për sistemin e monitorimit të paneleve elektrike duhet të parashikohen module për marrjen e informacionit nga panelet. Në varësi të sistemit të aplikuar duhet të parashikohen edhe kontaktet, ose portat e komunikimit. Multimetrat e instaluar në panele duhet të jenë të pajisura me porta komunikimi modbus apo ekuivalent. Kontrolli i gjëndjes duhet të bëhet për të gjithë automatet kryesorë në secilin prej paneleve. Informacioni që do të merret për to është:

a) Open/Close (i hapur/i mbyllur) te automateve.

b) Informacion nese parametrat e furnizimit me energji elektrike jane jashte diapazonit normal

-Detektimin e mungeses se tensionit

-Asimetri te fazave

-Renditje te kundert te fazave

-Nivel i larte tensioni

-Nivel i ulet tensioni

-Frekuence e ndryshme nga 50 Hz

c) Te gjithë parametrat e multimetrit U, I, P, S, Q, Hz cosφ etj.

Gjithashtu sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit duhet të integrojë, ruaj dhe përpunojnë gjithë informacionin që vjen nga paneli/et. Në sistemin e monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit duhet të konfigurohet një pamje grafike e qartë me të dhëna on-line të skemës principale të furnizimit me energji elektrike.

- *PDU*

a) Te gjithë parametrat e multimetrit tension, rryme, fuqi etj.

Gjithashtu sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit nepermjet sensoreve eshte përgjegjës per monitormin e parametrave te dhomave:

- *Temperaturen*

- *Lageshtiren*

- *Prezencën e ujit*

Sistemi duhet të japë historikun e alarmeve të gjithë pajisjeve të integruara, dhe krijojë raporte të ndryshme për mënyrën e funksionimit të pajisjeve. Sistemi, përvec raportimit on-line të gjithë pajisjeve të integruara, duhet të ruajë në database-in e tij gjithë informacionet e punës së tyre, për një periudhë minimalisht 3 muaj, si psh. konsumin e energjisë elektrike në server room, temperaturën e dhomës, lagështirën, etj.

Sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit duhet të japë një paraqitje grafike on-line të gjitha pajisjeve që do të integrohen dhe monitorohen, si kondicionerët, UPS-të, sensorët e temperaturës, lagështisë, panelet elektrike, etj. Këto pajisje duhet të raportojnë me anë të ngjyrave gjëndjen e tyre. Ngjyra e gjelbër në gjëndje normale, të kuqe për avari në pajisje. Me klikim në secilën prej pajisjeve duhet të sigurohet marrja e informacioneve të detajuara për secilin nga sistemet e instaluar.”

III.10.6. Lidhur me zërin nr.14 “F.V. Sistem CCTV (5 kamera, NVR, sëitch PoE)”, Komisioni konstaton se në pikën 9.2.1, të shtojcës 10 “Specifikime teknike”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si vijon:

“Dhoma e serverave duhet të pajiset me sistem CCTV dhe sistem të kontrollit të aksesit. Brenda dhomes se serverave duhet të instalohen 5 kamera per vezhgimin e gjithe hapesires se dhomes.

Gjithashtu, dhoma e serverave duhet të pajiset me sistem kontrolli aksesi me dy readera per deren e dhomes se serverave (Brenda dhe jashte dhome).

Regjistrimi i kamerave në dhomen e serverave do të behet me ane të NVR-se lokale, ndersa kamerat do të ushqehen nëpërmjet teknologjisë PoE për të evituar instalimet e rrymës elektrike. Të gjithë aksesorët e nevojshëm për montimin e kamerave duhet të jenë të përfshira.

Për ushqimin e kamerave me PoE duhet të instalohet nje sëitch sipas specifikimeve te percaktuara me poshte.

Me poshtë janë specifikimet teknike për komponentët kryesore të sistemit CCTV”

III.10.7. Lidhur me zërin nr.15 “F.V. Sistem akses kontrolli”, Komisioni konstaton se në pikën 9.2, të shtojcës 10 “Specifikime teknike”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si vijon:

“Zgjidhja për sistemin e akses kontrollit duhet të jete e bazuar në TCP/IP në mënyre që ti ofrohet akses të gjithë personave të cilët do të jene të autorizuar për të pare apo për të konfiguruar sistemin. Sistemi duhet të jete i afte për tu implementuar per sisteme te vogla me një dere të vetme për të monitoruar hyrje-daljet, deri në sisteme komplekse me disa dyer.

Karakteristikat e kontrollit (hardëare)

Akses kontrolli duhet të ketë këto karakteristika të përgjithshme:

- *Memorie të brëndshme për minimalisht 30,000 ngjarje*
- *Ushqimi: 10-30V DC dhe/ose PoE IEEE 802.3af/at*
- *Komunikimi TCP/IP, RS-485*
- *Siguria e rrjetit: Filtrim i adresave IP, enkriptim HTTPS, mbrojtje me fjalëkalim*
- *Temperaturat e operimit: nga 0°C to +45°C*
- *Të ofroje mundesinë e autentifikimit vetëm me karte, vetëm me PIN ose me karte edhe me PIN.*

Akses kontrolli duhet të ofroje mundesinë e konfigurimit të pajisjes nëpërmjet ndërfaqes ëeb. Centrali duhet të ofroje ndërrim i PIN, ndërrim i kartës, shtimi apo heqja e userve si edhe ndryshimi i skedulimeve të akseseve.

Lexuesit

- *Lexuesit duhet të suportojnë karte dhe PIN*
- *Teknologjitë e leximit: Generic 13,56 MHz (MIFARE Classic, MIFARE Plus, vMIFARE DESFire EV1, iCLASS® CSN*
- *Shkalla e leximit: 30 mm*
- *Temperaturat e punës: nga -20 ° C në + 70 ° C*
- *I pajisur me tamper për të detektuar në qofte se hiqet nga muri.*
- *Sinjalizimin për: Access Granted, Access Denied, armed, disarmed*

Magneti

- *Deri në 300 kg e forcës mbajtëse*
- *E monitorueshme*
- *12/24 VDC*
- *Status me led për gjendjen e derës”*

III.10.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publik (në zbatim të nenit 12 të LPP-së) është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e specifikimeve teknike. në rastin konkretë, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se autoriteti kontraktor, gjatë hartimit të specifikimeve teknike, ka përshkruar minimumin e kërkesave që duhet të kenë produktet që kërkon të furnizohet me anë të kësaj procedure prokurimi, duke përcaktuar funksionalitetet minimale që duhet të kenë pajisjet objekt prokurimi. Por, autoriteti kontraktor, në specifikimet teknike të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nuk ka përcaktuar minimumin e aksesorëve të nevojshëm që do të jenë pjesë e “set” për zërat, 12 F. V. *Sistem i detektimit dhe fikjes se zjarrit*, 13 F.V. *Sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit* dhe 15 F.V. *Sistem akses kontrolli*, sikurse ka bërë me zërat 11 F.V. *Network (përfshi FO, CU, patchpanele dhe menaxhues kablli, menaxhues ajri, kanalinen e verdhe, aksesor etj.)* dhe 14 F.V. *Sistem CCTV (5 kamera, NVR, switch PoE)*. Komisioni gjykon se, autoritetet kontraktore duhet të përcaktojnë qartë minimumin e karakteristikave, përbërjes dhe specifikimeve teknike të mallrave/punëve/shërbimeve që prokurojnë, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve, kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale ose të dyja metodave të përcaktuara më lart për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate.

Sa më sipër, duke marrë në konsideratë edhe pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues lidhur me mospërcaktimin e specifikimeve minimale për pajisjet që prokurohen, në vecanti për sistemin e detektimit dhe fikjes së zjarrit, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike lidhur me zërat 12 F. V. *Sistem i detektimit dhe fikjes se zjarrit*, 13 F.V. *Sistemi i monitorimit, kontrollit dhe menaxhimit* dhe 15 F.V. *Sistem akses kontrolli*, duke përcaktuar minimumin e pjesëve përbërëse si dhe specifikimet teknike të tyre, gjithmonë duke u bazuar në përcaktimet nenit 23 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.11. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Integrated Security Solutions” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]ANKESË NR.14

Paragrafet me poshte jane manuali i sistemit qe keni parapercaktuar per kete procedure ??? Sistemi duhet te jetë i programuar për këto skenarë:

Stand by - Sistemi është në gatishmeri. Në këtë gjendje sistemi nuk kryen asnjë veprim por vetëm lexon të dhënat nga detektorët zjarrit në zonat e përcaktuara më lart.

Prealarm (Pre-activated) - Sistemi ka sinjal alarmi (Fire Alarm) nga një prej zonave të mbulimit të zjarrit (kur aktivizohet një sensor në zonën e mbrojtur nga zjarri- temperature ose tym) dhe duhet të iniciojë një alarm në panelin e kontrollit, duhet të aktivizojë sirenat dhe dritat pulsuese

në zonën e mbuluar nga ky sensor. Këto sinjale i dergohen dhe personelit për kontrollin dhe monitorimin e mbrojtjes nga zjarri. Në këtë gjendje nuk duhet të aktivizohet menjëherë sistemi i shuarjes së zjarrit për të shmangur alarmet "false", që mund të vijne si rezultat i faulteve të sistemit. Pas ndërhyrjes së operatorëve të sigurisë. në rastin e alarmeve "false", sistemi mund të kthehet në gjendjen e tij normale nëpërmjet butonave të komandimit në panelin e kontrollit.

Alarm (Activated) - Sistemi ka sinjal alarmi nga të dy zonat e dhomes (sensore temperature dhe detektor tymi). Detektimi i zjarrit nga një sensori i dytë aktivizon "alarmin nga zjarri" dhe kalimin në fazën e shuarjes së zjarrit; edhe në këtë fazë, operatorët mund të ndalojnë manualisht kalimin në procesin e shuarjes së zjarrit (në rast se zjarri mund të shuhet nëpërmjet shuarësve portabël me pluhur ose nëse kemi të bëjmë me një alarm "fals"). Sistemi i projektuar i mbrojtjes nga zjarri duhet t'i mundësojë operatorëve edhe aktivizimin manual në procesin e shuarjes së zjarrit nëpërmjet butonit përkatës në ambjent. Në këtë gjendje sistemi jep alarmin për evakuimin e ambjenteve duke ndezur sinjalet dalje dhe duke aktivizuar alarmin e përgjithshëm. Njëkohësisht behet caktivizimi i magnetëve të dymit nga sistemi i kontrollit, monitorimit dhe menaxhimit.

Kerkojme rishikimin e ketyre fjalive pasi jane copy paste!

Ak në përgjigjen e tij pretendon se këto janë në gjëndje të sistemi të zjarrit dhe janë në cdo sistem. Kërkojmë rishikimin e tyre pasi orientojnë drejt një prodhuesi të vetëm.

ANKESË NR.16

Në pikën 9.2.1 Sistemi CCTV përcaktoni se: Dhoma e serverave duhet të pajiset me sistem CCTV dhe sistem të kontrollit të aksesit. Brenda dhomes se serverave duhet të instalohen 5 kamera per vezhgimin e gjithë hapësirës së dhomes. Gjithashtu, dhoma e serverave duhet të pajiset me sistem kontrolli aksesi me dy readera per deren e dhomes se serverave (Brenda dhe jashte dhome). Regjistrimi i kamerave në dhomen e serverave do të behet me ane të NVR-se lokale, ndersa kamerat do të ushqehen nëpërmjet teknologjisë POE për të evituar instalimet e rrymës elektrike. Të gjithë aksesoret e nevojshëm për montimin e kamerave duhet të jenë të përfshira. Për ushqimin e kamerave me POE duhet të instalohet nje sëitch sipas specifikimeve të përcaktuara me poshte. Me poshtë janë specifikimet teknike për komponentët kryesore të sistemit CCTV.

I.S.S shpk i ka kërkuar AK saktësimin e pikave si më poshtë: a.Kërkoni më sipër që aksesoret duhet të jene të përfshirë. Si mundet që nje AK të mos japi informacion se kush janë keto aksesore ndihmës? Ky term që ju perdorni konfondon O.E pjesëmarrës duke mos llogaritur dot kostot pasi ju nuk përcaktoni produktet. Sa metra kabull kerkojne keto kamera per tu instaluar? A duhen kanalina duhen? Tubo duhen? Kuti per kamerat duhen? Koka rrjeti duhen?

Karakteristikat Vlerat specifike minimale

Numri i kanaleve hyrëse 8 kanale ose me shume

Outgoing Bandwidth Min 150 Mbps

Rezolucioni maksimal në regjistrim Min 12 MP Synchron Playback deri në 8 kanale

Formati i Videos H.264 ose me mire

Kapaciteti i numrit të Hard-disqeve 2

Kapaciteti fizik i disqeve Deri në 8 TB

HDD te përfshira 2x4TB HDD

Porta e rrjetit Min 2x RJ-45 10/100/ 1000 Mbps

Portat USB 2xUSB 2.0 ose me shume; 1xUSB 3.0 ose me shume;

Temperaturat e operimit 0 deri në +45° C

Me Siper kerkoni nje NVR qe te jete minimalisht 12 MPX nderkohe qe kamerat i kerkoni jo me shume se 8 MPX. Keni Arsye? Kerkojme uljen e rezolucionit minimal te NVR nga 12 MPX ne 8 MPX. Kerkojme riformulimin e te gjitha parametrave Teknik te NVR pasi nuk jepni informacione cili do të jete procesori minimal i pranuar per NVR? Kush do jete bandëithi ne hyrje i kesaj NVR pasi kerkoni vetem daljen? NVR duhet te kete minimalisht nje porte VGA apo nje Porte HDMI apo 10 porta ??? Nuk e kuptojmë se si AK ka marrë oferta për një projekt ku nuk janë përcaktuar as specifikimet teknike minimale!!! Kur thoni kapaciteti fizik i disqeve 8 TB kuptoni nje HDD duhet te jete 8 apo te dy 8? Cfare lloji duhet te jene HDD 2.5 apo 3.5?

Kerkojme që AK minimalisht të bëjë perkthimin ne gjuhen shqipe te fjalive qe jane Anglisht dhe COPY Paste nga katalogët e operatorit të paracaktuar per të fituar këtë kete procedure.

Karakteristikat Vlerat specifike minimale

Tipi i kameres ("Type of camera") Bullet

Procesori i figures ("Image Sensor") Progressive Scan CMOS sensor 1/2"

*Rezolucioni i figures ("Resolution") Minimumi 3840*2160*

Frekuenca e kuadrove ("Frame Rate") 20 fps

Reduktimi i zhurmes ("Noise Reduction") 3D DNR

Tipi i lenteve ("Lens Type") E Motorizuar

Gjatesia fokale ("Local length") 2.8 ~ 12mm,

Ndjeshmeria drites në 50 IRE, ("Min. Illumination @50IRE,) Color 0.01 lux; B/W 0 lux with IR

Ndriçimi Infra të Kuqe ("IR illuminators") 40 m;

Rezistenca ndaj pluhurit dhe shiut IP67

Dite/Nate ("Day/Night") R cut filter

Diapazoni dinamik i djeshmerise, (Wide Dynamic range) Po ("Yes"), min 120 dB

Formati i kompresimit të Videos H.264 ose me mire

Dedektim i levizjes ("Motion Detection") Po

Formati i kompresimit të Videos H.264 ose me mire

Dedektim i levizjes ("Motion Detection") Po

Pajtueshmeria e sistemit ("System support") ONVIF

Multi-streaming Min. Dual stream

Temperatura e operimit ("Operating Temperature") -10°C +50°C

Ushqimi ("Power") PoE

Aksesore per montimin Po, sipas tipit të kameres dhe menyres se montimit

I.S.S shpk i ka kërkuar AK të saktësojë : Me cfare do lidhet kamera me NVR? Me ëireles apo me kabull? Nqs duhet kabell sa metra duhen ? Si do kaloje. Kerkojme te rishikoni te gjitha specifikimet e mesiperme te kameres pasi janë vetëm për një prodhues të paracaktuar?

Edhe në lidhje me sa më sipër AK pretendon AK ka lënë që cdo operator ekonomik të sjellë zgjidhjen për të gjitha sistemet e kërkuara! Kjo vlen edhe për sistemin e kamerave! Të gjitha pikat e tjera janë lënë evazive, madje edhe kërkesa për të përkthyer është refuzuar me pretendimin se: Parametrat teknik të cilët njihen gjerësisht në gjuhën angleze referuar edhe standarteve ndërkombëtare, AK ka zgjedhur mos ti shqipërojë për të mos krijuar konfuzion tek OE!!!

Kërkojmë që AK të detyrohet të përcaktojë saktë cdo mall që kërkon qoftë në sasi qoftë në specifikime teknike pasi kjo është një procedurë blerje dhe jo konkurs projektimi që të lihet në dorë të zgjidhjeve të ofruara nga operatoret ekonomik.

ANKESË NR.17

Pika 9.2.1.3 Switch për sistemin e kamerave parashikon se: Sëitch do të përdoret për të ushqyer me POE kamerat e instaluara për monitorimin e dhomes se serverave.

Modeli I montueshem ne rack, 1U, aksesore te perfshira

Nderfaqet 24 RJ-45 auto-negotiating 10/100/1000 POE+ ports

Memorja Min 32MB flash

Min 128MB RAM

Min 512 KB packet buffer

Kapaciteti/Performanca Switching capacity min: 50 Gbps

Throughput min.: deri ne 40 Mpps

Mac-Address table: Min 8000 Entries

Routing Table min 32 entries

Karakteristika L2 Sëitch Spanning Tree Protocol (STP)

BPDU filtering

Jumbo frame support

VLAN supping

supports IEEE 802.1Q; 256 VLANs with a VLAN ID range 2-4093

Karakteristika L3 Static IPv4 routing

DHCP relay

Address Resolution Protocol (ARP)

Siguria Advanced access control lists (ACLs)

IEEE 802.1X and RADIUS network logins

Secure Socket Layer (SSL)

Port Isolation

Automatic VLAN assignment

Automatic denial-of-service protection

Management password

QoS 802.1p Quality of Service

Type of Service (ToS)

COS based on: 802.1p priority Queues, DSCP

Advanced Classifier based QoS

Rate Limit

Manaxhimi WEB with SSL (HTTPS)

SNMP: Supports v1/v20/v3

Remote Monitoring (RMON)

FTP, TFTP, or SFTP support

Netëork Time Protocol (NTP)

Port mirroring

POE poëer 370 W PoE+

Fuqia/Ambienti AC Poëer Input

Temprature operacionale: 0 - 40 degree Celsius

Lageshtira: 15% to 90%, noncondensing

Garancia Min 1 vit

Specifikimet Teknike te switch jane marre COPY PASTe nga nje prodhues i paracaktuar per të fituar kete projekt.

Kerkojme perktimin ne gjuhen shqipe te ketyre specifikimeve teknike. Kerkojme riformulimin e ketyre specifikimeve duke pare qe kerkoni ta bllokoni projektin me kete switch. Si mundet te kerkoni nje switch qe do mbaje ne pune 5 kamera dhe sëitchi ka parametra per te mbajtur edhe 25 kamera apo 100? Si ta quajmë kete fakt shperdorim fondesh ne kohe Pandemie apo bllokim projekti me nje prodhues te paracaktuar? Per cfare kerkohen porta 1000 Mbps kur kamerat jane 100 mpbs??? Si e shpjegoni qe ju si njesi per pergatitjen e kritreve ne disa produkte vendosni kriteret deri ne detaje ku vetem nje operator i permbush dhe ne disa produkte nuk vendosni asnje kriter? Si shpjegohet nga ana e AK qe disa specifikime teknike jane ne shqip dhe disa te tjera anglisht? [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.11.1. Në shtojcën nr.10, “Specifikime teknike”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

“Sistemi duhet të jetë i programuar për këto skenarë:

- **Stand by - Sistemi është në gatishmeri.**

Në këtë gjendje sistemi nuk kryen asnjë veprim por vetëm lexon të dhënat nga detektorët e zjarrit në zonat e përcaktuara më lart.

- **Prealarm – (Pre-activated) Sistemi ka sinjal alarmi (Fire Alarm) nga një prej zonave të mbulimit të zjarrit (kur aktivizohet një sensor në zonën e mbrojtur nga zjarri- temperature ose tym) dhe duhet të iniciojë një alarm në panelin e kontrollit, duhet të aktivizojë sirenat dhe dritat pulsuese në zonën e mbuluar nga ky sensor. Këto sinjale i dergohen dhe personelit për kontrollin dhe monitorimin e mbrojtjes nga zjarri.**

Në këtë gjendje nuk duhet të aktivizohet menjëherë sistemi i shuarjes së zjarrit për të shmangur alarmet “false”, qe mund te vijne si rezultat i faulteve te sitemit. Pas ndërhyrjes së operatorëve të sigurisë, në rastin e alarmeve “false”, sistemi mund të kthehet në gjendjen e tij normale nëpërmjet butonave të komandimit në panelin e kontrollit.

- **Alarm – (Activated) Sistemi ka sinjal alarmi nga të dy zonat e dhomes (sensore temperature dhe detektor tymi). Detektimi i zjarrit nga një sensori i dytë aktivizon “alarmin nga zjarri” dhe kalimin në fazën e shuarjes së zjarrit; edhe në këtë fazë, operatorët mund të ndalojnë manualisht kalimin në procesin e shuarjes së zjarrit (në rast se zjarri mund te shuhet nëpërmjet shuarësve portabël me pluhur ose nëse kemi të bëjmë me një alarm “fals”). Sistemi i projektuar i mbrojtjes nga zjarri duhet t’i mundësojë operatorëve edhe aktivizimin manual në procesin e shuarjes së zjarrit nëpërmjet butonit përkatës në ambjent. Në këtë gjendje sistemi jep alarmin per evakuimin e ambjenteve duke ndezur sinjalet dalje dhe duke aktivizuar alarmin e përgjithshem. Njëkohesisht behet caktivizimi i magneteve te dyerve nga sistemi i kontrollit, monitorimit dhe menaxhimit.**

Karakteristikat	Vlerat specifike minimale
Numri i kanaleve hyrëse	8 kanale ose me shume
Outgoing Bandwidth	Min 150 Mbps
Rezolucioni maksimal në regjistrim	Min 12 MP
Synchron Playback	deri në 8 kanale
Formati i Videos	H.264 ose me mire
Kapaciteti i numrit të Hard-	2

disqeve	
Kapaciteti fizik i disqeve	Deri në 8 TB
HDD te përfshira	2x4TB HDD
Porta e rrjetit	Min 2x RJ-45 10/100/1000 Mbps
Portat USB	2xUSB 2.0 ose me shume; 1xUSB 3.0 ose me shume;
Temperaturat e operimit	0 deri në +45° C

Karakteristikat	Vlerat specifike minimale
Tipi i kameres (“Type of camera”)	Bullet
Procesori i figures (“Image Sensor”)	Progressive Scan CMOS sensor 1/2”
Rezolucioni i figures (“Resolution”)	Minimumi 3840*2160
Frekuenca e kuadrove (“Frame Rate”)	20 fps
Reduktimi i zhurmës (“Noise Reduction”)	3D DNR
Tipi i lenteve (“Lens Type”)	E Motorizuar
Gjatesia fokale (“Local length”)	2.8 ~ 12mm,
Ndeshmeria drites në 50 IRE, (“Min. Illumination @50IRE,)	Color 0.01 lux; B/W 0 lux with IR
Ndriçimi Infra të Kuqe (“IR illuminators”)	40 m;
Rezistenca ndaj pluhurit dhe shiut	IP67
Dite/Nate (“Day/Night”)	IR cut filter
Diapazoni dinamik i djeshmerise, (Wide Dynamic range)	Po (“Yes”), min 120 dB
Formati i kompresimit të Videos	H.264 ose me mire
Dedektim i levizjes (“Motion Detection”)	Po
Pajtueshmeria e sistemit (“System support”)	ONVIF
Multi-streaming	Min. Dual stream
Temperatura e operimit (“Operating Temperature”)	-10°C - +50°C
Ushqimi (“Power”)	PoE
Aksesore per montimin	Po, sipas tipit të kameres dhe menyres se montimit

Modeli	I montueshem ne rack, 1U, aksesore te perfshira
Nderfaqet	24 RJ-45 auto-negotiating 10/100/1000 PoE+ ports
Memorja	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Min 32MB flash ▪ Min 128MB RAM ▪ Min 512 KB packet buffer
Kapaciteti/Performanca	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Sëitching capacity min: 50 Gbps ▪ Throughput min.: deri ne 40 Mpps ▪ Mac-Address table: Min 8000 Entries

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Routing Table min 32 entries
Karakteristika L2 Switch	Spanning Tree Protocol (STP) BPDU filtering Jumbo frame support VLAN support and tagging supports IEEE 802.1Q; 256 VLANs with a VLAN ID range 2-4093
Karakteristika L3	<ul style="list-style-type: none"> ● Static IPv4 routing ● DHCP relay ● Address Resolution Protocol (ARP)
Siguria	<ul style="list-style-type: none"> ● Advanced access control lists (ACLs) ● IEEE 802.1X and RADIUS network logins ● Secure Socket Layer (SSL) ● Port Isolation ● Automatic VLAN assignment ● Automatic denial-of-service protection ● Management password
QoS	<ul style="list-style-type: none"> ● 802.1p Quality of Service ● Type of Service (ToS) ● CoS based on: 802.1p priority Queues, DSCP ● Advanced Classifier based QoS ● Rate Limit
Manaxhimi	<ul style="list-style-type: none"> ● WEB with SSL (HTTPS) ● SNMP: Supports v1/v2c/v3 ● Remote Monitoring (RMON) ● FTP, TFTP, or SFTP support ● Network Time Protocol (NTP) ● Port mirroring
PoE power	<ul style="list-style-type: none"> ▪ 370 W PoE+
Fuqia/Ambienti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ AC Poëer Input ▪ Temperature operationale: 0 – 40 degree Celsius ▪ Lageshtira: 15% to 90%, noncondensing
Garancia	Min 1 vit

”

III.11.2. Në nenin 23 pika 1, 2, 3 dhe 5 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se : “1. *Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*

2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar: a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve; b) kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t'u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj."*

5. *Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime"*

III.11.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publik (në zbatim të nenit 12 të LPP-së) është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e specifikimeve teknike. Lidhur me pretendimet se specifikimet teknike kufizojnë konkurrencën duke drejtuar në prodhues të paracaktuar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se autoriteti kontraktor, gjatë hartimit të specifikimeve teknike, ka përshkruar minimumin e kërkesave që duhet të kenë produktet që kërkon të furnizohet me anë të kësaj procedure prokurimi, duke mos përcaktuar në mënyrë të hollësishme kapacitete dhe parametra fikse për objektet të cilat prokurohen, por ka përcaktuar parametrat minimal ose maksimal që duhet të disponojnë këto objekte, duke lënë një diapazon të gjërë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP. Përcaktimi në mënyrë të detajuar i specifikave që nuk ndikojnë në funksionalitetin apo nuk vërtetojnë cilësinë e pajisjeve objekt prokurimi, duke i përcaktuar në mënyrë eksplicite ato, do të kufizonte pjesëmarrjen në këtë procedurë prokurimi e për pasojë do të kufizonte konkurrencën, cka nuk është bërë në rastin konkret. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues, në ankesën e tij, nuk identifikon asnjë specifikim apo të dhënë konkrete për të bazuar pretendimin e tij, apo të orientojë në mënyrë konkrete se cili parametër drejton në një produkt të vetëm. Komisioni gjykon se operatoët ekonomik duhet të mbështesin me fakte dhe prova konkrete pretendimet e tyre, si dhe duhet ta bëjnë të identifikueshme shkeljen e pretenduar.

III.11.4. Lidhur me pretendimin mbi gjuhën e përdorur në hartimin e specifikimeve teknike, bazuar në përcaktimin e VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Komisioni vlereson se, në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetar, gjuha e përdorur duhet të jetë tërësisht në gjuhën shqipe, si nga ana e autoritetit kontraktor në hartimin e dokumentave të tenderit, gjithashtu edhe nga ana e operatorëve ekonomik ofertues në hartimin e ofertave. Në rastin konkretë, Komisioni gjykon se specifikimet

teknike të mësipërme, nuk janë hartuar në përputhje të plotë me aktin nënligjor të sipërcituar. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë specifikimet teknike në përputhje me nenin 14 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

III.11.5.Lidhur me pretendimet e tjera të cituara në pikën III.11., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi para kërkimit për sqarime mbi specifikimet teknike. Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteri kualifikues është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës), por në thelb është një paqartësi mbi kërkesën e autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik në ankesë ka theksuar paqartësinë në përmbushjen e tyre.

Gjithashtu, KPP konstaton se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit, Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. 2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë.”*, ka dhënë sqarimet e nevojshme për operatorin ekonomik ankimues me anë të shkresës nr.1836/3prot., datë 23.06.2020, lidhur me specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi, por këtë sqarim nuk e ka publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në zbatim të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të publikojë këtë sqarim me anë të shtojcës përkatëse, sikurse përcaktohet në nenin 42 pika 2 të L.P.P-së.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Integrated Security Solutions” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Realizimi i dhomës së serverave (bcc site) në Vaun e Dejës dhe krijimi i kushteve teknike në HEC Vau i Dejës, HEC Koman dhe HEC Fierzë*”, me nr. REF-61043-06-11-2020, me fond limit 27,800,000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 13.07.2020, nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Integrated Security Solutions” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 679 Protokoli, Datë 30.06.2020;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri